Tiranë , më dt. 12 / 11 / 2026

PËRMBLEDHJE E KËRKESAVE E PRETENDIMEVE PËR PROVAT

Kërkues: i pandehuri z. ILIR METAJ , i përfaqësuar e mbrojtur nga Av. Bujar Musta ;

Me objekt: Paraqitja e përmbledhur e pretendimeve dhe kërkesave për prova dhe kundërshtimin e provave , sipas nenit 356 të K. Pr. Penale ;

Drejtuar: Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ;

(Kryetarit të trupit Gjykues z. Erion Bani)

E nderuar Gjykatë !

Sipas kërkesës / orientimit tuaj në seancat gjyqësore dt. 18 / 6 / 2026 dhe dt. 05 / 11 / 2026 ; ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur kërkesat dhe pretendimet e mia vijuese , parashtruar verbalisht dhe me shkrim , në seancat gjyqësore ose për llogari të seancave gjyqësore të datave 18 / 6 / 2026 , 24 / 6 / 2026 , 09 / 7 / 2026 , 29 / 7 / 2026 , 10 / 9 / 2026 , 17 / 9 / 2026 , 24 / 9 / 2026 , 01 / 10 / 2026 , 15 / 10 / 2026 , 22 / 10 / 2026 , 29 / 10 / 2026 dhe 05 / 11 / 2026 ;

1). Jam dakord të administrohen , shqyrtohen dhe të diskutohen provat e kërkuara prej prokurorit (deklaruar prej tij , në seancën gjyqesore të dt. 18 / 6 / 2026) , sepse nga shqyrtimi i tyre në tërësi provojnë kundërshtimet e mia për faktet , rrethanat dhe episodet , objekt gjykimi dhe provojnë pafajësinë time (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 /2026) .

2). Prokurori kërkon të merren dhe të administrohen , si prova , deklarimet / dëshmia e disa shtetasve shqiptar dhe të huaj ; Edhe unë kërkoj të pyeten

dëshmitarët e kërkuar prej Prokurorit (deklaruar prej tij , po në seancën gjyqësore të dt. 18 / 6 / 2026) , sepse çdo dëshmi e tyre objektive e besueshme , rreth pyetjeve të mia , provojnë kundërshtimet e mia për faktet , rrethanat dhe episodet , objekt gjykimi dhe provojnë pafajësinë time (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) .

3). Prokurori kërkon të administrohen provat e marra , nga jashtë shtetit , me letërporosi , lidhur me episodin hetimor të lobimit politik ; Por në lidhje me korespondencën e Ministrisë të Drejtësisë me Departamentin e Drejtësisë të SH.B.A (për ndihmë juridike , lidhur me marrjen e informacioneve / akteve / të dhënave , nga shoqëria G.S.I.S) ; meqenëse më dt. 23 / 6 / 2026 është plotësuar afati 2 vjeçar i kufizimit (të caktuar nga një gjykatë e SH.B.A) dhe referuar e-mail dt. 15 / 7 / 2024 të Departamentit të Drejtësisë të SHBA pretendoj sa vijon :

3/1). Kërkoj nga Gjykata që të merret , si provë , nga Ministria e Drejtësisë , kërkesa " për ndihmë juridike " , që Prokurori ka depozituar , në këtë Ministri , për këtë kërkesë të posaçme (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026 ; kërkuar edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) .

3/2). Kërkoj të merren , si provë , në Ministrinë e Drejtësisë kërkesat nr. 122/2022 dhe 3285/Prot./AH , që Ministria e Drejtësisë i ka dërguar Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) .

3/3). Gjykata t'i kërkojë , si provë , Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A paraqitjen e të dhënave dhe akteve bankare të çdo lloji , sepse kanë lidhje me ekzekutimin e çdo lloj marrëveshje , që ish- Partia LSI ka krijuar e ndryshuar , me shoqërinë kompaninë amerikane G.S.I.S (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) .

3/4). Gjykata t'i kërkojë , si provë , Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A paraqitjen e të dhënave / informacionit , përgjigjen e shoqërisë amerikane Grupit

McKeon (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) .

3/5). Gjykata t'i kërkojë , si provë , Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sa vijon:

i). Paraqitjen e vendimit gjyqësor dt. 23 / 6 / 2024 të Gjykatës përkatëse të SH.B.A , që ka vendosur "…e*kzekutimi i kërkesës të palës shqiptare të trajtohej si konfidenciale dhe e padisponueshme për publikun për dy vjet…"* (shih e-mail datë 15 / 7 / 2024 të Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A) ;

ii). Paraqitjen e kërkesës e palës të interesuar , me objekt " për konfidencialitet " , drejtuar po asaj gjykate në SH.B.A (e cila disponoi me vendimin e saj dt. 23 / 6 / 2024) .

iii). Paraqitja e çdo vendimi tjetër gjyqësor , nga gjykatat në SH.B.A , që ka disponuar eventualisht , për ekzekutimin e letërporosisë , prej dt. 15 / 7 / 2024 dhe në vijim.

iv). Paraqitja , nga shoqëria G.S.I.S , e marrëveshjes (varianti i saj anglisht) dt. 03 / 02 / 2016 të lidhur prej saj / shoqëria G.S.I.S (përfaqësuar nga Dennis Burke) , me ish- partinë L.S.I (përfaqësuar nga Petrit Vasili) , përfshirë dhe ndryshimet e saj eventuale , me shkrim (nëse ka ndryshime , sipas parashikimeve të mirëpërcaktuara , në marrëveshjen fillestare G.S.I.S - Partia LSI) .

- Nëse marrëveshja fillestare ka patur ndryshime , na njoftoni se kur janë kryer secili ndryshim ?

- Cili përfaqësues i partisë L.S.I i ka miratuar ndryshimet eventuale ? Në çfarë forme / mënyre i ka miratuar ky përfaqësues i partisë LSI , ndryshimet eventuale ?

- Në çfarë forme/mënyre e ka njoftuar shoqërinë G.S.I.S , ky përfaqësues i partisë LSI për miratimin e ndryshimeve eventuale ?

v). Paraqitja nga shoqëria G.S.I.S e çdo lloj akti përfaqësimi të partisë LSI , për krijimin , ndryshimin apo shuarjen e marrëveshjes së tyre.

vi). Paraqitja nga shoqëria G.S.I.S e çdo lloj akti financiar , që ka lidhje me ekzekutimin monetar të marrëveshjes , të lidhur midis tyre dhe partia LSI , sipas parashikimeve kontraktore në fuqi të marrëveshjes G.S.I.S - Partia LSI .

vii). Paraqitja nga shoqëria G.S.I.S të të gjitha miratimeve / autorizimeve paraprake nga partia LSI , për çdo lloj shpenzimi të paguar , nga kjo parti , në dobi të shoqërisë G.S.I.S , mbi 1000 USD , sipas parashikimeve kontraktore në fuqi .

viii). Paraqitjen e emrit të personit përgjegjës / përfaqësuesit , që ka miratuar çdo shpenzim financiar , nga partia LSI , për t'u paguar , në dobi të shoqërisë G.S.I.S , pas çdo fature financiare të dërguar nga G.S.I.S , për partinë LSI, sipas marrëveshjes në fuqi.

ix). Paraqitja nga shoqëria G.S.I.S të informacionit , për çdo produkt të punës /veprimtarisë së tyre, në zbatim të marrëveshjes të lidhur me partinë LSI ?

- Nëse po , kujt ja ka dorëzuar këtë produkt (në partinë LSI) , kur ja ka dorëzuar dhe në çfarë forme /mënyre , ja ka dorëzuar ?

- A ka caktuar shoqëria GSIS ndonjë nënkontraktor , për zbatimin e marrëveshjes së tyre , me partinë LSI ? Nëse po , cili është nënkontraktori dhe cili përfaqësues i partisë LSI e ka dhënë pëlqimin?

- Nëse shoqëria G.S.I.S e ka marrë paraprakisht pëlqimin / miratimin e partisë LSI , për caktimin e këtij nënkontraktori ? Nëse po , të paraqiten prej G.S.I.S , të gjitha aktet e miratimit / pëlqimit / autorizimit të partisë LSI , për caktimin e tij.

- Paraqitja nga shoqëria G.S.I.S të informacionit , se çfarë veprimesh apo produkti ka kryer nënkontraktori eventual për zbatimin e marrëveshjes të lidhur , midis shoqërisë G.S.I.S dhe partia LSI ?

x). T'i kërkohet shoqërisë G.S.I.S informacion , se kur i ka mbaruar efektet marrëveshja e tyre , me partinë LSI ? Ose kur e ka ndërprerë shoqëria G.S.I.S ekzekutimin e marrëveshjes së tyre fillestare dhe/ose të ndryshuar me partinë LSI ?

- Cili ka qenë përfaqësuesi i partisë LSI dhe përfaqësuesi i shoqërisë G.S.I.S , në rastet e ndryshimit të marrëveshjes së tyre fillestare eventualisht ?

- Cili ka qenë përfaqësuesi i partisë LSI dhe përfaqësuesi i shoqërisë G.S.I.S , në rastet e ndërprerjes/shuarjes përfundimisht të kontratës midis tyre dhe cila është dita e ndërprerjes së kontratës , nëse nuk ka patur asnjë ndryshim , nga marrëveshja fillestare e dt. 03 / 02 / 2016 .

- A është dhënë nga ndonjë përfaqësues i partisë LSI pëlqimi/miratimi/autorizimi paraprak me shkrim, që shoqëria G.S.I.S t'i japë akses një pale të tretë në informacionin konfidencial të marrëveshjes , të lidhur midis shoqërisë G.S.I.S dhe partisë LSI (përfshirë edhe informacionet për ndryshimet e saj) ? Nëse po , të na dërgoni këto pëlqime/ miratime/autorizime.

- A është dhënë nga ndonjë përfaqësues i partisë LSI pëlqimi / miratimi/autorizimi paraprak me shkrim , që shoqëria G.S.I.S të nënshkruajë (në emër të partisë LSI) ndonjë marrëveshje / kontratë tjetër angazhimi apo veprimtarie tjetër ? Nëse po, na dërgoni këto pëlqime / miratime / autorizime eventuale .

- A është dhënë nga ndonjë përfaqësues i partisë LSI pëlqimi / miratimi / autorizimi paraprak me shkrim , që shoqëria G.S.I.S të kthejë dhe/ose të asgjësojë të gjithë informacionin konfidencial , të përfituar gjatë zbatimit të marrëveshjes (dhe ndryshimet e saj) , lidhur midis tyre ? Nëse po , cili përfaqësues e ka dhënë (dhe na dërgoni këto pëlqime/ miratime / autorizime) ?

- Nëse shoqëria G.S.I.S ka kryer asgjësime të të gjithë informacionit konfidencial , na njoftoni , kur është asgjësuar , prej tyre dhe çfarë informacioni është asgjësuar ?

xi). T'i kërkohet shoqërisë G.S.I.S informacion , se çfarë vlerash monetare janë paguar , në dobi të shoqërisë G.S.I.S , nga partia LSI ?

- Sa ka qenë vlera totale monetare e faturave bankare , që ka ekzekutuar / paguar partia LSI , në dobi të shoqërisë G.S.I.S , sipas marrëveshjes së tyre fillestare dhe sipas ndryshimeve të saj eventuale ? Për çfarë shërbimesh / produkti të kryer eventualisht prej shoqërisë G.S.I.S , janë paguar , nga partia LSI , secili shpenzim ?

- Cilit person (në partinë LSI) i janë dërguar/njoftuar , nga shoqëria G.S.I.S , secili shërbim dhe faturë e tyre , para se të kryhej pagesa , nga partia LSI ?

- Cilët janë përfaqësuesit e partisë LSI , që kanë autorizuar /miratuar pagimin e çdo lloj shpenzimi në dobi të shoqërisë G.S.I.S ?

- A ka përdorur partia LSI ndonjë fond monetar të paligjshëm ose ndonjë pagesë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (në kundërshtim me ligjet e zbatueshme të SH.B.A), gjatë zbatimit të marrëveshjes të saj në fuqi, me shoqërinë G.S.I.S ?

- Nëse po , cili përfaqësues i partisë LSI e ka autorizuar / miratuar këtë pagesë ? Nëse është konstatuar nga shoqëria G.S.I.S , kjo parregullsi eventuale financiare , a është raportuar / denoncuar pranë autoriteteve të SH.B.A ?

xii). Nëse pagesat e shërbimeve/produkteve (në dobi të shoqërisë G.S.I.S) janë kryer (në emër të partisë LSI) , nga shtetasi Adrian Shatku kërkoj të paraqitet kontrata / marrveshja , në bazë të të cilës ai i ka kryer këto pagesa? Na njoftoni se cili përfaqësues i partisë LSI e ka autorizuar/lejuar shtetasin Adrian Shatku të kryejë këto pagesa ? (Njëkohësisht na dërgoni këto autorizime dhe faturat e pagesave bankare , të kryera eventualisht prej shtetasit Adrian Shatku, përfshirë edhe shërbimet e shoqërisë G.S.I.S të kryera , për interes të partisë LSI dhe të paguara nga Adrian Shatku).

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 /2026 ;

3/6). Kjo letërporosi ka lidhje me faktet e rrethanat objekt akuze (për lobimet politike) dhe provojnë pafajësinë time.

i). Për këtë shkak kërkoj , që Gjykata të caktojë përkthyes të licensuar (sipas neneve 123 -126 , 196 të K. Pr. Penale , ligjit organik nr. 82/2021 dhe akteve tij nënligjore) dhe të regjistruar , në Ministrinë e Drejtësisë , për t'u paraqitur për betim , në një seancë të ndërmjetme dhe për të përkthyer , në gjuhën angleze të zbatuar në SH.B.A , kërkesat , pyetjet e mia , kërkesat dhe pyetjet eventuale të prokurorit dhe kërkesat e pyetjet eventuale të Gjykatës . Teksti i plotë i kërkesës t'i dërgohet Departamentit të Drejtësisë të SHBA , duke patur parasysh / referencë përmbajtjen e e-mail dt. 15 / 7 / 2024 të Departamentit të Drejtësisë të SHBA (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026).

4). Prokurori kërkon të merren , si prova shkresore , aktet e ILDKPKI dhe të lidhur (këto prova) me ekspertimin financiar (kryer gjatë hetimit paraprak) ; Por pretendoj , se Gjykata duhet të kërkojë informacion /të dhëna nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit / ILDKPKI) përsa vijon :

i). Sa zyrtarë deklarues e kanë deklaruar dietën si të ardhur gjatë periudhës kohore financiare të viteve 1992 - 2022 ? A është përfshirë , nga ILDKPKI , dieta , si e ardhur , për këta zyrtarë gjatë periudhës kohore financiare të viteve 1992 – 2022 ? Nëse po , jep shkakun / arsyen ? Nëse jo , jep shkakun /arsyen ?

ii). A ka vendime gjyqësore civile/penale të formës së prerë , që administrohet pranë ILDKPKI , për periudhën kohore të viteve 1992 – 2022 , që ka lidhje me ndonjë zyrtar deklarues dhe që ka trajtuar (ndër të tjera) edhe dietën ? Nëse po , dërgoni vendimin / vendimet përkatëse gjyqësore. Çfarë efekti / ndikimi / pasojë/reflektimi ka patur ky / këto vendim/e gjyqësore në vijueshmërinë e veprimtarisë të ILDKPKI për zyrtarin / zyrtarët përkatës dhe për zyrtarët e tjerë deklarues?

iii). Çfarë metodologjie financiare / kontabile / ekonomike është patur parasysh / zbatuar , prej ILDKPKI , për periudhën kohore të viteve 1992 - 2022 , lidhur me analizimin e të ardhurave , shpenzimeve , investimeve dhe për kontrollin llogjiko-ekonomik / financiar / kontabël , ndaj zyrtarëve deklarues ? Kjo metodologji ka qenë e njëjtë për çdo zyrtar deklarues apo ka qenë e ndryshme sipas kategorive/nivelit të zyrtarëve ?

iv). Cilat ligje dhe akte nënligjore financiare / kontabile / ekonomike në fuqi ka patur parasysh ILDKPKI , në periudhën kohore të viteve 1992 - 2022 , për zbatimin e metodologjisë financiare / kontabile / ekonomike , tatimore për analizimin e të ardhurave , shpenzimeve , investimeve dhe për kontrollin llogjiko - ekonomik / financiar / kontabël , tatimor , ndaj zyrtarëve deklarues ?

v). A ka ndonjë vendim gjyqësor civil/penal të formës së prerë (për periudhën kohore të viteve 1992 - 2022) , që ka ndryshuar metodologjinë financiare / kontabile / ekonomike të ILDKPKI , ndaj zyrtarëve deklarues ? Nëse po , dërgoni vendimin / vendimet përkatëse gjyqësore.

vi). A ka patur këshillime , nga ILDKPKI , për periudhën kohore të viteve 1992 - 2022 , ndaj zyrtarëve deklarues , për faktin që të mos e llogaritnin dietën , si të ardhur ? Nëse po , për sa zyrtarë deklarues ka patur këshillime ? Si është reflektuar ky këshillim , edhe për zyrtarët e tjerë ?

vii). Nëse për mua / deklaruesin ILIR METAJ , a ka konstatuar ndonjëherë mosdeklarim apo fshehje të ardhurash , shpenzimesh etj. ? nëse po , a më kanë paralajmëruar / këshilluar / njoftuar / pyetur / hetuar / gjobitur mua ?

viii). A kanë zhvilluar ndonjë hetim administrativ , për mua deklaruesin , lidhur me burimin e pasurisë/ve , burimin e të ardhurave , burimin e shpenzimeve dhe burimin kursimeve të mia ? Nëse po , çfarë rezultatesh / vendimesh kanë nxjerrë eventualisht , sipas parimit të sigurisë juridike , parimit të njoftimit të vendimeve , parimit të vendimmarrjes , sipas dispozitave të ligjit në fuqi nr. 9049/2003 dhe sipas dispozitave të K. Pr. Administrative relevant në fuqi ? a më kanë gjobitur , për shkelje eventuale ?

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026 ;

5). Pretendoj / kërkoj nga GJ.K.K.O , të merret si provë shkresore , nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë vendimi gjyqësor penal i dënimit të dëshmitarit K.I (përfshirë edhe vendimin përkatës të Gjykatës se Apelit dhe vendimin përkatës të Gjykatës së Lartë) , sepse përmbajnë të dhëna , fakte e rrethana , që kanë lidhje me objektin e akuzës , ndaj meje (lidhur me episodin hetimor ÇEZ - DIA , objekt gjykimi) ; provojnë edhe ecurinë objektive të veprimtarisë /marëdhënies kontraktore tregtare e krijuar midis shoqërive tregtare ÇEZ - DIA (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026 ; kërkuar edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) ;

6). Prokurori pretendon , se nuk ka dokumentacion tjetër (referuar informacionit të Kryeministrisë ; shih fq. 310 të fashikullit hetimor nr. 22 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ; shih fq. 47 të fashikullit hetimor nr. 23 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Por unë pretendoj , se Gjykata duhet të kërkojë të gjithë dokumentacionin administrativo - financiar të muajve Nëntor 2010 - Dhjetor 2010 , që administron aktualisht Kryeministria dhe Ministritë përgjegjëse të Ekonomisë , Tregtisë dhe Energjitikës , për rimbursimin financiar të shpenzimeve të mia përkatëse (për transport , bileta avioni , akomodimi në hotel , dieta etj.) , gjatë udhëtimit tim zyrtar , në Republikën e Çekisë (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026 ; kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 16 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 17 / 9 / 2026).

7). Kërkoj të merret , si provë shkresore , kopje e legalizuar e aktit nr. 4512/3 Prot. dt. 05 / 4 / 2012 i Ministrisë së Financave (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) , sepse provoj mënyrën , se si është vepruar , nga një anëtar qeverie (konkretisht

nga Ministri i Finanacave) , pranë Entit Rregullator të Energjisë , në interes të shoqërisë “ ÇEZ Shpërndarje “ ; Pra , në rastin konkret objekt gjykimi , unë pretendoj , se Prokurori ka bërë interpretim arbitrar dhe të paarsyeshëm të fakteve , rrethanave dhe provave , lidhur me episodin hetimor “ ÇEZ “ - “ DIA “ ;

8). Kërkoj të merret , si provë shkresore (lidhur me episodin e lobimeve) , kopje e legalizuar e Statutit të ish- Partisë LSI , gjëndje e saj , në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë , përkatësisht në vitet 2016 e 2017 , sepse provon organizimin e veprimtarisë të partisë LSI , organet / strukturat e saj përgjegjëse , për çdo episod , lidhur me krijimin e mardhënieve kontraktore lobuese politike , me pagesat e Partisë , në dobi të shoqërive përkatëse të lobimit politik ; Provojnë , se unë nuk kam asnjé nënshkrim , lidhur me marréveshjen përkatëse me shoqërinë G.S.I.S ; Provon gjithashtu , se Kryetari i asaj partie nuk kishte asnjë lloj kompetence / përgjegjësie dhe menaxhimi , në fushën financiare të kësaj partie (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) .

9). Kërkoj të merret , si provë shkresore / elektronike (në versionin e saj anglisht) , e-mail i dërguar , nga e-mail *Tim.Schreiber@CliffordChance.com* , adresuar / drejtuar znj. Alma Hicka / me detyrë Avokate e Shtetit (me e-mail e saj Alma.Hicka@avokaturashtetit.gov.al) më dt. 01 / 9 / 2015 , ora 16:07 , për mosmarrveshjen e shoqërive tregtare ÇEZ - DIA , në Arbitrazhin Tregtar të Vjenës / Austri (e lidhur kjo provë , me episodin hetimor “ ÇEZ – DIA ”) ; Kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) .

10). Kërkoj të merret , si provë shkresore , kopje e legalizuar e aktit nr.1 Prot. dt. 05 / 01 / 2016 të Kryetarit të Kuvendit (ushtruar kjo detyrë prej meje / i pandehuri ; ky akt është hartuar prej meje) , drejtuar Prokurorit të Pëgjithshëm (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 /2026) ; Kërkoj të merret , si provë shkresore , kopje e legalizuar e aktit nr.3020 Prot. dt. 27 / 9 / 2015 të Kuvendit / Parlamentit (nënshkruar nga dëshmitari S.B, me cilësinë deputet / Kryetar i Komisionit Parlamentar) , drejtuar (ndër të tjerë) Ministrit të Punëve të Brendëshme ;

11). Kërkoj të merret , si provë shkresore , kopje e legalizuar e aktit nr. 36/1 Prot. dt. 06 / 01 / 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

12). Kërkoj të merret , si provë shkresore , kopje e legalizuar e vendimit penal të pushimit dt. 18 / 01 / 2017 , për procedimin penal nr. 86 viti 2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

12/1). Praktika e akteve / provave kërkuar , prej meje (me nr. rendor të sipërcituar 10 - 12) provojnë denoncimin tim , në Prokurori , për rrethanat /faktet e parashtruara , me intervista mediatike dhe me mesazhe telefonike (në telefonin tim) , nga dëshmitarja V.I ; provojnë gjithashtu , edhe denoncimin e Kuvendit / Komisioni saj përkatës , drejtuar Ministrit përgjegjës , për të njëjtat rrethana /fakte ;

13). Kërkoj të merret , si provë shkresore , kopje e legalizuar e aktit nr. 8276/1 dt. 20 / 12 / 2010 të shoqërisë shtetërore " KESH Sh.A " , drejtuar Entit Rregullator të Energjisë / shkurtimisht pasqyrohet , në vijim " ERE " (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

14). Kërkoj të merret , si provë shkresore , kopje e legalizuar e vendimit administrativ nr.118 dt. 28 / 12 / 2010 i ERE-s (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

15). Kërkoj të merret , si provë shkresore , kopje e legalizuar e vendimit gjyqësor civil përfundimtar nr. 11759 dt. 03 / 12 / 2012 i Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (me shënimet / sqarimet e Gjykatës së Apelit dhe / ose të Gjykatës së Lartë , sipas gjëndjes eventuale) , që i përket paditësit " KESH Sh.A " (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

15/1). Praktika e akteve kërkuar prej meje (me nr. rendor të sipërcituar 13 - 15) provojnë vendosmërinë e shoqërisë shtetërore " KESH " (në përgjegjësi funksionale / hierarkike të Ministrit të Ekonomisë , Tregtisë dhe Energjitikës , ushtruar prej meje , kjo detyrë , në vitin 2010) , për të kundërshtuar vendimin administrativ nr. 97/2010 të ERE-s , në rrugë / formë administrative e gjyqësore ; Meqenëse pretendimet e KESH janë rrëzuar , në rrugë administrative e gjyqësore provoj gjithashtu (me këto akte) , se unë nuk kam ndërhyrë , në vendimmarrjen e ERE-s ;

16). Kërkoj të merret , në shoqërinë shtetërore " O.SH.E.E " , si provë shkresore , kopje e legalizuar e marrëveshjes së plotë dt. 03 / 12 / 2014 , lidhur /krijuar midis shoqërisë O.SH.E.E. dhe personit juridik privat tregtar privat " DIA " , sepse ka lidhje me episodin hetimor ÇEZ -DIA (kërkuar me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) .

17). Kërkoj të merret , si provë shkresore , intervista e publikuar më dt. 05 / 9 / 2016 , në Revistën shqiptare " MAPO " të ish- Ambasadorit të SHBA në Tiranë, Z. Donald Lu , sepse provoj , që të gjitha vizitat / takimet e mia , në SH.B.A , kanë qenë të koordinuara , edhe me selinë e Ambasadës USA , në Tiranë ;

18). Kërkoj të merren , si prova shkresore (të lidhur me episodin hetimor të lobimit politik) praktika e aktit noterial nr. 2626 Rep. dt. 10 / 6 / 2026 të noteres Joana Smakaj (me seli në Tiranë) , që ka legalizuar aktin dt. 30 / 01 / 2017 të kompanisë private " McKeon Group " dhe përkthimin e saj , në gjuhën shqipe (administruar këto akte , në dosjen gjyqësore të veçantë penale me nr. 164 vendimi dt. 18 / 6 / 2026 të Gj.K.K.O të Apelit , në fq. 40 - 42) ;

18/1). Kërkoj të merren , si prova shkresore praktika e aktit noterial nr. 2632 Rep. dt. 10 / 6 / 2026 , po të noteres J.S , që ka legalizuar statementin bankar dt. 11 / 3 / 2024 të Bankës së Greqisë (administruar / lidhur këto akte , në dosjen gjyqësore të veçantë penale me nr. 164 vendimi dt. 18 / 6 / 2026 të Gj.K.K.O të Apelit , në fq. 43 , 44) , sepse provoj pafajësinë time ;

18/2). Kërkoj të merren , si prova shkresore (të lidhur me akuzat , ndaj meje , për fshehje pasurie e pastrim parash) praktika e aktit noterial nr. 2621 Rep. dt. 10 / 6 / 2026 të noteres J.S , që ka legalizuar aktin noterial nr. 1846 Rep. dt. 22 / 5 / 2024 (po të noteres Joana Smakaj) , lidhur me deklarimin noterial të të pandehurave Fatime Kryemadhi dhe Ema Çoku (administruar ky akt , në dosjen gjyqësore të veçantë penale me nr. 164 vendimi dt. 18 / 6 / 2026 të Gj.K.K.O të Apelit , në fq. 45 - 50) ; Me këtë akt noterial provoj , vetëm faktin se nuk kam dijeni , për mardhënien midis dy të pandehurave Fatime dhe Ema ;

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 29 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 29 / 7 / 2026 ;

19). Meqenëse ndaj vendimit gjyqësor të veçantë penal " për dërgimin e çështjes në gjyq " , nuk lejohet ankim (shih nenin 332/gj të K. Pr. Penale). Në përputhje me parashtrimet dhe kërkesat e prokurorit , në fq. 208 , 211 , 213 d 214 të kërkesës për gjykim dhe parashtrimet e tij , gjatë seancës paraprake (lidhur me akuzën , sipas nenit 257/a paragrafi i dytë të Kodit Penal) dhe për realizimin e mbrojtjes time efektive **kërkoj** , që Prokurori të saktësojë / cilësojë rregullisht në këtë faze , nëse akuzohem për deklarim të rremë , në ILDKPKI , lidhur me deklaratën time periodike vjetore të vitit 2019 (dorëzuar kjo deklaratë , prej meje , në ILDKPKI , në vitin 2020 ; shih fq. 211 , 213 e 214 të kërkesës për gjykim ; shih fq. 197 të vendimit gjyqësor të veçantë penal / seancë paraprake nr. 28/138 dt. 18 / 3 / 2026 të Gj.K.K.O të Shkallës së Parë) ? **apo** akuzohem për deklarim të rremë , në ILDKPKI , lidhur me deklaratën time periodike vjetore të vitit 2020 (dorëzuar kjo deklaratë , prej meje , në ILDKPKI , në vitin 2021 ; shih fq. 208 të kërkesës për gjykim) ? kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

19/1). Secila provë e sipërcituar apo mjet kërkimi prove të sipërcituar <u>provojnë direkt dhe indirekt faktet , se</u> nuk kam kryer deklarim të rremë , në ILDKPKI , në vitin 2019 (dorëzuar deklarata ime përkatëse , e këtij viti , në ILDKPKI , në vitin 2020) dhe nuk kam kryer deklarim të rremë , në ILDKPKI , në vitin 2020 (dorëzuar deklarata ime përkatëse , e këtij viti , në ILDKPKI , në vitin 2021) ; Kërkuar /deklaruar sa më lart me pretendimet në seancën gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

20). Kërkoj të merret , si provë , deklarimi / dëshmia i shtetasit Jozef Hejsek , para prokurorit Ndini Tavani (në Prokurorinë pranë Gjykatës të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) , më dt . 20 / 12 / 2011 ; Sipas deklarimit tij të këtij viti rrëzohet deklarimi tjetër i mëvonshëm të këtij shtetasi , qé ai ka bërë / dhënë eventualisht , në Arbitrazhin Tregtar të Vjenës , në Vjenë / Austri (kjo kërkesë ka lidhje me episodin hetimor " ÇEZ - DIA " ; kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia verbale në seancën gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

21). Gjykata të deklarojë papërdorshmërinë e deklarimeve të të ndjerit Dritan Prifti , sepse unë nuk kam patur asnjë lloj bisede , me të ndjerin Dritan ; Gjithashtu në deklarimet e tij , i ndjeri Dritan referon , për biseda eventuale , sikur ato /bisedat janë bërë , në muajt Maj e Qershor të vitit 2010 (pra , bisedat janë bërë dy-tre muaj para , se të nënshkruhej , né shtator 2010 , marréveshja midis dy shoqërive tregtare DIA - CEZ ; Referuar edhe dëshmisë së shtetasit ILIR Ciko , në këtë procedim penal pretendoj , se deklarimet e të ndjerit Dritan , nuk janë të besueshme) ; kjo kërkesë ka lidhje me episodin hetimor " ÇEZ - DIA " (Kërkuar sa më lart me parashtrimet e mia , në seancën gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ;

- Secila provë apo mjet kërkimi prove provojnë faktet , se unë kam patur personalisht dhe familjarisht të ardhura të mjaftueshme (nga burime të ligjshme dhe të deklaruara rregullisht prej meje , në ILDKPKI) , të cilat ishin të mjaftueshme për të kryer shpenzimet , investimet dhe për të përballuar koston e jetesës time personale dhe të familjes time ; Provohet , se unë nuk kam dijeni , për shpenzime personale të kryera eventualisht , nga e pandehura Monika ; Provojnë faktet , se unë nuk kam fshehur shpenzimet e mia (që janë të detyrueshme , për deklarim , në ILDKPKI) , për llogari të viteve 2019 e 2020 dhe nuk kam fshehur , asnjë llogari bankare . Provojnë faktet , se unë nuk kam dijeni për deklarimet e të pandehurës Monika (në ILDKPKI) dhe nuk mbaj pergjegjësi , për deklarimet dhe shpenzimet e saj (në ILDKPKI) ; Unë kam qenë në mirbesim dhe nuk kam dijeni , për shpenzimet e mia familjare pasmartesore , sepse me këto shpenzime merrej konkretisht e pandehura Monika (pra , ne i kishim të ndara detyrat , në familjen time pasmartesore) ; Provojnë faktet , se unë kam nënshkruar aneksin përkatës të deklaratés përkatëse të pasurisë të të pandehurës

Monika , dorëzuar prej saj në ILDKPKI (por unë nuk kam nënshkruar deklarimin e saj konkret ; prandaj e pretendoj faktin se nuk kam dijeni , për deklarimin e saj , në ILDKPKI) ; Provojnë faktet , se nuk kam asnjë lloj shpenzimi personal të pajustifikuar dhe të pa deklaruar , prej meje (në ILDKPKI) ; Provojnë faktet , se nuk kam patur asnjëherë kartë krediti dhe nuk kam kryer pagesa , në Austri ; Provojnë faktet , se unë nuk kam qenë , në asnjë dyqan , në Londër / Angli dhe unë nuk kam kryer blerje , në ato dyqane (kërkuar /deklaruar sa më lart me parashtrimet e mia verbale në seancën gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026) ; Provojnë faktet , se unë nuk kam dijeni , per veprimet përkatëse financiare apo shpenzimet e kryera , midis të pandehurave Monika , Fatime dhe Ema , në çdo periudhë kohore të viteve 2003 - 2023 , objekt hetimi dhe objekt ekspertimi financiar ; Provojnë faktet , se unë nuk kam dijeni , për të ardhurat e përfituara ose jo , nga e pandehura Monika , prej të pandehurave të tjera Ema dhe Fatime ;

- Secila provë apo mjet kërkimi prove provojnë faktet , se unë nuk kam influencuar / ndikuar (në asnjë formë dhe mënyrë , as direkt , as indirekt) , në asnjë autoritet /organ kompetent shtetëror/ publik , për lidhjen e kontratës midis palëve / personave juridik " CEZ " - " DIA " ; Provojnë , se nuk kam kërkuar (në asnjë formë dhe mënyrë , as direkt , as indirekt) personalisht , as në bashkëpunim dhe nuk kam marrë (në asnjë formë e mënyrë , as direkt , as indirekt) , personalisht , as në bashkëpunim , nga shtetasi Kastriot Ismailaj , asnjë vlerë monetare ;

- Provojnë faktin , se nuk kam ndikuar / influencuar (në asnjë formë e mënyrë , as direkt , as indirekt) , personalisht , as në bashkëpunim , ndaj të pandehurit Piro Xhixho (për lidhjen e kontratës , midis palëve/persona juridik tregtar privat " Vodafone " SHA - " UNIFI Communication Inc " ; Provojnë faktin , se Kryetari i AKEP-it (kryer nga i pandehuri Piro) , zgiidhej nga Kuvendi i Shqipërisë , me propozim té Késhillit té Ministrave (dhe jo nga ish- Partia LSI apo nga ana ime/Kryetar I LSI apo Kryetar Kuvendi) ; Komunikimi / korespondenca , midis entit publik / AKEP-it dhe Kuvendit të Shqipërisë , është kryer , jo në aspektin personal (midis titullarëve) , por është kryer në formën / korespondencën zyrtare dhe për shkak të detyrës (këto rrethana e fakte nuk përbëjnë ndihmë) ; Provojnë faktin , se të pandehurit Piro nuk i është dhënë , prej meje , asnjë lloj shpërblimi (qoftë edhe për vajzën e tij Erisa) , sepse vajza e të pandehurit Piro (deputetja

aktuale Erisa Xhixho) , ka qenë e treta , në qarkun Fier në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 (dhe nuk është zgjedhur deputete) ; Ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 , ajo ka qenë e renditur e treta , në qarkun Tirané ; Këto fakte e rrethana provojnë , se deputetja Erisa Xhixho , nuk ka patur asnjë lloj favorizimi , lidhur me episodet objekt hetimi , në vitin 2014 , për të cilat akuzohet babai i saj / i pandehuri Piro (sikur ai ka bashkëpunuar me mua) ; Por unë pretendoj , se nuk kam bashkëpunuar me të pandehurin Piro , lidhur me rrethanat /faktet , objekt gjykimi ;

- Provojnë faktet , se nuk kam përfituar (në asnjë formë e mënyrë , as direkt , as indirekt) , personalisht , as në bashkëpunim nga " UNIFI Communication Inc " dhe/ose nga shtetasi / dëshmitari A.Sh , vlera monetare dhe/ose karta krediti dhe/ ose mbulim/ pagese të shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve të mi dhe/ose pagesa / shpenzime të tjera familjare dhe/ose personale , as interesa të tjera të çdo lloji dhe nuk kam dijeni , për shpenzime të tilla eventuale.

- Secila provë apo mjet kërkimi prove provojnë faktet , se asnjë ndryshim në ligje , nuk është inicuar , as votuar , as miratuar , personalisht , as në bashkëpunim , me qëllimin për të përfituar çdo lloj interesi , vetëm dëshmitari S.M (personalisht , apo bizneset e tij) dhe as me qëllimin për të përfituar unë dhe familja ime , çdo lloj interesi , prej dëshmitarit S.M apo prej bizneseve të tij ; Provojnë faktet , se nuk kam kryer asnjë veprim korruptiv dhe asnjë marrédhénie korruptive , për të ndihmuar dëshimtarin S.M apo bizneset e tij (përfshirë , edhe shoqërinë private tregtare " PLUS " , ku ishin rreth 161 aksionerë) ; Provojnë faktet , se unë nuk kam ndikuar / influencuar dhe nuk jam përfshirë (në asnjë formë dhe mënyrë , as direkt , as indirekt) , personalisht , as në bashkëpunim , për të futur në sistemin bankar dhe/ose për investimin , në pasuri të ndryshme të paluajtshme të ndonjë vlere monetare , pa burim të ligjshëm dhe pa u deklaruar , prej meje , shpenzimi dhe të ardhurat përkatëse , në ILDKPKI.

- Nuk provohet , se unë (me detyrat e mia publike) kam patur ndonjë komunikim timin , me të pandehurin Piro (në detyrën e tij Kryetar i AKEP-it) , për veprime / mosveprime të çdo lloji / forme e mënyre , direkte apo indirekte , personalisht apo në bashkëpunim , në dobi /apo kundër të shoqërive private " PLUS " dhe / ose " VODAFONE " ; Deklaroj , se çdo komunikim , prej meje (në detyrën publike

Kryetar i Kuvendit / Parlamentit , në periudhën kohore përkatëse të viteve 2013 - 2017) ka qenë komunikim zyrtar dhe i dokuemntuar / protokolluar ;

- Provojnë faktet , se ligji nr. 134/2014 dt. 9 / 10 / 2014 " Për ndryshimin e ligjit nr.10304/2010 ' Për sektorin minerar…' " është mbrojtur , në Kuvend , drejtëpërdrejtë , nga Kryeministri Edi Rama , i cili ishte edhe ai (pra , jo vetëm unë) aktor politik kryesor (sepse ai , prej vitit 2013 e në vijim , ishte drejtues i Partisë Socialiste dhe Kryeministër ; ai, kishte shumicën e deputetëve , për të votuar e miratuar çdo ligj) ; Nuk provohet , se unë (me detyrën Kryetar i Kuvendit , në vitet 2013 - 2017) kam patur ndonjé komunikim timin , me Kryeministrin Edi Rama , për të miratuar ndryshimet përkatëse , në ligjin nr. 134/2014 , objekt gjykimi ; Gjithashtu (sipas këtij ndryshimi ligjor) parashikohej /qëllimi të forcohej siguria e minierave dhe kishte eventualisht 200 - 300 operatorë ekonomik / biznese përfitues (pra , ky ligj nuk ka krijuar pasoja juridike / financiare , për asnje subjekt tregtar privat individualisht të përcaktuar) ; Për qëllimet e ligjit relevant / të zbatueshëm nr. 9367/2005 " Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike " provohet qartazi , se vota ime , nuk përbënte çastin e fundit të procesit ligjvënës (gjatë të cilit u vendos miratimi i këtij ligji) , unë nuk kam kryer asnjë veprim paraprak vendimmarrës (të cilat do të ishin thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese , për procesin eventual ligjvënës të miratimit të këtij ligji) ; Veprimtaria / detyra ime publike / Kryetar Kuvendi nuk ishte thelbësore dhe përcaktuese , për miratimin e këtij ligji ; Pjesmarrja ime , qëndrimi im , në këtë proces ligjvënës , për këtë ligj , nuk ka qenë ndikues , në përmbajtjen e tij dhe në miratimin e tij . Gjithashtu ligji nr. 134/2014 nuk është shfuqizuar nga Kuvendi , për fakte se (në kohën e miratimit tij) ka patur eventualisht shkaqe korruptive ;

- Nuk provohet , se unë kam ndikuar në ndonjë çështje përmbarimore publike dhe/ose private ;

- Nuk provohet se unë /me detyrën Kryetar i Kuvendit (në vitet 2013 - 2017) të kem patur personel (në organikën zyrtare të Kuvendit) , me detyrën asistent ; Pra

, edhe dëshmitarja E.G nuk ka qene asistentja ime , në detyrën time publike Kryetar i Kuvendit (në vitet 2013 - 2017) ;

- Secila provë apo mjet kërkimi prove provojnë faktet , se nuk ka llogari bankare , financime dhe shpenzime , që nuk janë deklaruar , në dijeninë time (për ish-partinë LSI) , në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ; Provojnë faktet , se nuk kam transferuar vlera monetare (në mënyrë të kundraligjshme apo të fshehtë) , jashtë territorit të Shqipërisë , për financimin e lobimit politik , midis ish - partisë LSI dhe shoqërisë G.S.I.S . Provojnë faktet , se unë nuk kam dijeni për pagesat e çdo lloji , që ka bërë eventualisht shtetasi Adrian Shatku , në emër e për llogari të ish-partisë LSI dhe për llogari të shoqërisë lobuese amerikane G.S.I.S ;

- Gjithashtu (nga kjo kontratë lobimi politik) provohen , se nuk kam përfituar personalisht , jo vetëm asnjë lloj vlere monetare , por as për interes personal familjar dhe politik . Secila prove apo mjet kërkimi prove provojnë (në vlerësimin e tyre në tërësi) pafajësinë time për çdo akuzë , episode , objekt hetimi dhe gjykimi.

- Provojnë faktet , se dëshmitari K.I , nuk ka qenë asnjëherë , kandidat i Ministrisë përkatëse / shkurtimisht pasqyrohet " METE " , për të qenë ai anëtar në Bordin e entit ÇEZ ;

- Provojnë faktet , se unë nuk kam komunikuar me dëshmitarin S.M dhe as me gruan e tij , për çështjet e mia personale / private e familjare të çdo lloji .

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 23 / 6 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 6 / 2026 ; Kërkuar sa më lart edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026 ;

22). Lista e dëshmitarëve (që unë kërkoj të pyeten , në gjykim) , sipas episodeve përkatëse objekt gjykimi , grupohen si vijon :

Lista e dëshmitarëve për episodin hetimor " ÇEZ – DIA "
Lista e dëshmitarëve për episodin hetimor të lobimeve politike
Lista e dëshmitarëve për episodet hetimore të ashtuquajtura " PLUS , AKEP, VODAFONE dhe UNIFI "
Lista e dëshmitarëve për episodin hetimor të shitjes së Vilës në Qerret
Lista e dëshmitarëve lidhur me akuzat për fshehje pasurie dhe pastrim parash

22/1). Sipas gjëndjes të dëshmive , që do të administrohen në gjykim , do kërkoj , nga gjykata kryerjen e ballafaqimit , midis dëshmitareve ;

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia , për llogari të seancës gjyqësore dt. 29 / 7 / 2026 ;

23). Prokurori kërkon të administrohet , si mjet kërkimi prove sms / mesazhi elektronik vijues eventual i dt. 22 / 6 / 2009 " *Nesër në darkë duhet të takohemi patjetër. Më duhen 200 mijë patjetër. Mos harro* " , konstatuar eventualisht (me proces - verbalin e dt. 28 / 6 / 2009) , tek karta celulare /elektronike me nr. 0682009693 apo tek aparati celular / elektronik (ku ishte instaluar eventualisht , kjo kartë elektronike celulare) , në posedim të dëshmitarit K.I (e lidhur kjo sms /mesazh , me episodin hetimor " ÇEZ - DIA ") ; **Por unë pretendoj** dhe provohet , se oficeri i policisë gjyqësore <u>nuk e ka sqaruar</u> , në kohë reale (në procedimin penal nr. 978 të vitit 2008 të Prokurorisë së Rrethit Tiranë) shkaqet ligjore , për të cilat ai / ky oficer (pasi konstatoi këtë sms / mesazh më dt. 22 / 6 / 2009) , nuk e ka mbajtur / përpiluar procesvebalin , po më dt. 22 / 6 / 2009 (por e përpiloi , pas 6 ditësh / më dt. 28 / 6 / 2009) ; **Referuar** kuptimit të arsyeshëm të neneve 223 e 226/1 të K. Pr. Penale pretendoj dhe provohet , se regjistrimi i këtij mesazhi /sms (kontatuar eventualisht më dt. 22 / 6 / 2009) nuk i është dorëzuar (nga ky oficer) menjëherë /brenda 5 ditëve prokurorit , nga dita e mbarimit të veprimeve ditore eventuale të përgjimit . Ka dyshime të arsyeshme , <u>që ky mesazh / sms është pasqyruar , nga ky oficer , më dt. 28 / 6 / 2009 , pikërisht një ditë para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009 , për arsye të ndryshme</u> (por jo për shkaqe procedurale penale) ; Pretendoj , se **mosveprimi** i oficerit të policisë gjyqësore , në kohë reale (pra , mosmbajtja prej tij e proceverbalit , që

prej dt. 22 / 6 / 2009 dhe mbajtja e procesverbalit më dt. 28 / 6 / 2009 , për konstatimet eventuale të sms / mesazheve të dt. 22 / 6 / 2009) cënon qartazi dhe mjaftueshëm parimin / standartin e objektivitetit / saktësisë / vërtetësisë / besueshmërisë , integritetit dhe autenticitetit të veprimeve hetimore , në procedimin përkatës penal dhe vë në dyshim autenticitetin e regjistrimit të kësaj mesazhi / sms ; Unë kërkoj / pretendoj , se ky mjet kërkimi prove / rezultatet e përgjimit dhe kjo sms / mesazh (referuar procesverbalit të oficerit të policisë gjyqësore dt. 28 / 6 / 2009 " Mbi transkriptimin e bisedave të numrit të telefonit nr. 0682009693 , poseduar nga dëshmitari K.I janë montazh , **janë të papërdorshme** dhe **të mos përdoren** , nga gjykata , kundër meje ;

i). Provat e marra , prej këtij mjeti procedural kërkimi prove / përgjimi të përjashtohen / të mos përdoren , kundër meje , nga gjykata ; Gjykata **të urdhërojë asgjësimin** e procesverbalit të oficerit të policisë gjyqësore dt. 28 / 6 / 2009 dhe asgjësimi i çdo akti tjetër , që lidhen / bazohen / referohen , në këtë përgjim sms /mesazh ;

ii). kërkoj nga gjykata të marrë , si prova shkresore , **kopje të legalizuar** të të gjithë akteve të dosjes gjyqësore penale me nr. vendimi gjyqësor të veçantë penal 75/28 dt. 10 / 6 / 2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , që ka lejuar përgjimin e kartës përkatëse celulare të dëshmitarit K.I;

iii). kërkoj nga gjykata të marrë , si prova shkresore , **kopje të legalizuar** të të gjithë akteve , që ka protokolluar dhe administruar prokurori , në procedimin penal nr. 978 të vitit 2008 (të Prokurorisë së Rrethit Tiranë) , për ekzekutimin / zbatimin e vendimit gjyqësor të veçantë të sipërcituar penal nr. 75/28 dt. 10 / 6 / 2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

iv). kërkoj nga gjykata të marrë , si prova shkresore , **kopje të legalizuar** të të gjithë akteve , që ka protokolluar dhe administruar Prokuroria e Përgjithëshme (Sektori i Përgjimeve) , për ekzekutimin e kërkesës të prokurorit të procedimit penal nr. 978 të vitit 2008 të Prokurorisë së Rrethit Tiranë (lidhur me zbatimin / ekzekutimin e vendimit gjyqësor të veçantë penal të sipërcituar nr. 75/28 dt. 10 / 6 / 2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) ;

v). kërkoj nga gjykata të marrë , si prova shkresore , **kopje të legalizuar të të gjithë akteve** të dosjes gjyqësore penale me nr. vendimi gjyqësor të veçantë penal 75/36 dt. 19 / 01 / 2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , që ka vendosur asgjësimin e regjistrimeve të përgjimit të bisedave te kartës përkatëse celulare të dëshmitarit K.I;

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) ; Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026 ;

24). Prokurori kërkon të merret /pranohet , si provë , intervista e shtetases **V.I** (dhënë prej saj , para gazetarit Fatos Mahmutaj) ; Unë kërkoj të mos përdoret , nga gjykata , kundër meje , si provë dhe as si mjet kërkimi prove , kjo intervistë e saj , sepse ajo nuk është pyetur , në rastin konkret , nga policia gjyqësore / prokurori (por nga gazetari përkatës ; kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) ;

25). Prokurori kërkon të merret / pranohet , si provë , intervista e shtetasit **E.M** (dhënë prej tij , para gazetarit Artan Hoxha) ; Unë kërkoj të mos përdoret , nga gjykata , kundër meje , si provë dhe as si mjet kërkimi prove , kjo intervistë e tij , sepse ai nuk është pyetur , në rastin konkret , nga policia gjyqësore / prokurori (por nga gazetari përkatës ; kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) ; Kjo intervistë e tij mediatike është kundërshtuar , nga ky dëshmitar , kur ai u pyet prej policisë gjyqësore ;

26). Prokurori kërkon të administrohet , si provë shkresore deklarimi i dëshmitarit Jozef Hejsek , dhënë prej tij eventualisht , në Arbitrazhin Tregtar të Vjenes / Austri (lidhur me episodin hetimor ÇEZ - DIA , objekt gjykimi) ; Unë kërkoj , që ky deklarim i shtetasit **J.H** të mos përdoret , nga gjykata , kundër meje , sepse ky Arbitrazh , nuk konsiderohet , as Gjykatë , as organ procedues penal dhe unë , nuk kam qenë i pranishëm , në këtë Arbitrazh , për tu mbrojtur , nga deklarimet e tij eventuale dhe mungonin (ditën e deklarimit tij , në këtë Arbitrazh) garancitë procedurale , lidhur me pozitën time , në atë proces arbitrazhi (kërkuar sa më lart

me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) ;

27). Prokurori pretendon veprime korruptive , lidhur me episodin hetimor , ashtuquajtur shoqëria " PLUS" ; Unë kërkoj të merret , si provë shkresore , ekstrakti historik i personit juridik privat tregtar " Plus Communication " , me NIPT K91811014B , sepse provon faktin , që ky person juridik privat tregtar (përveç shoqërisë private , ku ka aksione dëshmitari S.M) , ka edhe rreth 160 aksionerë të tjerë (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) ;

28). Prokurori pretendon veprime korruptive , lidhur me episodin hetimor " ÇEZ - DIA " ; Unë kërkoj të merren , si prova , aktet vijuese :

i). të merren , në Kryeministri dhe/ose në Ministrinë e Jashtme dhe/ose në Ministritë përgjegjëse , për fushat e Ekonomisë , Tregtisë , Financave shqiptare informacioni , nëse i ndjeri Qazim Tepshi (ish- ambasador në Republikën e Çekisë) , ka qenë i emëruar , nga ndonjë autoritet publik qendror , edhe me detyrën " këshilltar tregtar " , pranë shoqërisë tregtare " ÇEZ " , me seli në Pragë ? Nëse po , cili autoritet publik/zyrtar e ka emëruar ? kur është emëruar ai ? afati i ushtrimit të kësaj detyre , prej tij ? Ky informacion / fakt /e dhënë ka lidhje , edhe me deklarimet e dëshmitarit J.H , dhënë prej tij , në Arbitrazhin Tregtar të Vjenës dhe pretendohet (nga prokurori) , se përbën provë ;

ii). Ti kërkohet me letërporosi , personit juridik tregtar " ÇEZ " , me seli në Pragë informacioni vijues : Nëse ky person juridik administron akte zyrtare , sipas të cilave konfirmohet emërimi i z. Qazim Tepshi , me detyrën këshilltar tregtar , atashuar pranë asaj shoqërie ? nëse po , të dërgohet prej tyre , kopje e legalizuar rregullisht e çdo lloj akti , që ajo administron , lidhur me atashimin eventual , pranë saj të z. Qazim Tepshi ;

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) ;

29). Prokurori pretendon kundër meje të merret /pranohet , si provë , akti / deklarata noteriale nr. 1846 Rp. dt. 22 / 5 / 2024 (redaktuar nga notere Joana Smakaj , me seli në Tiranë) , lidhur me administrimin e deklarimeve të të pandehurave Ema Çoku e Fatime Kryemadhi) ; Unë kërkoj **të mos përdoret** , nga gjykata , kundër meje , në çështjen objekt gjykimi , as si provë dhe as si mjet kërkimi prove (sepse deklarimet noteriale të këtyre dy të pandehurave është marrë në shkelje të neneve 62 e 63 ligjit relevant nr. 110/2018 " Për noterinë " ; kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026) ;

30). Prokurori kërkon të merret / pranohet , si provë , ekspertimi financiar (kryer ky ekspertim , në hetimet paraprake) ; Unë kërkoj nga gjykata , sa vijon :

i). se ekspertimi financiar (referuar metodollogjisë , ku bazohet Prokurori , ekspertja) dhe interpretimet financiare të ekspertes , **nuk kanëfuqi prapavepruese ndaj meje** (për periudhën kohore të viteve 2003 - 2023 , objekt ekspertimi) ; ky ekspertim nuk është i besueshëm ; nuk përbën provë indirekte , ndaj meje dhe (për rrjedhojë) nuk duhet të merren parasysh (si provë) , nga gjykata , në këtë gjykim themeli ;

ii). thirrjen e ekspertes financiare , në gjykim , për të sqaruar / shpjeguar të metat dhe paqartësitë e dukshme përkatëse , lidhur me faktet , parashtrimet , aktet e ligjet relevante (që ka patur parasysh , për këtë ekspertim) dhe për konkluzionet / përfundimet e saj ;

iii). të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri financiar (për periudhën kohore të viteve 2003 - 2023) , objekt ekspertimi aktual , duke thirrur ekspertë të tjerë ose me grup ekspertësh (sepse kërkimet e vlerësimet financiare , ekonomike , kontabile , bankare , tatimore / fiskale , në këtë procedim penal , janë shumë komplekse) ; ky ekspertim të mbështetet parimisht e konkretisht , në metodologjitë e dokumentuara / të botuara / publikuara rregullisht ; ekspertimi të respektojë kriteret / parimet e kuadrit rregullator financiar / ekonomik / kontabël / tatimor / fiskal / bankar etj. të zbatueshëm / relevant , për periudhën kohore të viteve 2003 - 2023

iv). Në veçanti kërkoj të kryhet ekspertim financiar , lidhur me analizën shteruese / ezauruese dhe të plotë financiare të të ardhurave , shpenzimeve , investimeve e kursimeve të mia , për periudhën kohore të viteve Prill të vitit 1992 (koha kur unë u zgjodha deputet) e deri më dt. 31 / 12 / 2002 , në drejtim të sqarimit të faktit , nëse kisha mundësi financiare , në periudhën kohore të viteve 1992 - 2002 dhe/ose të viteve 1992 - 2023 , për të patur / krijuar kursime monetare , deri më dt. 31 / 12 / 2002 ose për të patur mundësi për të krijuar të ardhura , kursime e përballuar shpenzimet deri më dt. 31 / 12 / 2023 , referuar në metodologjitë e dokumentuar / të botuara / publikuar rregullisht (refruar gjithashtu kritereve / parimeve dhe kuadrit rregullator financiar / ekonomik / kontabël / tatimor / fiskal / bankar etj. të zbatueshëm / relevant , për periudhën kohore të viteve 1992 - 2002 dhe/ose 1992 - 2023) ; Nëse po , pretendoj se ky kursim monetar duhet të integrohet , edhe në analizën time financiare të viteve 2003 e vijim (viti kur fillon kryerja e analizës financiare , prej Prokurorit / ekspertes financiare) ; Ekspertimi të përfshijë në analizën / konkluzionet përkatëse financiare , edhe dietat (sipas kuadrit ligjor relevant , që kam pretenduar , gjatë seancave të mëparshme gjyqësore) ; Ekspertimi të garantojë / sigurojë trajtim objektiv , të arsyeshëm , proporcional dhe jodiskriminues . Pretendoj , se përjashtimi (gjatë hetime paraprake) , nga analiza financiare / ekspertimi financiar , të periudhës kohore financiare të viteve 1992 -2002 , është i qëllimtë , për shkaqe arbitrare dhe të paarsyeshme ;

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 09 / 7 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 29 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 29 / 7 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 22 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 24 / 9 / 2026 ;

31). **Të merret** , si provë dhe t'i nënshtrohen debatit gjyqësor , **deklarimi i të pandehurës Monika** , në gjykimin e çështjes së veçantë penale , ku është disponuar me vendimin e veçantë gjyqsor penal nr. 130 dt. 23 / 10 / 2024 të Gj.K.K.O e shkallës Parë , me objekt " Verifikimin e kushteve dhe kritereve të zbatimit të masës së sigurimit " ; Të administrohen / vlerësohen / kihen parasysh , si provë , edhe

deklarimet e të pandehurës Monika , në gjykimin e kësaj çështje penale themeli (në seancat e dt. 09 / 7 / 2026 e dt. 29 / 7 / 2026) , sepse (me këto deklarime të saj) pretendoj , sa vijon :

i). Se e pandehura Monika , nuk ka bashkëpunuar me mua , në asnjë lloj dobie dhe për asnjë lloj interesi të dëshimtarit Adrian Shatku , lidhur me episodin hetimor të AKEP-it ; Se unë nuk kam ndërhyrë , tek ndonjë organ shtetëror / publik , lidhur me episodin hetimor të AKEP-it ; Se unë nuk kam biseda / komunikime /mesazhe , me dëshmitarin A. , lidhur me episodin hetimor të AKEP-it ;

ii). Se e pandehura Monika nuk ka bashkëpunuar , në asnjë lloj forme e mënyre , me mua , per të ndikuar tek veprimtaria publike e të pandehurit Piro Xhixho ; Se unë nuk kam ndikuar personalisht apo në bashkëpunim , në asnjë lloj forme e mënyre tjetër , tek veprimtaria publike e të pandehurit Piro Xhixho ;

iii). Se e pandehura Monika ka qenë e pavarur , në veprimet e saj dhe e pandikuar , në asnjë rast , prej meje ;

iv). Se veprimet dhe udhëtimet , objekt akuze , të të pandehurës Monika , nuk janë bërë me dijeninë time (pra , unë nuk kam shprehur ndërgjegjen dhe vullnetin tim , lidhur me veprimet dhe udhëtimet e saj , objekt akuze) ;

v). Se e pandehura Monika nuk ka bashkëpunuar , me mua , në asnjë lloj forme e mënyre , lidhur me episodin hetimor të UNIFI-s ; Se unë nuk kam ndërhyrë tek ndonjë organ shtetëror / publik , lidhur me episodin hetimor të UNIFI-s ;

vi). Se komunikimet / mesazhet / bisedat e dt. 18 / 11 / 2014 objekt akuze , të të pandehurës Monika , nuk kanë lidhje me episodet hetimore të AKEP-it dhe/ose UNIFI-së (por janë komunikime / mesazhe / biseda , lidhur me shkollimin e vajzës tonë Bora) ;

vii). Nuk ka biseda / komunikime /mesazhe , midis meje dhe të pandehurës Monika , për të ndikuar unë , tek ndonjë organ shtetëror / publik dhe për asnjë lloj përfitimi ;

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia , për llogari të seancave gjyqësore të dt. 09 /7 / 2026 dhe dt. 29 / 7 / 2026 ;

32). Prokurori kërkon të merret / pranohet , si provë dhe mjet kërkimi prove , kontrolli i banesës (ku banonte edhe e pandehura Monika) , kqyrja e aparatit calular dhe kqyrja kartës celulare të instaluar , konkluzionet e ekspertimit të këtij aparati celular , konkluzionet e ekspertimit kompjuterik të kartës celulare , të dhënat / informacioni / mesazhet /sms dhe çdo lloj komunikimi tjetër elektronik / virtual , çdo provë tjetër direkte ose indirekte dhe procesverbalet e mbajtura (si rezultat i këtyre veprimeve/akteve procedurale dhe mjeteve të kërkimit të sipërcituara) ; **Unë kërkoj** , që :

i). veprimi procedural i kontrollit të kësaj banese , kqyrja e aparatit calular me nr. IMEI 013428000432516 (dhe kqyrja kartës celulare të instaluar , në këtë aparat) , konkluzionet e ekspertimit të këtij aparati celular (dhe konkluzionet e ekspertimit të kartës celulare të instaluar , në këtë aparat) , të dhënat / informacioni / mesazhet /sms dhe çdo lloj komunikimi tjetër elektronik /virtual (i rikuperuar / përfituar , sipas këtyre ekspertimeve) , çdo provë tjetër direkte ose indirekte (të siguruar pas kontrollit të banesës dhe pas kqyrjeve të sipërcituara) , procesverbali i i kontrollit të banesës dhe procesverbalet e tjera të mbajtura (si rezultat i këtyre veprimeve /akteve procedurale dhe mjeteve të kërkimit të sipërcituara) , **nuk duhet të përdoren** , nga Gjykata , si prova e mjet kërkimi prove , për asnjë lloj episodi , objekt akuze , ndaj meje ; sekuestrimi dhe procesverbali i sekuestrimit të sendeve (aparati celular / mobil dhe karta përkatëse celulare , administruar ky sekuestrim , në fq. 139 të fashikullit hetimor nr.60 të Prokurorit) , nuk përbëjnë provë shkresoredhe as provë indirekte ; se telefoni celular me nr. IMEI 013**4**28000432516 apo me nr. IMEI 01328000432516 (gjetur / dorëzuar eventualisht , në këtë banesë) dhe karta përkatëse celulare (e instaluar eventualisht , në këtë telefon) , **nuk përbëjnë prova materiale** ;

ii). **nuk provohet** / nuk identifikohet , **nëse telefoni celular** (i gjetur /dorëzuar eventualisht , në këtë kontroll banese **ka** nr. IMEI 013**4**28000432516 (referuar procesverbalit të kontrollit të kësaj banese) **apo ka** nr. IMEI 01328000432516 (referur vendimit dt. 23 / 11 / 2023 të prokurorit , që ka vendosur " kryerjen e ekspertimit kompjuterik ....") ;

iii). **ekspertimet kompjuterike** nr. 260 dt. 21 / 12 / 2023 e nr. 16 dt. 06 / 02 / 2024 (kryer në hetimet paraprke) , **nuk përbëjnë provë indirekte , ndaj meje** , për çdo akuzë/episode , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe aktet e tjera procedurale , që referojnë , në këto dy ekspertime kompjuterike , nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për çdo akuzë/episode , objekt gjykimi ;

iv). provohet , se të dhënat elektronike / e-maile (me përmbajtje , në gjuhën shqipe dhe gjuhë anglisht) , të përfituara / shkarkuara / ekstraktuara eventualisht , nga telefoni përkatës celular (shih fq. 1 - 52 të fashikullit hetimor nr. 64 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore dhe/ose eksperti , që i ka ekstraktuar / shkarkuar elektronikisht ato ; nuk sqarohet /argumentohet / tregohet shkaku përkatës ; **Provohet** , se prokurori ka caktuarpërkthyese (shih fq. 1 , po të këtij fashikulli hetimor nr. 64) ; **Provohet** , se përkthimi në gjuhën shqipe (i këtyre e-maile të gjuhës angleze) administrohen në fq. 62 - 229 (po të këtij fashikulli nr. 64 të Prokurorit) ; Por provohet gjithashtu dhe **pretendoj , se** përkthyesja e caktuar (përveçse aktet e përkthyera , **nuk kanë datën e përkthimit** ; shih fq. 60 , 145 , 229 të këtij fashikulli) , por edhe deklarata e saj/përkthyeses (për saktësinë e përkthimit prej saj ; shih po fq. 145 , 229 të këtij fashikulli) **nuk ka datën e këtij deklarimi** ; Provohet , se e-maili i dt. 08 / 10 / 2013 (shih fq. 7 të këtij fashikulli hetimor nr. 64) , është në gjuhën shqipe dhe **nuk përbënte objekt përkthimi** !!!! (ky " përkthim " është , në fq. 67 të fashikullit hetimor nr. 64 , ku rezulton se përkthyesja ka pasaktësi , lidhur me datën e e-mail dhe me përmbajtjen e saj , sepse ka shtuar gërma e fjalë); Pretendoj , se gjatë hetimit penal , nuk janë zbatuar rregullat / format e caktuara , për përkthimin (në gjuhën shqipe) të këtyre akteve /e-maileve (dhe te administruara , në fq. 62 - 229 të fashikullit hetimor nr. 64 të Prokurorit) ; Këto akte /e-maile (të përkthyera në gjuhën shqipe) **nuk përbëjne provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte/ e-maileve nuk kane fuqi provuese dhe nuk përbëjne provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

v). **kërkoj** nga gjykata të merren , si prova shkresore zyrtare : **procesverbali i seancës gjyqësore** dt. 19 / 11 / 2023 të GJ.K.K.O të Shkallës së Parë (ku është

disponuar , sipas vendimit të saj gjyqësor të veçantë penal të sipërcituar nr. 469 dt. 19 / 11 / 2023) **dhe aktet e njoftimit** (nga kjo gjykatë) , në drejtim të prokurorit , për këtë vendim gjyqësor (për të **qartësuar , kohën** , se kur është shpallur ky vendim gjyqësor ? kur janë kryer veprimet e njoftimit /marrjes / dorëzimit të këtij vendimi gjyqësor ? ku dhe si administrohen , këto akte procedurale , nga kjo gjykatë) ;

vi). kërkoj nga Gjykata thirrjen në gjykim të ekspertëve (që ka kryer këtë ekspertim , në hetimet paraprake) , për sqarime dhe për plotësimin e ekspertimit tyre (sepse kërkohen njohuri / vlerësime të posaçme e komplekse kompjuterike) ose

vii). eksperti/tët të **përsërisin veprimet** , duke kryer ekspertët , edhe një herë (në prani të palëve dhe para gjykatës) , veprimin procedural të rikuperimit të të dhënave / komunikimeve / informacionit , që ka telefoni me nr. IMEI 013428000432516 dhe karta e saj (në përdorim të të pandehurës Monika) ose Gjykata të vendosë **kryerjen e një ekspertim të ri** , nga eksperttët ekzistues ose ti besohet detyra një grupi ekspertësh të huaj ;

viii). Pretendoj , se komunikimet / bisedat eventuale , të marra /administruara , nga kontrolli i banesës dhe kqyrja e telefonit me nr. IMEI 013428000432516 (që pretendohet në përdorim të të pandehurës Monika) dhe nga rikuperimi elektronik i të dhënave/informacionit (në shkelje të ndalimeve të parashikuara në mënyrë specifike , nga Kushtetuta dhe nga K. Pr. Penale) , **nuk duhet të përdoren** , ndaj meje .

ix). Kërkoj **të printohen** dhe të administrohen , si prova , **1734** komunikimet elektronike eventuale , që përmbanin dy adresat e-maileve (pra , kërkoj printimin e diferencës të këtyre komunikimeve elektronike , sepse nga 1786 komunikimet totale eventuale , të ruajtura dhe të gjetura , në dy adresat e e-mail **erametaj@gmail.com** dhe **ashatku@unificom.com** , policia gjyqësore ka printuar fizikisht , vetëm 52 komunikime) ; Theksoj , se këto prova shkresore / komunikimet elektronike (në formën e dokumentit) , kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe mjaftueshëm , me pafajësinë time ;

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 22 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 24 / 9 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 29 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 01 / 10 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026 ;

33). Prokurori kërkon të merren , si prova shkresore akti nr. 2061/1 Prot. dt. 29 / 4 / 2011 i shoqërisë private tregtare mobile " AMC " dhe relacioni i oficerit të policisë gjyqësore dt. 05 / 5 / 2011 " Mbi analizimin e tabulateve të numrit celular … " (ku ndër të tjera , pretendohet biseda e poseduesit të kartës celulare , objekt përgjimi , me poseduesit e kartave tjera celulare ILIR META etj. ; shih fq. 23 , 25 - 37 të fashikulli hetimor nr. 6 të Prokurorit , bashkalidhur dosjes gjyqësore të themelit) ; Unë kërkoj , që këto akte **nuk duhet të përdoren** , si prova ndaj meje , sepse , **nuk janë njësuar me origjinalin** e dokumentacionit , që administronte Gjykata e Lartë . Gjithashtu provohet , se edhe vetë akti nr. 2061/1 Prot. dt. 29 / 4 / 2011 i shoqërisë " AMC " , **nuk identifikon** nëpunësin e saj (që e ka lëshuar / nxjerrë këtë akt , në emër të kësaj shoqërie) dhe **nuk ka nënshkrimin** e këtij nëpunësi (ky akt përmban vetëm vulën e shoqërisë " AMC ") . Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026 ;

34). Prokurori kërkon të merren , si prova shkresore , aktet financiare / bankare (të marra , nga policia gjyqësore , pranë personit juridik privat tregtar bankar " Credins Bank " ; shih fq. 150 - 262 të fashikullit nr. 2 të Prokurorit , që i bashkalidhet të dosjes gjyqësore të masës të sigurimit ; akte bankare të cilat përbëjnë , ndër të tjera , praktikën e transferimit eventual bankar të vlerave monetare , nga llogaria bankare e ish- partisë LSI , pranë kësaj banke , në llogarinë përkatëse bankare të kompanisë amerikane private G.S.I.S dhe veprime të tjera bankare ; këto akte kanë lidhje me episodin hetimor të lobimeve) ; Unë pretendoj , se këto akte / kopjet e fq. 171 (faqja prapa saj) , 177 - 190 , 216 - 242 , 250 - 254 , të marra nga SPAK , **nuk janë njësuar** , seicila prej tyre , nga kjo bankë , me origjinalin e tyre ; Pretendoj , se aktet / kopjet e fq. 150 - 157 , 172 - 176 , 191 - 215 , 243 - 249 , 255 - 262 , nuk përmbajnë , seicila prej tyre , **datën** , kur kjo Bankë / nëpunësi i saj përgjegjës ka vërtetuar njësinë e kopjeve të akteve (të marra

nga SPAK) , me origjinalin e tyre (pra , këto akte përmbajnë vetëm vulën dhe nënshkrimin e kësaj banke) ; Pretendoj , se aktet / kopjet e fq. 158 - 171 , nuk përmbajnë , seicila prej tyre , **nënshkrimin nëpunësit përgjegjës** të kësaj banke , që ka vërtetuar njësinë e kopjeve të akteve (të marra nga policia gjyqësore) , me origjinalin e tyre (pra , këto akte përmbajnë vetëm vulën tip të kësaj banke) ; Prandaj aktet e sipërcituara **nuk përbëjnë prova shkresore , kundër meje ,** për çdo akuzë objekt gjykimi , ndaj meje (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

35). Prokurori kërkon të merren , si prova shkresore aktet financiare / bankare (të marra , nga policia gjyqësore , pranë personit juridik privat tregtar bankar " Credins Bank " ; shih fq. 114 - 190 të fashikullit nr. 4 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të masës të sigurimit) ; Pretendoj , se asnjë prej këtyre akteve , **nuk ka shënimin** , nga kjo Bankë " e njëjtë me origjinalin " dhe **nuk identifikohet** (në procesverbalin e oficerit të policisë gjyqësore) detyra / kompetenca e dorëzuesit të këtyre akteve , në emër të kësaj Banke.; Pretendoj , se këto akte bankare **nuk përbëjnë prova shkresore , kundër meje ,** për çdo akuzë objekt gjykimi , ndaj meje (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

36). Me vendimin e dt. 09 / 6 / 2025 të prokurorit , në procedimin penal objekt gjykimi , është vendosur zgjatja e afatit të hetimeve , për periudhën kohore , nga dt. 10 / 6 / 2025 - 10 / 9 / 2025 (shih fq. 319 - 324 të fashikullit hetimor nr.5 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Provohet , se prokurori ka formuluar aktet , për njoftimin tim (për këtë vendim zgjatje) , nëpërmjet I.E.V.Penale " Jordan Misja " (ku unë qendroj i paraburgosur) ; Provohet , se unë dhe/ose avokati im **nuk jemi njoftuar , për këtë vendim zgjatje** , nuk **identifikohet dorëzuesi** i këtij vendimi (në adresën time) , nuk ka nëshkrimin e tij/dorësuesit dhe **nuk identifikohet , se cili ka nënshkruar** (në emrin tim) , marrjen e këtij vendimi ; Prandaj kërkoj , që çështja / procedimi hetimore , ndaj meje , të shqyrtohet , vetëm mbi bazën e provave , vendimeve të prokurorit dhe akteve të policisë gjyqsore të kryera dhe të administruara , në fashikujt hetimor , brenda afatit ligjor të hetimeve (**deri më dt. 10 / 6 / 2025**) ; Kërkoj

që të mos përdoren nga gjykata , në këtë gjykim , kundër meje , provat , vendimet e prokurorit dhe aktet /veprimet e policisë gjyqsore të kryera dhe të administruara , në fashikujt hetimor , pas dt. 10 / 6 / 2025 e në vijim (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

37). Prokurori kërkon të merren , si prova shkresore aktet e Entit Rregullator të Energjisë (shih fq. 2 - 8 , të fashikullit hetimor nr. 8 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Pretendoj , se nuk identifikohet detyra / kompetenca e dorëzuesit të këtyre akteve (në emer të ketij enti publik) ; provohet se aktet e mara nga policia gjyqësore , pranë këtij enti (administruar në fq. 9 - 231 , po në këtë fashikull nr. 8 të Prokurorit) , **nuk janë njësuar me origjinalin** e tyre të administruar , në këtë ent publik ; **Referuar** procesverbalit të sipërcituar të oficerit të policisë gjyqësore dt. 29 / 12 / 2021 (sipas të cilëit theksohet , ndër të tjera , se " … *janë marrë **200** fletë* ..") provohet qartazi , se aktet e marra , në këtë ent (dhe të administruar në fq. 9 - 231 , po në këtë fashikull nr.8 të Prokurorit) janë gjithësej **223** fletë (pra , nuk provohet qartazi , nëse janë marrë , pranë ERE-s , 200 fletë apo 223 fletë ?) ; Prandaj pretendoj , se aktet e mara , pranë këtij enti (administruar në fq. 9 - 231 , po në këtë fashikull nr. 8 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë** , kundër meje , për çdo akuzë , objekt gjykimi , po ndaj meje , të lidhura mjaftueshëm me këto akte (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

38). **Referuar** vendimit dt. 12 / 3 / 2024 të Prokurorit " Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave " , në Prokurorinë e Përgjithëshme (shih fq. 4 të fashikullit nr. 6 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; **referuar** procesverbalit dt. 13 / 3 / 2024 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave " , në Prokurorinë e Përgjithëshme (shih fq. 1 , po në këtë fashikull nr. 6 të Prokurorit , sipas të cilit theksohet , ndër të tjera , se " …*kopje e shkresave të cilat u fotokopjuan dhe u njësuan me orgjinalin*….") **provohet** , se fq. 6 - 11 (po të këtij fashikulli nr. 6 të Prokurorit) **nuk përmbajnë datën** (se kur janë njësuar këto akte , me orgjinalin e tyre) , **nuk identifikohet** / pasqyrohet nëpunësi përgjegjës i Prokurorisë së Pëgjithëshme dhe **as detyra** / kompetenca e tij (që ka vërtetuar njësinë me origjinalin e tyre);

i). Provohet , se akti nr. 1100/1 Prot. dt. 15 / 3 / 2011 i shoqërisë private tregtare mobile " AMC " (sipas akt të cilit , vihet në dijeni … *për kartën celulare , që posedon eventualisht shtetasi ILIR Rexhep Meta* … ; shih fq. 8 , po të këtij fashikulli nr. 6 të Prokurorit) , **nuk identifikon** nëpunësin e saj përgjegjës (që e ka lëshuar / nxjerrë këtë akt , në emër të kësaj shoqërie) dhe **nuk ka nënshkrimin** e këtij nëpunësi (pra , ky akt përmban vetëm vulën e shoqërisë " AMC ") .

ii). **Referuar** dy procesverbaleve të tij të dt. 20 / 3 / 2024 " Mbi analizimin e tabulateve telefonike …" (shih fq. 12 - 22 e vijues , po të këtij fashikulli nr. 6 të Prokurorit) **provohet** , se oficeri i policisë gjyqësore ju referohet (ndër të tjera) , në këto procesverbale të tij , edhe aktit nr. 100/1 Prot. dt. 15 / 3 / **20211** të shoqërisë private " AMC " ; Edhe prokurori i referohet aktit nr. 1100/1 Prot. dt. 15 / 3 / **20211** të shoqërisë private tregtare mobile " AMC " (shih fq. 33 të kërkesës tij , për gjykimin në themel të kësaj çështje) ; Por aktet eventuale nr. 100/1 Prot. dt. 15 / 3 / **20211** dhe nr. 1100/1 Prot. dt. 15 / 3 / **20211** të shoqërisë private " AMC " , nuk rezultojnë / nuk provohet të jenë kqyrur e marrë , në Prokurorinë e Përgjithëshme (shih procesverbalin e sipërcituar dt. 13 / 3 / 2024 ; shih fq. **1** po të fashikullit nr. 6 të Prokurorit) ; Gjithashtu viti **20211** i akteve të sipërcituara përkatësisht nr. 100/1 Prot. dhe nr. 1100/1 Prot. të shoqërisë private " AMC " (që referon prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore) , **nuk përputhet** me rendin kohor objektiv dhe **nuk kuptohet** qartë , se çfarë viti duhen nënkuptuar , keto akte , indirekt dhe në mënyrë të arsyeshme ;

iii). Meqenëse nuk është provuar rregullisht , që unë të kem kërkuar me shkrim (pranë shoqërisë private tregtare mobile " AMC ") posedimin e kartës celulare me nr. 0682031701 ; Meqenëse akti nr. 1100/1 Prot. dt. 15 / 3 / 2011 i shoqërise private " AMC " përmban të metat / parregullsitë e formës të sipërcituar ; Meqenëse nuk është provuar rregullisht , që unë të kem kërkuar me shkrim (pranë shoqërisë private tregtare mobile " Eagle Mobile ") posedimin e ndonjë karte celulare (shih fq. 33 të kërkesës të prokurorit , për gjykimin e kësaj çështje ; shih fq. 8 e vijues , po të këtij fashikulli nr. 6 të Prokurorit) ; Në përputhje me aktet , faktet dhe për shkaqet e sipërcituara **pretendoj** , se akti nr. 1100/1 Prot. dt. 15 / 3 / 2011 i shoqërisë private " AMC " , dy procesverbalet e oficerit të policisë gjyqësore të dt. 20 / 3 / 2024 (shih fq. 12 - 22 e vijues , të fashikullit hetimor nr. 6 të

Prokurorit) ” Mbi analizimin e tabulateve telefonike …” (procesverbale të cilat , referojnë /bazohen tek akti nr. 1100/1 Prot. dt. 15 / 3 / 2011 i shoqërisë private “ AMC “) dhe procesverbali dt. 27 / 12 / 2024 i oficerit të policisë gjyqësore ” Mbi analizimin e tabulateve telefonike …” (shih fq. 343 - 370 të fashikullit hetimor nr. 63 të Prokurorit) , nuk përbëjnë provë shkresore (në formën e dokumentave , sipas kuptimit të arsyeshëm të neneve 149/1 e 191 të K. Pr. Penale) , ndaj meje dhe (këto akte) **nuk duht të përdoren , si prova , ndaj meje** , për çdo akuzë objekt gjykimi , ndaj meje (akuza të cilat , janë të lidhura me këto akte të shoqërive private tregtare mobile “ AMC “ , “ Eagle Mobile " dhe me këto procesverbale të policisë gjyqësore) ; Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 29 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 01 / 10 / 2026 ;

39). Provohet se aktet vijuese :

i). Deklarata në gjuhën angleze dt. 26 / 10 / 2014 e dëshmitarit J.H , në Pragë /Çeki (shih fq. 35 - 45 , 57 të fashikullit nr. 2 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ;

ii). Marrveshja e dt. 01 / 9 / 2010 , në gjuhën angleze , lidhur midis palëve/shoqërive “ OSHEE “ - “ DIA “ (shih fq. 123 - 138 , 155 , po të këtij fashikulli nr. 2 të Prokurorit) ;

iii). Marrveshja e dt. 01 / 02 / 2011 , në gjuhën angleze , lidhur midis palëve /shoqërive “ ÇEZ “ - “ DIA “ (shih fq. 192 - 204 , 256 , po të këtij fashikulli nr. 2 të Prokurorit) ;

iv). Deklaratat në gjuhën angleze të dëshmitarit E.M (shih fq. 42 , 45 - 61 , 116 - 140 , 166 të fashikullit nr. 3 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ;

v). e- mailet në gjuhën angleze , midis shoqëria private “ DIA “ - Oligert Kume ; njoftime të ndryshme , në gjuhën angleze ; komunikimet , në gjuhën angleze ,

midis shtetasve / dëshmitarëve W.H – E.M , E.M - Romeo Kara (shih fq. 42 , 62 - 82 , po të këtij fashikulli nr. 3 të Prokurorit) ,

janë përkthyer (nga gjuha angleze , në gjuhën shqipe) nga i njëjti përkthyes dhe noterizimi i këtyre përkthimeve , është vërtetuar vetëm nga notere Natasha Xhaçka (me seli në Tiranë) ;

39/1). Por provohet , se përkthyesi **nuk identifikon / nuk përcakton ditën** , se kur i ka përkthyer ai , secilin akt të sipërcituar ; ndërsa noterja **nuk identifikon /** nuk përcakton (në aktet e saj noteriale) **ditën** kur është paraqitur (para saj) përkthyesi ; Në përputhje me faktet dhe për shkaqet e sipërcituara pretendoj , se aktet e sipërcituara (të noterizuara nga notere Natasha Xhaçka) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave) , kundër meje , për çdo akuzë , objekt gjykimi , po ndaj meje , të lidhura me këto akte (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026);

40). **Referuar** vendimit dt. 23 / 3 / 2023 të Prokurorit " Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave " (shih fq. 1 të fashikullit nr. 11 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; **referuar** procesverbalit dt. 24 / 3 / 2023 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave " (shih fq. 2 - 4 , po në këtë fashikull nr. 11 të Prokurorit) ,

i). **provohet , se** fq. 5 - 84 (po të këtij fashikulli nr. 11 të Prokurorit , sipas të cilave pretendohet , se janë kqyrur e marrë aktet për formimin /krijimin e pasurisë së paluajtëshme nr.102/21 , regjistruar në volumin 20 , fq.31 , të ndodhur në Zonën Kadastrale 3101 , fshati Qerret , Rrethi Kavajë , qarku Tiranë , në emër të shtetasve Samir Mane , Baton Haxhiu etj.) , **nuk përcaktojnë vendin** ku (policia gjyqësore) i kqyri dhe i mori këto akte ;

ii). **provohet** , se këto akte **nuk janë njësuar me origjinalin e tyre** (nga nëpunësi përgjegjës , që i administronte ato) ;

iii). **provohet** , se nëpunësi përgjegjës , nuk e përcakton **datën** , se kur i vulosi këto akte (pra , këto akte përmbajnë vetëm vulën dhe nënshkrimin) ;

iv). **provohet** , se në këto akte , **nuk identifikohet** nëpunësi përgjegjës , që i administronte ato dhe nuk identifikohet **detyra** / kompetenca e tij ;

v). **provohet** , se nuk identifikohet , as detyra e personit , që ia dorëzoi , këto akte , policisë gjyqësore ;

40/1). Në përputhje me faktet dhe për shkaqet e sipërcituara pretendoj , se aktet e administruara në fq. 5 - 84 (të këtij fashikulli nr. 11 të Prokurorit) , **nuk duhet të përdoren** , si prova , ndaj meje , për çdo akuzë objekt gjykimi , ndaj meje (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

41). Prokurori kërkon të merren , si prova shkresore aktet financiare / bankare (të marra , nga policia gjyqësore , pranë personit juridik privat tregtar bankar " Credins Bank " ; shih fq. 89 - 168 të fashikullit nr. 11 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ; akte bankare të cilat përbëjnë , ndër të tjera , praktikën e veprimeve të asgjësimit të dokumentave të ndryshme bankare të kësaj Banke , për vitet 2008 - 2010 , veprimet e ndryshme bankare të kryera / urdhëruara , në mardhënie me këtë Bankë , nga dëshmitarja E.G etj.) ; Por provohet se :

i). Akti në fq. 87 të këtij fashikulli 11 të Prokurorit , **nuk identifikon detyrën e nëpunësit përgjegjës** / dorëzuesit të këtyre akteve , në emër të kësaj Banke ;

ii). Kopjet e fq. 89 - 168 , **nuk janë njësuar me origjinalin e tyre** ;

iii). Prandaj pretendoj , se këto akte bankare (shih fq. 89 - 168 të këtij fashikull nr. 11 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova shkresore (në formën e dokumentave) , kundër meje ,** për çdo akuzë objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte bankare , nuk përbëjnë prova shkresore , kundër meje , për çdo akuzë objekt gjykimi (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 09 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026);

42). **Referuar** vendimit dt. 23 / 5 / 2023 të Prokurorit " Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave " (shih fq. 212 , po në këtë fashikull nr. 11 të Prokurorit) ; **Referuar** procesverbalit dt. 25 / 5 / 2023 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave " , nga noteri Arian Mërkuri , me seli në Tiranë (shih fq. 213 , po në këtë fashikull nr. 11 të Prokurorit) provohet , se kopjet e fq.214 - 251 (të cilat përfshijnë , ndër të tjera , kontratën noteriale të kredisë dt. 26 / 5 / 2010 të noterit Dusho Dusha , me seli në Tiranë , të lidhur midis palëve " Banka Credins " - Monika Kryemadhi , me dorëzanës ILIR META dhe akte të tjera) , **nuk janë njësuar me origjinalin e tyre** , nga ky noter ; Prokurori kërkon të merren , këto akte si prova shkresore ;

42/1). Por pretendoj , se këto akte (shih fq. 214 - 251 të këtij fashikull nr. 11 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave) , ndaj meje (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 09 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026);

43). **Referuar** akteve të fq.175 - 430 (shih fashikullin nr. 12 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ; akte të cilat përbëjnë , ndër të tjera , deklaratën noteriale të vitit 2019 të palëve ILIR META etj. - Tahir Çelmanaj , para noterit Julian Zhelegu , me seli në Tiranë dhe veprime të tjera juridike) provohet , se **nuk kanë proceverabal** të marrjes tyre (nga oficeri i policisë gjyqësore) dhe **nuk janë njësuar me origjinalin e tyre** (që administron enti A. SH. Kadastrës Tirana - Jug) ;

43/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Por unë pretendoj , se këto akte (shih fq. 175 - 430 të këtij fashikull nr. 12 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave) , ndaj meje (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 09 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

44). **Referuar** procesverbalit dt. 07 / 02 / 2024 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen e dokumentave " (shih fq. 3 , 4 të fashikullit nr. 13 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Megjithëse përcaktohet , në këtë procesverbal , se " …*dokumentat u morën* …" provohet , që aktet përkatëse të protokollit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës , nuk

i bashkohen këtij fashikulli të pokurorit (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 09 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026);

45). **Referuar** procesverbalit dt. 12 / 02 / 2024 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen e dokumentave " , në Bankën Credins , dega e saj qendrore Tiranë ; (shih fq. 57 , po në këtë fashikull nr. 13 të Prokurorit , sipas të cilit theksohet , ndër të tjera , se " *…u morën kopje të dokumentave të njësuar me origjinalin ….*") **provohet** , se aktet e fq. 59 - 79 (po të këtij fashikulli nr. 13 të Prokurorit , akte të cilat përbëjnë , ndër të tjera , transfertat bankare të klientëve , nga kjo Bankë , në adresë të entit privat " Lanserhov GMBH " , për vitet 2013 , 2014 etj.) , **nuk janë njësuar me origjinalin e tyre** dhe nuk përcaktohet **detyra nëpunësit** përgjegjës të kësaj Banke (që dorëzoi aktet) ; Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ;

45/1). Por pretendoj , se këto akte bankare (shih fq. 59 - 79 të këtij fashikulli nr. 13 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave) , ndaj meje dhe (këto akte) **nuk mund të përdoren** , si prova , ndaj meje , për çdo akuzë objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte bankare , nuk përbëjnë prova shkresore , kundër meje , për çdo akuzë objekt gjykimi (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 09 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

46). **Referuar** procesverbalit dt. 12 / 7 / 2023 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale " , në sistemin elektronik publik policor TIMS (lidhur me hyrje - daljet e mia eventuale etj. , për vitet 2013 - 2015 etj.) ; Megjithëse janë printuar të dhënat provohet , se fq.12 - 32 (shih fashikullin nr. 17 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) **nuk janë nënshkruar** nga oficeri i policisë gjyqësore ; Gjithashtu , nuk rezulton printimi i këtyre të dhënave , për mua (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 09 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ; Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ;

46/1). Prandaj pretendoj , se këto akte të policisë gjyqësore (shih fq. 12 - 32 të këtij fashikulli nr. 17 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave) , ndaj meje dhe (këto akte) **nuk mund të përdoren** , si prova , ndaj meje , për çdo akuzë objekt gjykimi (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

47). **Referuar** procesverbalit dt. 11 / 9 / 2023 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen e kompjuterit dhe marrjen e dokumentave " , në Bankën Credins (lidhur me informacionin e pagesave të shkollës , për shtetasit Besar Metaj etj.) provohet , se aktet bankare të fq. 36 - 42 të fashikullit nr. 17 të Prokurorit (që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) , **nuk janë njësuar me origjinalin e tyre** ; Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Pretendoj , se këto akte bankare (shih fq. 36 - 42 të këtij fashikulli nr. 17 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave) , ndaj meje (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 08 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 10 / 9 / 2026) ;

48). **Referuar** procesverbalit dt. 12 / 9 / 2023 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen e kompjuterit dhe marrjen e dokumentave " , pranë personit juridik privat tregtar bankar " Credins Bank " (shih fq. 55 , të fashikullit nr. 17 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) provohet , se kopjet e fq.56 - 58 (akte bankare të cilat përbëjnë , ndër të tjera , praktikën e akteve / veprimeve të transferimit të vlerave monetare , jashtë vendit , nga llogaria bankare e ish - Partisë LSI , në llogarinë bankare të kompanisë amerikane G.S.I.S.) , **nuk janë njësuar me origjinalin** e tyre dhe **nuk identifikohet** detyra e nëpunësit përgjegjës , që ka printuar aktet (në emër të kësaj Banke) ; procesverbali i sipërcituar i policisë gjyqësore **është me korigjime** (lidhur me datën e përpilimit ; pra , nuk kuptohet qartazi , nëse ky procesverbal është mbajtur më dt. 11 apo 12 / 9 / 2023) ; Data e këtij akti , nuk mund të saktësohet me siguri procedurale) ;

48/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore dhe këto akte kanë lidhje me episodin hetimor të lobimeve ; Por unë pretendoj , se këto akte (shih fq. 55 - 58 të këtij fashikull nr. 17 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova**

shkresore (në formën e dokumentave) , ndaj meje ; Për rrjedhojë , edhe referimi , në këto akte bankare , nuk përbëjnë prova shkresore , për çdo akuzë objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 16 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 17 / 9 / 2026) ;

49). **Referuar** procesverbalit dt. 16 / 3 / 2024 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale " (janë të dhënat elektronike eventuale e- mail etj. , të mbërritura apo të dërguara , nga ish- zyrtarët e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës Edmond Haxhinasto etj. ; të dhëna të cilat , janë përcjellë , në SPAK , nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ; shih fq. 124 - 212 , në fashikullin nr. 17 të Prokurorit, që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) provohet , se kopjet e faqeve elektronike të printuara , **nuk janë nënshkruar** , në fundin e çdo flete /faqeje , nga oficeri i policisë gjyqësore (që i aksesoi ato ; pra , nuk ka siguri e qartësi procedurale , për autoritetin publik , që i ka printuar këto akte) ; Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ;

49/1). Pretendoj , se këto akte (shih fq. 124 - 212 , po në këtë fashikull nr. 17 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për seicilën akuzë (kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 16 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 17 / 9 / 2026) ;

50). **Provohet , se akti** në gjuhën angleze dt. 18 / 10 / 2010 ose 18 / 11 / 2010 i Ambasadës tonë në Pragë / Çeki (drejtuar autoriteteve zyrtare të Republikës Çeke , të lidhura me vizitën zyrtare të delegacionit zyrtar të kryesuar , nga ish- zv. Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtëme ILIR META , në Çeki , në datat 29 / 11 / 2010 - 01 / 12 / 2010 ; sipas të cilit akt pretendohet , ndër të tjera , se " ... *në takim do të jetë edhe ... Kastriot Ismailaj* ... " ; shih fq. 7 të fashikullit nr. 22 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ; shih fq. 20 - 22 të kërkesës të Prokurorit , për gjykim themeli) , **nuk identifikon** autoritetin përgjegjës të Ambasadës (që e ka nxjerrë / lëshuar këtë akt) dhe **nuk ka nënshkrimin** e këtij autoriteti (pra , ky akt përmban vetëm vulën e kësaj ambasade !!!!!) ; Gjithashtu , ky akt i Ambasadës **e ka datën (e përpilimit të saj) me korigjime** (dhe nuk kuptohet qartazi / me siguri procedurale

, nëse ky akt është nxjerrë më dt. 18 / 10 / 2010 apo 18 / 11 / 2010 ; prokurori pretendon , se ky akt është nxjerrë më dt. 18 / 11 / 2010) ; Data e këtij akti , nuk mund të saktësohet me siguri procedurale , indirekt ose në formë tjetër (në bazë / referuar të elementeve , që përmbahen në vetë këtë akt ose në aktet , që lidhen me të) . Provohet , se akti i përkthyeses (shih fq. 8 , po të këtij fashikulli nr. 22 të Prokurorit) **nuk ka datën** , kur ajo e ka përkthyer dhe përkthyesja **nuk ka paraqitur** deklaratën e saj eventuale të domosdoshme; Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore;

50/1). Pretendoj , se ky akt i Ambasadës , në gjuhën angleze , **nuk përbën provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë ; Për rrjedhojë , edhe referimet në këtë akt , nuk përbëjnë prova shkresore , për çdo akuzë objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 16 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 17 / 9 / 2026 ; kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

51). Provohet , se në bazë të aktit dt. 04 / 9 / 2023 të kompanisë private tregtare mobile " ONE Albania " (shih fq. 148 , po të fashikullit nr. 22 të Prokurorit ; shih fq. 32 e 33 të kërkesës të Prokurorit , për gjykim themeli) sqarohet , ndër të tjera , sa vijon " *... dokumentat për nr. celular 0682031701 , nuk rezultojnë të regjistruara në vitet 2009 , 2010 (por është regjistruar në vitin 2012 , në emrin e shtetasit Bledian Alla)* ; Sipas aktit të kësaj kompanie të dt. 19 / 9 / 2023 (shih fq. 162 , po të fashikullit nr. 22 të Prokurorit) , sqarohet ndër të tjera , sa vijon " *... rezulton , se gjatë viteve 2009 , 2010 ky numër celular ka qenë i regjistruar në emër të ILIR META , por nuk disponojmë nr. personal (ID) ose datëlindjen e këtij shtetasi* .." ; Ndërkohë emri im zyrtar (sipas aktit dt. 16 / 8 / 2022 të D. P. Gjëndjes Civile Tirane ; shih fq. 1 të fashikullit nr. 24 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ; shih dhe aktin dt. 25 / 8 / 2022 të Kuvendit të Shqipërisë , në fq.3 - 17 , po të fashikullit nr. 24 të Prokurorit) është ILIR METAJ dhe nuk kam patur asnjëherë ndryshime , në përbërësit e gjendjes time civile ; Gjithashtu sipas aktit të kësaj kompanie celulare të dt. 09 / 4 / 2024 (shih fq. 4 , po të fashikullit nr. 23 të Prokurorit) , sqarohet ndër të tjera , sa vijon " *... sistemi ynë nuk gjeneron informacion për*

pagesën e faturave mujore apo detyrimeve për numrin celular 0682031701 gjatë periudhës 2019 , 2010 .." ;

51/1). Referuar , edhe akteve të sipërcituara të kësaj kompanie celulare pretendoj përsëri , se nuk provohet , që unë (me emrin tim ILIR METAJ dhe me të dhënat e tjera zyrtare të gjëndjes time civile) kam kërkuar ndonjëherë **,** me shkrim (pranë shoqërisë private tregtare mobile fillestare " AMC ") posedimin **e kartës saj celulare me nr. 0682031701** (kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 16 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 17 / 9 / 2026) ;

52). **Referuar** akteve të hetimeve paraprake (shih aktin dt. 27 / 10 / 2023 të Komisariatit të Policisë Kufitare Rinas , administruar në fq. 212 e vijues të fashikullit nr. 22 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ; shih dhe fq. 22 të kërkesës të Prokurorit , për gjykim themeli ; sipas akte të cilave , pretendohen hyrje - daljet eventuale , në datat 29 / 11 / 2010 dhe 02 / 12 / 2010 , në/nga Shqipëria , nëpërmjet Aeroportit të Rinasit , të shtetasve ILIR METAJ dhe Kastriot Ismailaj) provohet , se kopjet e faqeve elektronike të printuara (bashkalidhur aktit përcjellës të këtij Komisariati) , **nuk janë nënshkruar** , në fundin e çdo flete / faqeje , nga oficeri përgjegjës , që i aksesoi ato (pra , në këtë gjendje , që janë këto akte , nuk kuptohet qartë dhe nuk ka siguri procedurale , për autoritetin publik , që i ka printuar ato) ;

52/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Por unë pretendoj , se këto akte të Komisariatit të Policisë Kufitare Rinas , **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për seicilën akuzë (kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 16 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 17 / 9 / 2026) ;

53). **Referuar** akteve të hetimeve paraprake (shih aktin dt. 21 / 7 / 2023 të entit " AIR Albania " Sh.P.K , administruar në fq. 255 të fashikullit nr. 34 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ; sipas akte të cilave , pretendohen daljet eventuale , më dt. 17 / 7 / 2021 të shtetasve Era Metaj , Bora Metaj e Besar Metaj , nga Shqipëria , jashtë vendit , me fluturim ajror ; pretendohet edhe hyrje eventuale , në Shqipëri , me fluturim ajror ,

më dt. 25 / 7 / 2021 , po të këtyre shtetasve) provohet , se ky akt **nuk identifikon** autoritetin përgjegjës (me emër e mbiemër) , që e ka lëshuar / nxjerrë (këtë akt) dhe nuk përcakton detyrën e tij (pra , ky akt përmban vetëm vulën dhe nënshkrimin) ; Provohet gjithashtu , se kopjet e faqeve elektronike të printuara (bashkalidhur aktit përcjellës të këtij enti , të administruara në fq. 257 - 273 , po të fashikullit nr. 34 të Prokurorit) , **nuk janë nënshkruar** , në fundin e çdo flete / faqeje , nga nëpunësi /punonjësi përgjegjës , që i aksesoi ato(pra , në këtë gjendje , që janë këto akte , nuk kuptohet qartë dhe nuk ka siguri procedurale , për autoritetin , që i ka printuar ato) ; Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ;

53/1). Pretendoj , se këto akte të entit tregtar "AIR Albania " Sh.P.K (të administruara në fq. 255 - 273 , të fashikullit nr. 34 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave) , ndaj meje , për seicilën akuzë ; Pretendoj , se edhe ekspertimi financiar (që mbështetet në këto akte , nga ekspertja financiare e prokurori , lidhur me shpenzimet e udhëtimeve të sipërcituara të vitit 2021) , **nuk përbën provë indirekte** , për çdo akuzë objekt gjykimi ;

i). Pretendoj , se edhe për shkaqet e sipërcituara , hetimi i fakteve dhe i rrethanave të çështjes (lidhur me shpenzimet e mia eventuale financiare të vitit 2021) , objekt gjykimi , nuk është i plotë ; Pretendoj , se ekspertimi financiar (lidhur me shpenzimet e udhëtimeve të sipërcituara të vitit 2021) ka mjaftueshëm mangësi e paqartësi .

ii). Pretendoj , se konkluzionet e ekspertimit financiar (referuar shpenzimeve të sipërcituara të udhëtimeve të vitit 2021) **janë nxjerrë , në mungesë të akteve të plota dhe në mungesë të elementëve thelbësore / të rëndësishëm të sipërcituar të çështjes** (shih nenet 178 e 191 të K. Pr. Penale) ;

Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 16 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 17 / 9 / 2026 ;

54). **Referuar** procesverbalit dt. 05 / 4 / 2023 të oficerit të policisë gjyqësore " Për kqyrjen dhe marrjen e provave materiale " , në ILDKPKI (akte të cilat lidhen eventualisht , me kqyrjen dhe marrjen e Deklaratave Periodike Vjetore të

Pasurisë të subjekteve deklarues / unë , e pandehura Monika dhe **megjithëse** përcaktohet nga oficeri i policisë gjyqësore , se " .... *u morën kopje të njësuara me origjinalin* ... ") provohet sa vijon :

i). se fletët e inventarizuara me numra 9 - 481 të fashikullit nr. 48 të Prokurorit (që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) dhe fletët e inventarizuara me numra 1 - 493 , të dy fashikujve nr. 49 të Prokurorit (që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) , janë numërtuar këto dy fashikuj , për efekt dorëzimi , ndaj meje , me nr. 49/1 e nr. 49/2) ;

ii). se fletët / aktet e këtyre dy fashikujve nr. 49/1 e nr. 49/2 dhe fletët e inventarizuara me numra 1 - 401 (të fashikullit nr. 50 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) , **nuk janë të njësuar me origjinalin** e tyre , që administrohen eventualisht , nga ILDKPKI dhe **nuk identifikohet** / përcaktohet detyra e nëpunësit përgjegjës / i autorizuar , që ia dorëzoi këto akte (në emër të ILDKPKI) oficerit të policisë gjyqësore ;

54/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Por unë pretendoj , se aktet e sipërcituara (në fashikujt nr. 48 , 49 e 50 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje;

55). **Referuar** aktit dt. 02 / 3 / 2023 të ILDKPKI (sipas të cilës janë dërguar , nga ILDKPKI , në SPAK , Deklaratat Periodike Vjetore të Pasurisë të subjekteve deklarues , unë dhe e pandehura Monika , të viteve 2003 e vijim dhe disa dokumenta të tjera) provohet , se fletët e inventarizuara me numra 165 - 322 të fashikullit nr. 52 të Prokurorit (që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) , **nuk janë kopje të njësuar me origjinalin e tyre** ; Edhe akti i sipërcituar përcjellës i ILDKPKI përcakton , ndër të tjera , vetëm se " .... *bashkalidhur ju vendosim në dispozicion* ***kopje*** *të dokumentacionit të administruar në ILDKPKI , për subjektet .....*" (krahaso me aktin e dt. 16 / 5 / 2024 , po të ILDKPKI , administruar në fq. 10 të fashikullit nr. 51 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi , ku cilësohet , prej nëpunësit përgjegjës , ndër të tjera , se " ..... *ju vendosim në dispozicion* ***kopje të njësuar me origjinalin*** *të DIPPV .....* " ;

55/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Por unë pretendoj , se këto akte (shih fq. 165 - 322 , po të këtij fashikulli nr. 52 të Prokurorit) **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje ;

56). Referuar kërkesës të prokurorit (shih fq.1 të fashikullit nr. 66 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) rezulton , se: Intesa SanPaolo Bank Albania ka kthyer përgjigje (për llogari të ish - Bankës Italo Albanese) , për lëvizjet në llogarinë bankare , që kjo bankë administronte , në emër të shtetasve ILIR Rexhep Meta e Monika Kryemadhi , për vitet 1999 - 2007 ; Provohet , se ky informacion bankar / lëvizjet në llogari / pasqyrat e saj (shih fletët 9 - 12 , po të fashikullit nr. 66 të Prokurorit) , janë në gjuhë të huaj dhe të papërkthyera , në gjuhën shqipe ; Intesa SanPaolo Bank Albania ka kthyer përgjigje , për lëvizjet në llogarinë bankare , që kjo bankë administronte , në emër të shtetasve ILIR Rexhep Meta e Monika Kryemadhi , për vitet 2000 - 2021 ; Provohet , se ky informacion bankar / lëvizjet në llogari / pasqyrat e saj (shih fletët 102 - 106 , po të fashikullit nr. 66 të Prokurorit) , janë në gjuhë të huaj dhe të papërkthyera , në gjuhën shqipe ; Intesa SanPaolo Bank Albania ka kthyer përgjigje , për lëvizjet në llogarinë bankare , që kjo bankë administronte , në emër të s htetasit ILIR Rexhep Meta , për vitet 2000 - 2021 ; Provohet , se edhe ky informacion bankar / lëvizjet në llogari / pasqyrat e saj (shih fletët 107 - 114 , po të fashikullit nr. 66 të Prokurorit) , janë në gjuhë të huaj dhe të papërkthyera , në gjuhën shqipe ; Kjo bankë **nuk konfirmon njësinë e këtyre akteve me origjinalin** ; Provohet , se ky informacion bankar , nuk është nënshkruar dhe/ose vulosur , në çdo fletë , nga nëpunësi bankar përgjegjës ;

56/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Por unë pretendoj , se këto dokumenta /akte bankare , **nuk përbëjnë provë shkresore** , ndaj meje , për çdo akuzë /episod , objekt gjykimi , ndaj meje ; Për rrjedhojë , edhe aktet e tjera procedurale , që referojnë , në këtë dokumentacion bankar , nuk përbëjnë provë dhe nuk kanë fuqi provuese , ndaj meje , për çdo akuzë/episod , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

57). Referuar kërkesës të prokurorit provohet , se " Credins Bank " i ka kthyer përgjigje , për llogaritë bankare , që kjo bankë administronte , në emër të shtetasve ILIR Rexhep Meta etj. , sipas aktit të saj nr. 64567/1 dt. 21 / 9 / 2022 (shih fq.165 e vijim të fashikullit nr. 66 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Provohet , se kjo përgjigje bankare është nënshkruar , nga zv. Drejtore e Departamentit Juridik **, pa e patur ajo , autorizimin / urdhërin / porosinë e titullarit / administratorit të kësaj banke** (pra , ky informacion bankar , ka të meta për shkak të formës tij) ; Kjo Bankë nuk përshkruan numrin e fletëve , që ajo i ka dërguar prokurorit dhe as Prokuroi / SPAK nuk ka protokolluar numrin e fletëve , që iu paraqitën , nga kjo bankë ; Banka është mjaftuar (për klientin e saj ILIR META) , vetëm me përgjigjen vijuese " *Bashkëlidhur ju dërgojmë transaksionet .... deri më dt. 20 / 9 / 2022*. " ; Ndërsa në fakt provohet , se veprimet / lëvizjet bankare rezultojnë (për klientin ILIR META) deri më dt. 18 / 8 / 2020 (dita kur është zeruar llogaria përkatëse e tij bankare ; pra , nuk ka lëvizje , në llogarinë tij , pas kësaj date) dhe llogaria e tij bankare është mbyllur më dt. 13 / 9 / 2022 (shih fq. 200 - 232 të fashikullit nr. 67 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Pra , provohet **se ka paqartësi** (edhe për këto shkaqe) , lidhur me informacionin bankar , për klientin ILIR META ; Kjo bankë **nuk konfirmon** (shih fq.165 e vijim , po të fashikullit nr. 66 të Prokurorit) **njësinë e këtyre akteve me origjinalin** ; Provohet , se ky informacion bankar , **nuk është nënshkruar dhe/ose vulosur , në çdo fletë** , nga nëpunësi bankar përgjegjës ; Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ;

57/1). Për këto fakte / rrethana e shkaqe dhe me këtë gjëndje aktesh pretendoj , se këto dokumenta /akte bankare (shih fq. 200 - 232 , po të fashikullit nr. 67 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentit , ndaj meje , për çdo akuzë /episod , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe aktet e tjera procedurale (ekspertimi financiar etj.) , që referojnë , në këtë dokumentacion bankar , nuk përbëjnë provë dhe nuk kanë fuqi provuese , ndaj meje , për çdo akuzë/episod , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

58). Referuar kërkesës të prokurorit provohet , se " Credins Bank " i ka kthyer përgjigje , duke dërguar (ndër të tjera) edhe kontratën noteriale të kredisë dt. 26 / 5 / 2010 të noterit Dusho Dusha , me seli në Tiranë , të lidhur midis palëve " Banka Credins " - Monika Kryemadhi , me dorëzanës ILIR META (shih fq.1 , 25 - 44 të fashikullit nr. 68 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) : Vetë kjo Bankë sqaron / thekson (ndër të tjera) , se " ..... *ju dërgojmë* ***kopje*** *të kontratave* ...." (shih fq. 2 , po të fashikullit nr. 68 të Prokurorit) ; Pra , kjo kontratë noteriale , nuk është **njësuar , nga kjo Bankë , me origjinalin e saj** ; Provohet , se kjo përgjigje / informacion bankare është nënshkruar , nga zv. Drejtore e Departamentit Juridik , pa e patur ajo , autorizimin / urdhërin / porosinë e titullarit / administratorit të kësaj banke (pra , ky informacion bankar , ka të meta , edhe për shkak të formës tij) ; Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ;

58/1). Pretendoj , se kjo kontratë noteriale dhe aktet bashkalidhur saj (shih fq. 25 - 44 , po të fashikullit nr. 68 të Prokurorit) , **nuk përbën provë shkresore** (në formën e dokumentit) , ndaj meje , për çdo akuzë /episod , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe aktet e tjera procedurale , që referojnë , në këtë praktikë kontraktore , nuk përbëjnë provë dhe nuk kanë fuqi provuese , ndaj meje , për çdo akuzë / episod , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

59). Referuar kërkesës të prokurorit provohet , se Kuvendi i Shqipërisë ka kthyer përgjigjen e dt. 13 / 3 / 2025 , për të ardhurat nga paga dhe përfitimet e tjera financiare (ndër të tjera) edhe për mua , me statusin e deputetit , për periudhën kohore të viteve 2003 - 2017 (shih fq. 133 e vijues të fashikullit nr. 89 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Rezulton , sipas këtij akti (dhe tabelës saj përkatëse) të Kuvendit , se unë (në vitin 2016) , **nuk kam përfituar rimbursimet** (për shpenzimet e karburantit , për telefonin) dhe **as honoraret** , për mbledhjet e komisioneve parlamentare ; Vlera totale monetare neto e të ardhurave të përfituara , prejmeje , për vitin 2016 , është në shumën **1.827.711** lekë (shih fq.134 , po të fashikullit nr. 89 të Prokurorit) ; Ky informacion , është patur parasysh , edhe për konkluzionet e ekspertimit financiar të kësaj çështje dhe për analizën time financiare ; Ndërsa sipas aktit dt. 21 / 7 /

2026 të Kuvendit dhe tabelave përkatëse (dërguar ky informacion , sipas kërkesës të deputetit përkatës , lidhur me të ardhurat e përfituara , prej meje , nga Kuvendi) provohet , se unë **kam përfituar** , në vitin 2016 , si vijon :

i). **rimbursimet** , për shpenzimet e **karburantit** (në vlerën monetare 60.032 lekë) + shpenzimet e **telefonit** (në vlerën monetare 34.000 lekë) ,

ii). **honoraret** , për mbledhjet e komisioneve (në vlerën monetare neto 34.000 lekë) ;

iii). vlera totale monetare neto e të ardhurave të përfituara , prej meje , për vitin 2016 , është në shumën **1.955.743** lekë ;

59/1) . Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Meqenëse rezulton dukshëm , se ka paqartësi në informacionin zyrtar , që administron Kuvendi , për të ardhurat e mia financiare , ka ndikim në analizën time financiare të periudhës kohore, objekt ekspertimi (për vitin 2016) dhe për rrethanat e shkaqet e sipërcituara , **kërkoj** :

i). Të merren e pranohen , nga gjykata , si provë aktet vijuese :

- Akti origjinal zyrtar nr. 3119 dt. 16 / 7 / 2026 të deputetit Tedi Blushi (me 1 fletë) , dërguar Kuvendit / Parlamentit ;

- Praktika e akteve origjinale zyrtare nr. 3119/1 dt. 21 / 7 / 2026 të Kuvendit (me 4 fletë) ;

ii). Të plotësohet ekspertimi financiar ose të kryhet ekspertim i ri financiar , për periudhën kohore të viteve 1992 - 2023 , duke patur parasysh , edhe informacionin e dt. 21 / 7 / 2026 të Kuvendit (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) .

60). Referuar procesverbalit dt. 01 / 9 / 2022 të oficerit të policisë gjyqësore (shih fq.1 të fashikullit nr. 90 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore

të themelit , objekt gjykimi) provohet , se janë kqyrur e marrë të dhëna eventuale , për kontratat e lobimit / konsulence të lidhura nga ish- Partia LSI , të shkarkuara / ekstraktuara , nga faqe online të eneit Foreign Agents Registration Act , US Department of Justice /shkurtimisht " FARA " ;

60/1). Provohet , se oficeri i policisë gjyqësore :

i). **nuk ka përshkruar** numrin e fletëve / akteve të shkarkuara / ekstraktuara prej tij (shih fq. 9 - 105 , po të fashikullit nr. 90 të Prokurorit) ;

ii). këto akte , **nuk janë nënshkruar** seicila , prej tij /oficerit ; **nuk sqarohet** programi elektronik i licensuar dhe i përdorur prej tij , për nxjerrjen / shkarkimin / marrjen e këtyre akteve (pra , nuk ka siguri , qartësi dhe besueshmëri procedurale , për cilësinë e këtyre akteve dhe nëse këto akte , janë ekstraktuar ose jo , prej tij) ;

iii). këto akte , janë në gjuhë të huaj dhe **të papërkthyera** ;

60/2). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Por pretendoj , se :

i). këto akte (shih fq. 9 -105 , po të fashikullit nr. 90 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave) , ndaj meje , për secilën akuzë ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë shkresore .

ii). Të kërkohet / merret nga gjykata (sipas nenit 509 të K. Pr. Penale) , me letërporosi , informacion / të dhëna / akte /dokumenta , nga US Department of Justice , për kontratat e lobimit / konsulencës politik , të lidhura eventualisht nga ish- Partia LSI .

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026 ;

61). Referuar procesverbalit dt. 07 / 9 / 2022 të oficerit të policisë gjyqësore (shih fq.106 -109 , po të fashikullit nr. 90 të Prokurorit) provohet , se janë kqyrur e marrë në " Credins Bank " praktika e akteve të transferimit të vlerave menetare , nga llogaria bankare (e kësaj banke) të ish- Partia e LSI , në dobi shoqërive të huaja të lobimit / konsulencës ; Por provohet , se (në kundërshtim me përshkrimin e oficerit të policisë gjyqësore dhe të nëpunësit përkatës të kësaj banke) fletët 121 - 134 , 140 - 153 , 179 - 205 , 213 - 217 të këtij fashikulli , nuk janë nënshkruar /vërtetuar / njësuar me origjinalin ; Ndërsa aktet e tjera bankare në fletët 113 - 120 , 135 - 139 , 154 - 178 , 206 - 212 , 218 - 225 , nuk identifikohet nëpunësi bankar , që ka nënshkruar njësinë e tyre me origjinalin (këto akte kane vetëm nënshkrimin dhe vulën e brendëshme) ; Provohet , se kjo kqyrje /marrje e akteve bankare është nënshkruar , nga zv. Drejtore e Departamentit Juridik (shih fq.106 - 109 , po të fashikullit nr. 90 të Prokurorit) , **pa e patur ajo** (dhe nëpunësit e tjerë , që kanë vulosur e nënshkruar aktet e ndryshme bankare bashkalidhur) , **autorizimin / urdhërin e titullarit / administratorit të kësaj banke** (pra , ky informacion bankar dhe ky veprim procedural , ka të meta , për shkak të formës tij) ;

61/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se këto dokumenta /akte bankare (shih fq. 106 - 225 , po të fashikullit nr. 90 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentit) , ndaj meje , për çdo akuzë /episod , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe aktet e tjera procedurale (ekspertimi financiar etj.) , që referojnë , në këtë dokumentacion bankar , nuk përbëjnë provë dhe nuk kanë fuqi provuese , ndaj meje , për çdo akuzë / episod , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

62). Provohet , se mbi kërkesën e Prokurorit " Për ndihmë juridike " (drejtuar autoriteteve të drejtësisë të Republikës të Çekisë) , është administruar praktika e akteve , në gjuhën çeke të autoriteteve të këtij shteti (shih fq. 15 e vijim të fashikullit nr. 91 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ;

62/1). Provohet , se **nuk administrohet akti** / komunikimi procedural i autoriteteve të drejtësisë të Republikës të Çekisë , me Ministrinë e Drejtësisë , për efekt të ekzekutimit të letërporosisë ;

i). lidhur me pranimin ose jo të ekzekutimit të letërporosisë / ndihmës juridike të kërkuar , prej prokurorit ,

ii). për aktet konkrete (dhe numrin e tyre) , që i janë dërguar , nga autoritetet çeke , Ministrisë të Drejtësisë ; Nuk ka asnjë akt procedural , që konfirmon origjinalitetin e akteve , në gjuhën çeke , objekt ekzekutimi të letërporosisë dhe objekt përkthmi .

62/2). Provohet , se marrveshja e muajit nëndor të vitit 2021 (lidhur midis prokurorit e përkthyesit ILIR Allushi ; shih fq. 106 , 107 , po të fashikullit nr. 91 të Prokurorit) dhe aktet e gjuhe çeke (ku ai ka asistuar , si përkthyes verbal i prokurorit ; shih fq. 15 - 18 , 27 e 248 , po të fashikullit nr. 91 të Prokurorit) , **nuk kanë vulën e përkthyesit** dhe përkthyesi **nuk ka paraqitur deklaratën e tij eventuale** të domosdoshme ;

62/3). Provohet , se mungon / **nuk administrohet vendimi** , për caktimin e përkthyeses Ani Hafizi , në hetimet paraprake (shih fq.124 - 202 , po të fashikullit nr. 91 të Prokurorit) ;

62/4). Provohet , se deklarata / aktet e kësaj përkthyesje (shih fq. 124 -202 , po të fashikullit nr. 91 të Prokurorit) , **nuk kanë vulën e saj** / përkthyeses dhe përkthyesja **nuk ka paraqitur** / përshkruar deklaratën e saj eventuale të domosdoshme;

62/5). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Por unë pretendoj se këto akte , në gjuhën çeke (ku është asistuar përkthimi) dhe aktet e përkthyera (nga gjuha çeke , në gjuhën shqipe) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më

lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

63). Provohet , se mbi kërkesën dt. 26 / 9 / 2022 të Prokurorit " Për ndihmë juridike " (drejtuar autoriteteve të drejtësisë të Republikës të San Marinos) , është administruar praktika e akteve të autoriteteve të këtij shteti (shih fq. 1 e vijim , 16 e vijim , 29 e vijim të fashikullit nr. 92 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) , sipas aktit dt. 24 / 02 / 2023 të Ministrisë së Drejtësisë (shih fq. 16 , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) ; Por nuk provohet , se cilat akte konkrete (dhe numrin e tyre) , ka dërguar Ministria jonë e Drejtësisë , në SPAK (për efekt të ekzekutimit të letërporosisë) ; Nuk kuptohet qartazi , dokumentacioni objekt i ekzekutimit të letërporosisë dhe objekt administrimi ;

i). Edhe SPAK / prokurori **nuk argumenton** , se cilat akte konkrete (dhe numrin e tyre) , i janë dërguar atyre , nga kjo Ministri (shih po fq. 16 , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) ;

ii). Kjo Ministri **nuk konfirmon origjinalitetin** e akteve të autoriteteve të këtij shteti (shih fq. 16 , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) ;

63/1). Provohet , që Prokurori ka vlerësuar / çmuar përkthimin (dhe ia ka dërguar ato , Ministrisë të Drejtësisë , për përkthim) , vetëm të disa akteve , objekt i ndihmës juridike / letërporosisë (shih fq. 17 , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) ;

i). Rezulton , se Ministria e Drejtësisë i ka dërguar SPAK / prokurorit , aktet (objekt përkthimi) , në gjuhën shqipe (shih fq. 59 e vijues , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) ; Provohet , se si Ministria e Drejtësisë , ashtu edhe SPAK , **nuk konfirmojnë numrin e akteve të përkthyera** dhe aktet konkrete , objekt përkthimi (shih fq. 59 , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) ;

ii). **Nuk argumentohet** / pasqyrohet / tregohet , se cilat akte konkrete (dhe numrin e tyre) , ka dërguar SPAK (në Ministrinë e Drejtësisë) , për tu përkthyer , në gjuhën shqipe ;

iii). **Nuk tregohet / argumentohet shkaku** , për të cilat nuk janë dërguar , për përkthim , edhe aktet e tjera , objekt i ekzekutimit të letërporosisë (dhe cilat akte konkrete , nuk janë të dërguara , për përkthim) .

iv). Provohet , se aktet e përkthyera (nga Ministria e Drejtësisë) , në gjuhën shqipe (shih fq. 61 - 76 , po të fashikullit hetimor nr. 92 të Prokurorit) , **nuk kanë datën** e përkthimit tyre ; Provohet , se Ministria e Drejtësisë dhe SPAK / prokurori **nuk identifikojnë** (shih fq. 16 , 17 , 59 , 61 - 76 , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) gjuhën e akteve të autoriteteve të shtetit të San Marinos (objekt i përkthimit tyre , në gjuhën shqipe) .

v). Provohet , se aktet në gjuhën e burimit (shih fq. 93 - 273 , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) , **nuk janë përkthyer** , në gjuhën shqipe .

63/2). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj:

i). Se aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe (shih fq. 61 - 76 , po të fashikullit nr. 92 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë** , për akuzat objekt gjykimi , ndaj meje ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

ii). Kërkoj nga Gjykata **të merren** , në Ministrinë e Drejtësisë i gjithë dokumentacioni , që kanë dërguar autoritetet e San Marinos (për ekzekutimin e letërporosisë të sipërcituar ; duke identifikuar <u>aktet e konkrete</u> , <u>numrin e tyre</u> dhe të konfirmojë <u>njësinë e tyre me origjinalin</u>) ;

iii). Kërkoj , që ky dokumentacion (që do të paraqesë Ministria e Drejtësisë) ti nënshtrohet **përkthimit tyre** , në gjuhën shqipe , duke caktuar përthyes të licensuar (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

64). Provohet , se mbi kërkesën dt. **07 / 7 / 2023** të Prokurorit " Për ndihmë juridike " (drejtuar autoriteteve të Republikës të San Marinos) , është administruar praktika e akteve të autoriteteve të këtij shteti , sipas aktit dt. 11 / 12 / 2023 të

Ministrisë të Drejtësisë (shih fq. 1 e vijim , 7 e vijim të fashikullit nr. 93 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ; por Ministria e Drejtësisë i referohet aktit dt. **07 / 7 / 2022** të prokurorit) ; Prokurori dhe kjo Ministri , nuk kanë sqaruar /argumentuar , nëse kjo datë(në këtë akt) , përbën gabim material apo ka kërkesë tjetër dt. **07 / 7 / 2022** , prej prokurorit ;

64/1). Por nuk provohet , se cilat akte konkrete (dhe numrin e tyre) , ka dërguar Ministria jonë e Drejtësisë , në SPAK (për efekt të ekzekutimit të letërporosisë , nga autoritetet e këtij shteti të huaj ; shih fq. 7 , po të fashikullit hetimor nr. 93 të Prokurorit);

i). Edhe SPAK nuk konfirmon, se cilat akte konkrete (dhe numrin e tyre) , i janë dërguar atyre , nga kjo Ministri (shih po fq. 7 , po të fashikullit nr. 93 të Prokurorit) ;

ii). Kjo Ministri **nuk konfirmon origjinalitetin** e akteve të autoriteteve të këtij shteti të huaj (shih fq. 7 , po të fashikullit nr. 93 të Prokurorit) ;

64/2). Provohet , se aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe(shih fq. 4 - 396 , të fashikullit nr. 94 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) , **nuk kanë datën** e përkthimit tyre .

64/3). Provohet dhe pretendoj , se përkthyesja e caktuar , nga prokurori , **nuk ka vulën e saj** , në aktet e përkthyera prej saj (shih fq. 4 - 396 , 402 - 405 , po të fashikullit nr. 94 të Prokurorit) dhe përkthyesja **nuk ka paraqitur** / përshkruar , as **deklaratën e saj eventuale** të domosdoshme .

64/4). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe (shih fq. 4 - 396 , po të fashikullit nr. 94 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

65). Provohet , se mbi kërkesën dt. 07 / 3 / 2024 të Prokurorit “ Për ndihmë juridike .... “ (drejtuar autoriteteve të drejtësisë të Republikës të San Marinos) , është administruar praktika e akteve të autoriteteve të këtij shteti , sipas aktit dt. 15 / 7 / 2024 të Ministrisë të Drejtësisë (shih fq. 1 e vijim , 36 e vijim të fashikullit nr. 95 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi ;

65/1). Por nuk provohet , se **cilat akte konkrete** (dhe numrin e tyre) , ka dërguar Ministria e Drejtësisë , në SPAK (për efekt të ekzekutimit të letërporosisë , nga autoritetet e këtij shteti të huaj ; shih fq. 36 - 79 , po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) ; Kjo mënyrë administrimi , cënon mjaftueshëm objektivitetin e veprimeve procedurale dhe nuk kuptohet qartazi , dokumentacioni objekt i ekzekutimit të letërporosisë dhe objekt administrimi ;

i). Edhe SPAK **nuk konfirmon** , **se cilat akte konkrete** (dhe numrin e tyre) , i janë dërguar atyre , nga kjo Ministri (shih po fq. 36 , po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) ; Kjo Ministri **nuk konfirmon origjinalitetin** e akteve të autoriteteve të këtij shteti të huaj (shih fq.36 , po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) ;

65/2). Provohet , se aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe (shih fq. 109 - 160 të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) , **nuk kanë datën** e përkthimit tyre . Pretendoj , se përkthyesja , **nuk ka vulën e saj** , në aktet e përkthyera prej saj dhe përkthyesja **nuk ka paraqitur deklaratën e saj eventuale** të domosdoshme t.

65/3). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet në gjuhën shqipe (shih fq.109 -160 , po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

66). Mbi kërkesën dt. 07 / 3 / 2024 të Prokurorit “ Për ndihmë juridike .... “ (drejtuar autoriteteve të drejtësisë të Republikës të Italisë) provohet , se aktet

objekt eventual kqyrjeje / ekstraktimi elektronik (shih fq. 219 - 234 , po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) **nuk janë nënshkruar nga oficeri i policisë gjyqësore dhe/ose eksperti** , që i ka ekstraktuar / shkarkuar elektronikisht ato ; nuk sqarohet /argumentohet / tregohet shkaku përkatës ;

67/1). Provohet , se aktet e fq. 242 - 246 (po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) , **nuk kanë datën** e përkthimit tyre (shih fq. 242 - 246 , 256 e 259 , po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) .Pretendoj , se përkthyesja **nuk ka vulën e saj** , në aktet e përkthyera prej saj (shih fq. 242 - 246 , 250 , 255 , 256 e 259 , po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) dhe përkthyesja **nuk ka paraqitur** / përshkruar , as **deklaratën e saj eventuale** të domosdoshme .**Nuk provohet** (në gjëndjen e akteve të këtij fashikulli) , që autoritetet Italiane të drejtësisë të kenë miratuar dhënien e ndihmës juridike ;

67/2). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e fq. 219 - 234 (po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ; Aktet e fq. 242 - 246 (po të fashikullit nr. 95 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

68). Provohet , se mbi kërkesën e Prokurorit " Për ndihmë juridike " (drejtuar autoriteteve të drejtësisë të Republikës të Qipros) , është administruar praktika e akteve të autoriteteve të këtij shteti (nëpërmjet Ministrisë të Drejtësisë ; shih fletët 14 , 15 - 31/1 të fashikullit nr. 96 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Provohet , se **nuk konfirmohen** aktet konkrete (dhe numrin e tyre) , që i janë dërguar , nga autoritetet publike të Qipros dhe nuk konfirmohen **origjinaliteti i këtyre akteve** ; Nuk konfirmohen , as aktet konkrete (dhe numrin e tyre) , që ka protokolluar Prokurori ; Rezulton se përkthyesja **nuk ka paraqitur** deklaratën e saj të domosdoshme.

68/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 32 - 45 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 20 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 22 / 10 / 2026) ;

69). Provohet , se mbi kërkesën e Prokurorit " Për ndihmë juridike " (drejtuar autoriteteve të drejtësisë të Republikës të Italisë ; shih fq. 95 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) , është administruar praktika e akteve të Prokurorisë të Venecias / Itali (drejtuar drejtpërdrejt Prokurorit / SPAK ; shih fletët 96 , 132 - 158 , 174 - 189 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ; Provohet , se **nuk konfirmohen** aktet konkrete (dhe numrin e tyre) , që i janë dërguar , SPAK - ut , nga autoritetet publike të Italisë dhe **nuk konfirmohen** (nga SPAK) **origjinaliteti i këtyre akteve** (shih fq. 96 , 132 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ; **Nuk konfirmohen** (nga SPAK) aktet konkrete , që i janë dhënë prej tyre , përkthyesit , për realizimin e përkthimit (shih fq. 132 - 158 , 160 - 173 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ;Referuar aktit dt. 03 / 3 / 2023 të Ministrisë tonë të Drejtësisë (shih fq. 114 -117 të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) provohet , se fq.115 **nuk është e përkthyer** , në gjuhën shqipe ; Provohet , se Ministria jonë e Drejtësisë **nuk konfirmon** , nëse praktika e akteve të Ministrisë të Drejtësisë Italiane (ardhur asaj eventualisht me e-mail ; shih fq. 115 , 116 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) janë të njëjta me origjinalin e tyre ; Gjithashtu akti i Ministrisë të Drejtësisë Italiane , **nuk ka vulën** e asaj Ministrie ; Provohet , se Prokurori i kërkoi (me aktin e saj fizik / manual dt. 15 / 5 / 2023) Ministrisë të Drejtësisë , caktimin e një përkthyesi të gjuhës italiane (shih fq. 96 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ; Ndërsa përgjigja e kësaj kërkese , i kthehet SPAK-ut (shih fq. 159 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) , me e-mail dt. 18 / 5 / 2023 , nën përgjegjësinë eventuale të një specialisteje të kësaj Ministrie ; Por provohet , se ky e-mail : nuk ka nënshkrimin e kësaj specialisteje , nuk ka as vulën e Ministrisë dhe nuk ka as autorizim , për caktimin e përkthyesit Erion Kabaj , për përkthimin e akteve (shih fq. 159 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ; Provohet , se akti përcjellës dt. 13 / 5 / 2023 i praktikës të akteve të Prokurorisë së Venecias/ Itali

(objekt përkthimi ; shih fq. 132 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) **nuk ka vulën** e Prokurorisë së Venecias ; Gjithashtu nuk **konfirmohet** (as nga Prokuroria e Venecias , as nga SPAK-u dhe as nga Ministria e Drejtësisë) **origjinaliteti i këtyre akteve**; **Nuk provohet** , se dy oficerët e SPAK-ut , kanë qenë të autorizuar /urdhëruar , për të marrë / tërhequr dorazi , në Itali / në Prokurorinë e Venecias , këtë praktikë aktesh ; Nuk provohet , **se cilat janë aktet** / të dhënat konkrete të llogarive rrjedhëse bankare përkatëse (që përmbante CD-ja përkatëse , e marrë dorazi në Prokurorinë e Venecias ; shih fq. 132 , 160 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) , të cilat akte/të dhëna , janë ekstraktuar / printuar / shkarkuar eventualisht , nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës ; Këto akte eventuale (të shkarkuara , nga kjo CD) **nuk kanë nëshkrimin** , nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti , në funksion të sigurisë e besueshmërisë procedurale (nëse janë printuar ose jo , prej tij/tyre) ; Provohet , se aktet eventuale të autoriteteve italiane , janë përkthyer , në gjuhën shqipe dhe administrohen , në fletët 160 -173 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit ; **Por nuk vërtetohet** data e përkthimit tyre ; **Nuk provohet** , se përkthyesi të ketë paraqitur / përshkruar **deklaratën e tij** të domosdoshme .

69/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. fletët 160 - 173 të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 20 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 22 / 10 / 2026) ;

70). Provohet , se mbi kërkesën e Prokurorit " Për ndihmë juridike " (drejtuar autoriteteve të drejtësisë të Republikës të Austrisë) , është administruar praktika e akteve të autoriteteve të këtij shteti (nëpërmjet Ministrisë tonë të Drejtësisë ; shih fletët 190 , 218 e 242 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ; Provohet , se aktet e Ministrisë austriake **nuk kanë vulën** , në shkresën përcjellëse të kësaj Ministrie ; krahasoje me fq. 220 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ; Provohet , se **nuk konfirmohen** aktet konkrete (dhe numrin e tyre) , që i janë dërguar , nga autoritetet e Austrisë , Ministrisë të Drejtësisë dhe **nuk konfirmohen** (nga

Ministria e Drejtësisë) **origjinaliteti i këtyre** akteve ; **Nuk konfirmohen** , as aktet konkrete (dhe numrin e tyre) , që ka protokolluar Prokurori / SPAK (shih fq. 218 e 242 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit); Provohet , se aktet e autoriteteve austriake janë përkthyer , në gjuhën shqipe (dhe administrohen , në fletët 243 - 279 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ; **Por provohet** , se fletët 228 (faqja prapa) dhe 237 (faqja prapa) , në emër të shteasit ILIR Metaj **nuk janë përkthyer** , në pjesën e shënimeve ngjitur me barkodet elektronike (shih fletët 228 , 237 , 254 e 270 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) ; **Nuk vërtetohet** , se cili është përkthyesi i këtyre akteve , në gjuhën shqipe ; shih fq. 243 - 279 , po të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) dhe **nuk vërtetohet** data e përkthimit tyre ; Provohet , se përkthyesi **nuk ka paraqitur** / përshkruar deklaratën e tij të domosdoshme .

70/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 243 - 279 të fashikullit nr. 96 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 20 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 22 / 10 / 2026) ;

70/2). Provohet , se mbi kërkesën e Prokurorit " Për ndihmë juridike " (drejtuar autoriteteve të drejtësisë të Republikës të Austrisë) , është administruar praktika e akteve të autoriteteve të këtij shteti (nëpërmjet Ministrisë të Drejtësisë ; shih fq. 280 të fashikullit nr. 96 të Prokurorit ; shih fq. 1 të fashikullit nr. 97 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Provohet , se aktet e Ministrisë austriake administrohen , në fletët 18 - 47 e fashikullit nr. 97 të Prokurorit (por **nuk kanë vulën** , në shkresën përcjellëse të kësaj Ministrie ; shih fq. 18) ; Edhe fletët 77 - 104 (po të fashikullit nr. 97 të Prokurorit , të printuara ato , nga e-maili , që i janë dërguar prokurorit eventualisht , prej Eurojust /shih fq. 76 , po të fashikullit nr. 97 të Prokurorit ; por këto akte / e-maili) , **nuk kanë** as vulën dhe as nënshkrimin e këtij autoriteti dërgues) ; Provohet , se **nuk konfirmohen** aktet konkrete (dhe numrin e tyre) , që i janë dërguar , nga autoritetet Austrisë (adresuar Ministrisë të Drejtësisë

) dhe nga Eurojust (adresuar drejtpërdrejt SPAK-ut) dhe **nuk konfirmohen** (nga Ministria e Drejtësisë dhe SPAK-u) **origjinaliteti** i këtyre akteve ; **Nuk konfirmohen** , as aktet konkrete (dhe numrin e tyre) , që ka protokolluar SPAK - u , në seicilin rast , që i janë paraqitur , pranë saj , këto akte (shih po fq. 17 e 76 , po të fashikullit nr. 97 të Prokurorit) ; Provohet , se fletët 29 - 32 , 39 , 45 (e fashikullit nr. 97 të Prokurorit) , në emër të ILIR Metaj , **nuk kanë vulën dhe as nënshkrimin** e lëshuesit të këtyre faturave / akteve financiare ; Provohet , se prokurori ka caktuar përkthyes të gjuhës gjermane , për përkthimin e akteve , që i kanë përcjellë prokurorit , autoritetet austriake (shih fletët 18 - 47 , 77 - 104 , 107 - 113 , po të fashikullit nr. 97 të Prokurorit) ; Por rezulton , se pjesë përbërëse e këtyre akteve të gjuhës gjermane (objekt përkthimi) janë , edhe aktet e gjuhës angleze (shih fq. 29 , 30 , 39 e 45 , për faturat financiare , në emër të ILIR Metaj , në fashikullin nr. 97 të Prokurorit) ; këto akte janë të përkthyera , në gjuhën shqipe ; shih fq. 59 , 69 e 75 të këtij fashikulli) ; Pra , ky përkthyes i gjuhës gjermane , **nuk kishte njohuri** (dhe nuk ishte në listën përkatëse të Ministrisë të Drejtësisë) , edhe për gjuhën angleze ; Rezulton , se përkthyesi **nuk ka vulë** (shih fq. 298 - 326 të fashikullit nr. 96 të Prokurorit ; shih fq. 48 - 75 , 106 , 112 e 113të fashikullit nr. 97 të Prokurorit) dhe ai nuk ka **paraqitur** / përshkruar deklaratën e tij të domosdoshme .

70/3). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 298 - 326 të fashikullit nr. 96 të Prokurorit ; shih fq. 48 - 75 të fashikullit nr. 97 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 20 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 22 / 10 / 2026) ;

71). Provohet , se Prokurori ka kërkuar " Ndihmë juridike " (drejtuar autoriteteve në SH.B.A ; shih fq. 1 e 18 të fashikullit nr. 98 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Provohet , se kjo letërporosi është dërguar , nëpërmjet Ministrisë të Drejtësisë , e nënshkruar nga një Drejtore e kësaj Ministrie ; Por provohet , se kjo drejtore **nuk kishte kompetencë / urdhër e porosi** , për ta nënshkruar këtë akt (shih fq. 8 , po të këtij fashikulli 98 të

Prokurorit ; krahaso me praktikat e ndjekura , sipas akteve të fq. 173/2 e 174 të fashikullit hetimor nr. 99 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; **Nuk provohet** lista dokumentave (dhe numri i fletëve) , që ka pretenduar SPAK-u për dërgesë , në drejtim të SH.B. A (shih fq. 8 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; **Nuk provohet** , edhe lista e dokumentave (dhe numri i fletëve) , që janë dërguar , nga Ministria e Drejtësisë , në drejtim të SH. B. A (shih fq. 24 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Provohet , se Autoritetet Amerikane kanë dërguar përgjigje me e-mail dt. 26 / 9 / 2022 (shih fq. 18 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Por edhe ky e-mail i është dërguar Prokurorit / SPAK-ut , nga Ministria e Drejtësisë , e nënshkruar nga një Drejtore e kësaj Ministrie ; Provohet , se kjo drejtore **nuk kishte kompetencë / urdhër e porosi** , për ta nënshkruar këtë akt / përgjigje ; Kjo Ministri , **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtij e-maili të autoriteteve të SH.B.A ; Ky e-mail (shih fq. 18 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) , **nuk ka as nënshkrim** dhe **as vulën** e autoriteteve Amerikane ; Provohet qartazi , se fq. 18 (pjesë e këtij e-mail) **nuk është** përkthyer në gjuhën shqipe ; Provohet , se akti i fq. 32 (po të këtij fashikulli / përgjigje e Autoriteteve Amerikane) , **nuk ka as nënshkrim** dhe **as vulën** e autoriteteve Amerikane ; Gjithashtu akti i fq. 32 (po të këtij fashikulli) , **nuk është përkthyer** në pjesën /fragmentet , se cili nëpunës e ka dërguar e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail; Rezulton , se akti i fq. 33 (po të këtij fashikulli / përgjigja e Autoriteteve Amerikane) është përkthyer në gjuhën shqipe , por **nuk identifikohet përkthyesi** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale);

71/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se **nuk konfirmohet lista akteve** të dërguara (nga SPAK-u , Ministria e Drejtësisë) , në SH.BA ; **Nuk konfirmohet origjinaliteti** i aktit / e-mail (dhe i akteve të printuara) të ardhur nga autoritetet e SH.B.A ; Se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 31 e vijues , po të këtij fashikulli) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

71/2). Referuar gjëndjes të e-mail **kërkoj të merret** me letërporosi , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 26 / 9 / 2022 (dhe dokumentacioni saj përbërës / bashkalidhur ; referuar fq.18 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A ; **kërkoj të merret** me letërporosi , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 10 / 4 / 2023 (dhe dokumentacioni saj përbërës , referuar fq. 32 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026) ;

72). Provohet , se me aktin e tyre të dt. 19 / 6 / 2023 (shih fq. 31 të fashikullit hetimor nr. 98 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) , SPAK-u i kërkon Ministrisë të Drejtësisë përkthimin , në gjuhën shqipe të akteve , që i janë dërguar eventualisht (SPAK-ut) , nga autoritetet e SH.B.A ; **Nuk provohet** , se cilat akte konkrete (e numri tyre) i janë dërguar , për përkthim (nga SPAK-u) Ministrisë të Drejtësisë ; Provohet , se Ministria e Drejtësisë , i ka kthyer përgjigje (SPAK-ut) , duke i dërguar aktet e përkthyera (shih fq. 294 e vijim të këtij fashikulli nr. 98 të Prokurorit) ; Provohet , se akti eventual i Autoriteteve Amerikane (shih fq. 36 e 40 , po të këtij fashikulli) **nuk ka vulën** e autoritetit ; Provohet , se **mungon** akti / e-mail dt. 16 / 6 / 2023 , në gjuhën angleze i Autoriteteve Amerikane (me reference shqiptare të letërporosisë nr. 3085 dhe me reference amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linja 2 , objekt përkthimi (shih fq. 42 të këtij fashikulli) ; Provohet , se **mungon** akti / e-mail dt. 16 / 6 / 2023 , në gjuhën angleze i Autoriteteve Amerikane (me reference shqiptare të letërporosisë nr. 3040 dhe me reference amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linja 1 , objekt përkthimi (shih fq. 38 të këtij fashikulli) ; Provohet , se **mungon** akti / e-mail dt. 16 / 6 / 2023 , në gjuhën angleze i Autoriteteve Amerikane (me reference shqiptare të letërporosisë nr. 3285 dhe me reference amerikane nr. CRM -182 - 85321 , objekt përkthimi (shih fq. 41 , po të këtij fashikulli) ; **Nuk provohet** autenticiteti i akteve në gjuhën angleze , objekt eventual përkthimi (shih aktet në fq.120 - 186 , 212 - 236 , 262 - 293 , 328 - 330 të këtij fashikulli ; Pra , **nuk provohet** me siguri procedurale , nëse aktet e këtyre faqeve , janë në të vërtetë / pikërisht aktet e dërguara , në

formë elektronike /manuale (në përgjigje të letërporosisë të SPAK-ut , nga autoritetet e SH.B.A ; shih fq. 311 , të këtij fashikulli) ; Pretendoj , se asnjë nga këto akte , **nuk janë të nënshkruara** nga nëpunësi përgjegjës / oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar , nga formati i tyre fillestar elektronik) dhe **nuk kanë datën e printimit tyre** (të cilat , në vijim , i janë vënë në dispozicion përkthyeses) ; Kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale ; **Nuk provohet , se cilat akte konkrete** (118 faqe totale) i janë dhënë përkthyeses , për të kryer përkthimin (shih fq. 45 të këtij fashikulli) ; Nuk provohet **data e përkthimit** , në gjuhën shqipe të aktit / e-mail dt. 16 / 6 / 2023 , ora 22:17 , me reference shqiptare nr. 3040 , dërguar eventualisht nga autoritetet e SH.B.A -s (shih fq. 38 ë këtij fashikulli) ; Nuk provohet **data e përkthimit** , në gjuhën shqipe të aktit(nëpërmjet e-mail) dt. 16 / 6 / 2023 , me reference shqiptare nr. 3040 , dërguar eventualisht nga autoritetet e SH.B.A -s (shih fq. 39 të këtij fashikulli) ; Nuk provohet **data e përkthimit** , në gjuhën shqipe të aktit / e-mail dt. 16 / 6 / 2023 , ora 22:17 , me reference shqiptare nr. 3285 , dërguar eventualisht nga autoritetet e SH.B.A -s (shih fq. 41 të këtij fashikulli) ; Nuk provohet **data e përkthimit** , në gjuhën shqipe të aktit (nëpërmjet e-mail) dt. 16 / 6 / 2023 , me reference shqiptare nr. 3085 , dërguar eventualisht nga autoritetet e SH.B.A -s (shih fq. 42 të këtij fashikulli) ; Rezulton , se aktet e përkthimit , në gjuhën shqipe (shih fq. 52 - 119 , 187 - 211 , 237 - 261 , 305 - 309 , 325 - 327 , 337 - 339 të këtij fashikulli) , nuk kanë **datën e përkthimit** tyre ; Kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Provohet , se aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe (në fq. 112 e 115 të këtij fashikulli) , **nuk përmbajnë nënshkrimin** e përkthyeses ; Provohet , se përkthyesja **nuk ka vulën** e saj dhe përkthyesja **nuk ka paraqitur** deklaratën e saj të domosdoshme . Provohet , se akti /e-mail dt. 01 / 9 / 2023 i autoriteteve të SH.B.A -s (shih fq. 319 të këtij fashikulli) **nuk ka as nënshkrim dhe as vulën e autoriteteve** ; Provohet , se ky e-mail , **nuk është përkthyer ,** në pjesën / fragmentet , se cili nëpunës e ka dërguar e-mail dhe kujt i dërgohet ai e-mail ; Ky e-mail **nuk ka datën e përkthimit** dhe **nuk identifikohet** përkthyesi (por ka vetëm nënshkrimin) ; Kjo datë përkthimi nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale ; Provohet , se aktet në gjuhën angleze (të dërguara eventualisht nga Autoritetet Amerikane të Drejtesisë (shih fq. 328 - 330 të këtij fashikulli) , **nuk janë përkthyer** , në gjuhën shqipe ;

72/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 38 - 42 , 112 , 115 , 52 - 119 , 187 - 211 , 237 - 261 , 305 - 309 , 320 , 325 - 327 , 337 - 339 të fashikullit hetimor nr.98) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

72/2). Referuar gjëndjes të e-mail dhe akti nëpërmjet e-mail , **kërkoj të merret** me letërporosi , nga autoritetet Amerikane aktet vijuese :

- akti (nëpërmjet e-mail) dt.16 / 6 / 2023 dhe dokumentacioni saj eventual përbërës / bashkalidhur (referuar fq. 36 të fashikullit nr. 98) ;

- akti manual / e-mail dt.01 / 9 / 2023 dhe dokumentacioni saj eventual përbërës / bashkalidhur (referuar fq. 319 të fashikullit nr. 98);

Kjo letërporosi (lidhur me këto dy akte) t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

72/3). Meqenëse ka lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe me pafajësinë time , **kërkoj** që Prokurori të paraqesë në gjykim aktin (nëpërmjet e-mail) të dt. 16 / 6 / 2023 , në gjuhën angleze i Autoriteteve Amerikane (me reference shqiptare të letërporosisë nr. 3085 dhe me reference amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linja 2 , objekt përkthimi (shih për orientim fq. 42 , po të këtij fashikulli) ;

72/4). Meqenëse ka lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe me pafajësinë time , **kërkoj** , që Prokurori të paraqesë në gjykim e-mail të dt. 16 / 6 / 2023 , në gjuhën angleze i Autoriteteve Amerikane (me reference shqiptare të letërporosisë nr. 3040 dhe me reference amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linja 1 , objekt përkthimi (shih për orientim fq. 38 , po të këtij fashikulli) ;

72/5). Meqenëse ka lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe me pafajësinë time , **kërkoj** që Prokurori të paraqesë në gjykim e-mail të dt. 16 / 6 / 2023 , në gjuhën angleze i Autoriteteve Amerikane (me reference shqiptare të letërporosisë nr. 3285 dhe me reference amerikane nr. CRM -182 - 85321 , objekt përkthimi (shih për orientim fq. 41 , po të këtij fashikulli) ;

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026) ;

73). Provohet , se Prokurori / SPAK- u ka kërkuar " ndihmë juridike " (nëpërmjet Ministrisë të Drejtësisë) drejtuar Autoriteteve Amerikane (shih fq.1 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Rezulton , se në faqen 9 të kësaj letërporosie , përshkruhet (ndër të tjera) , se " .. *bashkalidhur janë 10 dokumenta* ..." ; Por provohet , se këto akte / dokumenta bashkalidhur **janë gjithësej 9** (dhe jo 10 ; shih fq. 12 - 21 të këtij fashikulli ; gjithashtu mungon , në këtë fashikull , fq. 20) ; Pretendohet nga prokurori , sikur këto dokumenta / akte / prova shkresore janë siguruar eventualisht , nga aparati celular i sekuestruar të pandehurës Monika (referuar kontrollit të banesës , që edhe ajo posedonte) ; Provohet , se këto akte të siguruar eventualisht , nga memoria e këtij telefoni celular (dhe që pretendohet , se i bashkalidhen kësaj letërporosie) , **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar / shkarkuar / ekstraktuar) dhe **nuk kanë datën e printimit tyre** ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten këto 9 apo 10 akte (dhe që i janë dërguar eventualisht Autoriteteve Amerikane) **vihet në dyshim** (sepse nuk ka siguri procedurale dhe autenticitet) , nëse këto janë aktet që gjënden / konstatohen realisht ? , nëse janë printuar /ekstraktuar , nga ky telefon ? dhe vihet në dyshim subjekti procedural , që i ka printuar ato ; Referuar edhe pretendimeve / kërkesave / kundërshtimeve / shkaqeve ligjore / arsyeve të mia parashtruar ne aktet e mia përkatësisht të dt. 29 / 7 / 2026 , të dt. 22 / 9 / 2026 dhe të dt. 29 / 9 / 2026 (që unë ju kam paraqitur paraprakisht , në Gjykatë , lidhur me të dhënat / faktet / informacionin e siguruar eventualisht , nga telefoni celular me nr. IMEI 013428000432516) pretendoj , se edhe këto akte (që i janë bashkalidhur eventualisht , kësaj letërporosie) , **nuk përbëjnë prova** ; Provohet , se edhe Ministria e Drejtësisë , nuk përcakton , se cilat akte konkrete ka dërguar bashkalidhur kësaj letërporosie (shih fq. 34 - 45 , po të këtij fashikulli) ; Provohet

, se përgjigja e Autoriteteve Amerikane (për këtë letërporosi) ka ardhur fillimisht me e- mail të dt. 15 / 4 / 2024 (shih fq. 46 e 47, po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Provohet , se ky e-mail i Autoriteteve Amerikane , **nuk është nënshkruar** , **nuk ka vulën e autoriteteve** amerikane dhe **nuk është përkthyer** në gjuhën shqipe ; Rezulton , se Autoritetet Amerikane kanë kthyer eventualisht përgjigje një letërporosie të kërkuar (nëpërmjet Ministrisë të Drejtësisë ; shih fq. 22 , po të këtij fashikulli) , nga SPAK-u ; Por kjo Ministri **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtij e-mail bashkalidhur saj ; Kjo Ministri komunikon , sikur bashkalidhur aktit të saj përcjellës është e-mail dt. 22 / 4 / 2024 (shih fq. 22 , 23 , po të këtij fashikulli) ; Por **provohet , se** bashkalidhur saj është e-mal i dt. 15 / 4 / 2024 ; Provohet , se ky e-mail / fq. 23 i dt. 15 / 4 / 2024 **nuk është nënshkruar** dhe **nuk ka vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se përkthimi i saj , në gjuhën shqipe , **nuk ka datën e përkthimit** dhe **nuk identifikohet përkthyesi** (por ka vetëm nënshkrimin ; shih fq. 24 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit ; kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Gjithashtu ky e-mail **nuk është përkthyer plotësisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail) ; Rezulton , se Autoritetet Amerikane kanë kthyer eventualisht përgjigje e-mail një letërporosie , kërkuar (nëpërmjet Ministrisë të Drejtësisë ; shih fq. 25 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) , nga SPAK-u ; Por kjo Ministri **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtij e-maili bashkalidhur saj ; Kjo Ministri komunikon , sikur bashkalidhur aktit të saj përcjellës është e-mail dt. 15 / 4 / 2024 (shih fq. 25 , 26 po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Por provohet , se bashkalidhur është e-mal i dt. 22 / 4 / 2024 ; Provohet , se ky e-mail / fq. 26 i dt. 22 / 4 / 2024 **nuk është nënshkruar** dhe **nuk ka vulën e autoriteteve** amerikane ; Provohet , se përkthimi i saj , në gjuhën shqipe , **nuk ka datën e përkthimit** dhe **nuk identifikohet përkthyesi** (por ka vetëm nënshkrimin ; shih fq. 27 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit ; kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Gjithashtu ky e-mail **nuk është përkthyer plotësisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili nëpunës e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail) ;

73/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 24 e 27 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave

zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

73/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara e-mail ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me çështjen objekt gjykimi dhe me pafajësinë time , **kërkoj** :

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt.15 / 4 / 2024 , ora 09:37 PM dhe dokumentacioni saj eventual përbërës / bashkalidhur (referuar fq. 23 të sipërcituar , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 22 / 4 / 2026 , ora 11:19 PM dhe dokumentacioni saj eventual përbërës / bashkalidhur (referuar fq. 26 të sipërcituar , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 15 / 4 / 2024 , ora 09:37 PM dhe dokumentacioni saj eventual përbërës / bashkalidhur (referuar fq. 46 të sipërcituar , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2) ;

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026) ;

74). Provohet , se Prokurori / SPAK - u (me aktin e tyre dt. 03 / 5 / 2024) ka kërkuar " ndihmë juridike shtesë " (nëpërmjet Ministrisë tonë të Drejtësisë) drejtuar Autoriteteve të Drejtësisë (shih fq. 29 , po të këtij fashikulli nr. 99 të

Prokurorit) ; Por provohet , se për aktet vijuese (shih fq. 32 , 33 , 54 - 56 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) nuk administrohet vendimi " për caktimin e përkthyesit " , përkthimi i saj/tij , **nuk ka datën e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) , përkthyesi **nuk ka vulën e tij** , në këto akte dhe përkthyesi nuk ka paraqitur / përshkruar **deklaratën e tij** të domosdoshme . Rezulton , se Autoritetet Amerikane i kanë kthyer eventualisht përgjigje (me tre e-mail të të njëjtës datë 26 / 7 / 2024 , në orare të ndryshme) , kësaj letërporosie dhe i është përcjellë SPAK-ut (shih fq. 61 /akti i Ministrisë , po në këtë fashikull nr. 99 të Prokurorit) ; Por kjo Ministri **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtyre tre e-mail bashkalidhur saj (shih këto tre e-mail , në fq. 62 e 63 , po të këtij fashikulli) ; Provohet , se këto tre e-mail **nuk janë të nënshkruara** dhe **nuk kanë vulën e autoriteteve** amerikane ;

74/1). Provohet , se e-mail i parë (e identifikuar me 3-3) **është përkthyer pjesërisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail ; shih përkthimin e këtij e-mail , në fq. 64 të këtij fashikulli) ;

74/2). Provohet , se e-mail i dytë (e identifikuar me 2-3) **nuk është përkthyer** (shih fq. 64 të këtij fashikulli) ; Provohet , se Prokurori **nuk ka kërkuar sqarime** nga Ministria (nuk argumentohet shkaku i këtij mosveprimi) ;

74/3). Provohet , se e-mail i tretë (e identifikuar me 1-3) **është përkthyer pjesërisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail ; shih përkthimin e këtij e-mail , në fq. 64 të këtij fashikulli) ;

74/4). Provohet , se përkthimi i këtyre dy e-mail (të identifikuara me 1-3 , 3-3 ; shih fq. 64 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) , **nuk kanë datën e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) dhe **nuk identifikohet përkthyesi** ;

74/5). Provohet , se e-mail i tretë (e identifikuar me 1-3) përmban , në formë elektronike (dhe ato i bashkalidhen , pas printimit tyre) aktet e administruara , në

fq. 65 e vijim të fashikullit nr. 99 të Prokurorit ; Por provohet , se akti / e-mail i fq. 65 të Autoriteteve Amerikane , **nuk përmban vulën e tyre** ;

74/6). Provohet , se e-mail i Autoriteteve Amerikane (të identifikuara me 1 - 3 , 3 - 3 ; shih fq. 62 , 63 , po të këtij fashikulli) i bashkalidhen (sipas formatit tyre elektronik) aktet /të dhënat eventuale , manuale bankare (gjithësej 245 fletë ; shih fq. 67 - 81 , 173/7 - 173/21 , po të këtij fashikulli) ; Provohet , se Prokurori **nuk ka sqaruar** shkakun e numërtimit të akteve , në këtë formë /mënyrë renditje 173/7 - 173/21 , çka vë në dyshim mjaftueshëm dhe pretendoj për mungesë objektiviteti e besueshmërie të veprimeve / akteve procedurale , objekt i këtij numërtimi dhe për kohën e krijimit tyre ; Provohet , se Prokurori ka printuar vetëm fletët e këtij formati elektronik , me numrat vijues 1 , 2 , 4 , 5 , 6 , 87 , 95 , 104 , 108 , 113 , 118 , 123 , 128 e 203 (dhe nuk janë printuar fletët tjera) ; Megjithëse ishin të detyruar (për arsye objektiviteti e besueshmërie të veprimeve procedurale) provohet , se prokurori nuk argumenton qëllimisht shkakun e këtij mosveprimi ; Këto akte (që nuk janë printuar) **kanë lidhje me fakte e rrethana , që provojnë pafajësine time** ; Provohet , se këto faqe/akte të printuara (si më lart) , **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar) dhe **nuk kanë datën** e printimit tyre (kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten këto akte të printuara (si më lart) **vihet në dyshim** (sepse nuk ka siguri procedurale , dhe autenticitet) , nëse këto janë aktet , që gjënden / konstatohen realisht , në këto dy e-maile ? dhe vihet në dyshim subjekti procedural , që i ka printuar ato dhe për programet elektronike të printimit ; Provohet , se këto akte të printuara (si më lart) janë përkthyer në gjuhën shqipe (administruar në fq. 173/25 - 173/39 , po të këtij fashikulli) ; Provohet se Prokurori nuk ka sqaruar shkakun e numërtimit të akteve , në këtë formë /mënyrë renditje 173/25 - 173/39 , çka vë në dyshim mjaftueshëm dhe pretendoj për mungesë objektiviteti e besueshmërie të veprimeve / akteve procedurale , objekt i këtij numërtimi dhe për kohën e krijimit tyre ; Provohet gjithashtu , se(për këto akte të përkthyera) , nuk administrohet vendimi " për caktimin e përkthyesit " ; përkthimi i tyre , **nuk ka datën e përkthimit ,** nga përkthyesi (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Rezulton , se përkthyesi **nuk ka vulën e tij** (në këto akte) dhe përkthyesi , nuk ka paraqitur / përshkruar (në këto akte) **deklaratën e tij** të domosdoshme .

74/7). Provohet , se e-mail i Autoriteteve Amerikane (të identifikuara me 1-3 , 3 - 3 ; shih fq. 62 , 63 , po të këtij fashikulli) i bashkalidhen (sipas formatit tyre elektronik) aktet /të dhënat e tjera eventuale , manuale bankare (gjithësej 31 fletë ; shih fq. 84 -114 , po të këtij fashikulli) ; Provohet , se këto 31 faqe të printuara , **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar) dhe **nuk kanë datën** e printimit (kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten këto akte të printuara (si më lart) **vihet në dyshim** (sepse nuk ka siguri procedurale dhe autenticitet) , nëse këto janë aktet , që gjënden / konstatohen realisht , në këto dy e-maile ? dhe vihet në dyshim autoriteti procedural , që i ka printuar ato dhe për programet elektronike të printimit ;

74/8). Provohet , se e-mail i Autoriteteve Amerikane (të identifikuara me 1 - 3 , 3 - 3 ; shih fq. 62 , 63 , po të këtij fashikulli) i bashkalidhen (sipas formatit tyre elektronik) aktet /të dhënat e tjera eventuale , manuale bankare , me **35** fletë (por mungon fleta e printuar me nr. 35 dhe administrohen në fashikull gjithësej 34 fletë ; shih fq. 115 - 148 , po të këtij fashikulli) ; Provohet , se këto 34 faqe të printuara , **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar) dhe **nuk kanë datën** e printimit (kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri , procedurale ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten këto akte të printuara (si më lart) **vihet në dyshim** (sepse nuk ka siguri procedurale dhe autenticitet) , nëse këto janë aktet , që gjënden / konstatohen realisht , në këto dy e-maile ? dhe vihet në dyshim autoriteti procedural , që i ka printuar ato dhe për programet elektronike të printimit ;

74/9). Provohet , se ka çrregullime të pashpjegueshme , në numërtimin e fletëve të këtij fashikulli 99 , sepse pas faqes fillestare 148 , fletët vijuese numërtohen , përsëri me numra 142 - 148 ; Edhe këto fletë (të administruara në faqet e reja me numra 142 - 148 të këtij fashikulli) **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar / shkarkuar / ekstraktuar) dhe **nuk kanë datën** e printimit / ekstraktimit tyre (kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri , në bazë të elementëve , që përmbahen në vetë aktin ose në aktet e tjera , që lidhen me të) ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten këto akte të printuara (si më lart) **vihet në dyshim** (sepse nuk ka siguri procedurale , vërtetësi , besueshmëri dhe autenticitet) , nëse këto janë aktet , që gjënden / konstatohen

realisht , në këto dy e-maile ? dhe vihet në dyshim autoriteti procedural , që i ka printuar ato dhe për programet elektronike të printimit ;

74/10). Provohet , se faqet vijuese 145 - 173 (po të këtij fashikulli) **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar) dhe **nuk kanë datën** e printimit tyre (kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten këto akte të printuara (si më lart) **vihet në dyshim** (sepse nuk ka siguri procedurale dhe autenticitet) , nëse këto janë aktet , që gjënden / konstatohen realisht , në këto dy e-maile ? dhe vihet në dyshim autoriteti procedural , që i ka printuar ato dhe për programet elektronike të printimit ;

74/11). Provohet , se fq. 84 - 173 (po të këtij fashikulli dhe aktet e numërtuara gabimisht , pas faqes fillestare 148) **nuk janë përkthyer** në gjuhën shqipe ;

74/12). Prokurori kërkon të merren aktet e sipërcituara , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 32 , 33 , 54 - 56 , 173/25 - 173/39 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi;

74/13). Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe kanë lidhje me rrethanat e kësaj çështje , **kërkoj** të printohen fletët e tjera , që mungojnë (e konkretisht të printohen fletët me numra 3 , 7 - 86 , 88 - 94 , 96 - 103 , 105 - 107 , 109 - 112 , 114 - 117 , 119 - 122 , 124 - 127 , 129 - 202) ;

74/14). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara e-mail ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi , **kërkoj** :

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane aktet manuale / tre e-mail të datave 26 / 7 / 2024 dhe dokumentacioni tyre eventual përbërës / bashkalidhur secilit e-mail (referuar fq. 62 , 63 të sipërcituar , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata

, që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail i dt. 26 / 7 / 2024 (referuar fq. 65 të sipërcituar , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

74/15). Meqenëse fq. 84 - 173 (dhe aktet e numërtuara gabimisht , pas faqes fillestare 148 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) **nuk janë përkthyer** , në gjuhën shqipe dhe kanë lidhje mjaftueshëm me çështjen objekt gjykimi , **kërkoj përkthimin e tyre** (sipas neneve 123 - 126 e 196 të K. Pr. Penale ; Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026) ;

75). Lidhur me letërporosinë nr. L 140/3 dt. 07 / 10 / 2022 (shih fq. 173/1 , po të fashikullit nr. 99) provohet , se SPAK-u i ka dërguar (për përkthim) Ministrisë të Drejtësisë , kopjen e aktit elektronik , në gjuhën angleze ; Por nuk provohet , se cilat akte konkrete (e numri tyre) ka dërguar SPAK-u , për përkthim ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten ky / këto akte **vihet në dyshim** dokumentacioni , që ka dërguar , për përkthim (sepse nuk ka siguri dhe besueshmëri , për këtë korespondencë procedurale) ; Provohet , se kjo Ministri i kthen përgjigje SPAK-ut (shih fq. 173/2 , po të këtij fashikulli) ; Por provohet , se edhe kjo Ministri , **nuk përcakton** , se cilat akte konkrete të përkthyera , i ka përcjellë SPAK -ut ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten edhe ky/këto akte , **vihet në dyshim** dokumentacioni i përkthyer , që ju dërgua SPAK -ut (sepse edhe në këtë rast , nuk ka siguri dhe besueshmëri , për këtë korespondencë procedurale) ; Provohet , se për e-mail të dt. 26 / 7 / 2024 , ora 16.[41] të Autoriteteve Amerikane (shih fq. 173/4 e 310 , po të këtij fashikulli) **nuk konfirmohet origjinaliteti i saj** ; Provohet , se edhe ky e-mail **nuk është nënshkruar** dhe **nuk e ka vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se akti i përkthyer në gjuhën shqipe (shih fq. 173/22 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) , **nuk ka datën e përkthimit** (kjo datë përkthimi

, nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; përkthyesi **nuk ka vulën e tij** , në këtë akt dhe përkthyesi nuk ka paraqitur **deklaratën e tij** të domosdoshme .

75/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se Prokurori **nuk ka sqaruar** shkakun e numërtimit të akteve , në këtë formë /mënyrë renditje 173/1 - 173/4 (pretendoj , për mungesë objektiviteti e besueshmërie të veprimeve / akteve procedurale , objekt i këtij numërtimi) ;. Se akti i sipërcituar / e-mail i dt. 26 / 7 / 2024 i Autoriteteve Amerikane (shih fq. 173/4 e 310 , po të këtij fashikulli) dhe akti i përkthyer në gjuhën shqipe (shih fq.173/22 , po të këtij fashikulli) , **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentit zyrtar) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

75/2). Kërkoj që SPAK-u të sqaroj , se cilat akte konkrete , në gjuhën angleze , ka dërguar (për përkthim) , në Ministrinë e Drejtësisë ;

75/3). Ti kërkohet Ministrisë të Drejtësisë të sqarojë , konfirmojë dhe të paraqesë në Gjykatë : se cilat akte konkrete (në gjuhën angleze) , i ka paraqitur (SPAK-u) asaj / Ministrisë , për tu përkthyer ;se cilat akte (të përkthyera , në gjuhën shqipe) i ka dërguar ajo / kjo Ministri , SPAK-ut ;

75/4). Referuar gjëndjes të aktit të sipërcituar e-mail ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi , **kërkoj të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane , akti manual / e-mail i dt. 26 / 7 / 2024 , ora 16.[41] dhe dokumentacioni saj eventual përbërës / bashkalidhur ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026) ;

76). Referuar aktit (nëpërmjet e-mail) dt. 26 / 7 / 2024 të Autoriteteve Amerikane , me referencë shqiptare të letërporosisë nr. 122/2022 dhe 3285/Prot/A.H. dhe

referencë amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linjat 1 e 2 (shih fq. 173/5 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit dhe i përkthyer , në gjuhën shqipe ; shih përkthimin në fq. 173/23 të këtij fashikulli) dhe sipas vendimit gjyqësor përkatës në SH.B.A parashikohej , që ekzekutimi i kërkesës të palës shqiptare të *trajtohej si konfidenciale dhe e padisponueshme , vetëm për publikun* ; Por më dt. 26 / 7 / 2024 e vijim (që ka ardhur ky e-mail , në Ministrinë tonë të Drejtësisë / nëpunëses Alba Thoma) , unë nuk isha " palë publike " (por isha person nën hetim / palë drejtëpërdrejtë e interesuar) . Prokurori nuk ka pretenduar , se aktet përkatëse objekt letërporosie , janë akte sekrete , si dhe nuk ka pretenduar , në asnjë lloj faze e deri tani , ekzistencën e ndalimeve përkatëse konkrete , sipas nenit 511 të K. Pr. Penale. Provohet , se Prokurori **nuk ka sqaruar** shkakun e numërtimit të akteve , në këtë formë / mënyrë renditje 173/5 - 173/23 , çka vë në dyshim mjaftueshëm dhe pretendoj , për mungesë objektiviteti e besueshmërie të veprimeve / akteve procedurale , objekt i këtij numërtimi dhe për kohën e krijimit tyre ;. **Provohet** , se ky akt i dt. 26 / 7 / 2024 , **nuk përmban vulën** e Autoriteteve Amerikane ; **Provohet** deri tani , se Prokurori , nuk i ka kërkuar / dërguar Departamentit të Drejtësisë të SHBA sqarime / argumenta shtesë , në lidhje me pozitën time procedurale penale , prej dt. 26 / 7 / 2024 (kur erdhi ky e-mail) e vijim , si i paraburgosur / i pandehur (pas dt. 21 / 10 / 2024 , që unë u arrestova) ; Prokurori nuk i ka kërkuar /informuar sqarime Departamentit të Drejtësisë të SHBA , nëse shprehja (në këtë akt të dt. 26 / 7 / 2024) " të tjerëve " , a e përfshinte , edhe pozitën time procedurale penale (si i paraburgosur / i pandehur) , për t'u kufizuar unë , me njohjen e akteve përkatëse ? (shih nenin 511 të K. Pr. Penale) ; Mosveprimi dhe moskryerja e këtyre veprimeve , nga Prokurori , **është në kundërshtim** me nenet 1 e vijues , 8/a e vijues , 509 e vijues të këtij kodi dhe ka cënuar lirinë time personale ; Pra , pretendoj se prokurori parimisht dhe në këtë çështje duhet të mblidhte / kërkonte / merrte dhe të shqyrtonte , si provat , që më fajësojnë eventualisht , ashtu edhe provat , që janë në favorin tim . Pra , në mungesë të këtij informacioni / faktesh / të dhënash / /aktesh / provash , nga Departamenti i Drejtësisë të SH.B.A pretendoj , se mungonte një bazë e plotë faktike , prej dt. 26 / 7 / 2024 (që erdhi ky akt) e në vijim , për aplikimin ndaj meje , deri më dt. 21 / 10 / 2024 dhe pas kësaj date , të masës të sigurimit personal procedural penal . Mosveprimi dhe moskryerja e këtyre veprimeve , nga Prokurori , prej 2 vitesh (nga dita , që Autoritetet Amerikane , kanë njoftuar këtë e-mail) provojnë , se **është kufizuar mjaftueshëm** e <u>drejta ime (si palë direkte e</u>

interesuar) , për tu njohur , me aktet / të dhënat / informacionin objekt i letërporosisë (administruar ato aktualisht , në SH.B.A) ; është cënuar mjaftueshëm e drejta ime e mbrojtjes efektive /efikase / praktike , gjatë hetimit penal , në seancë paraprake gjyqësore dhe deri në këtë fazë ; është cënuar mjaftueshëm parimi i kondradiktoritetit (lidhur me njohjen time , me të gjitha provat / aktet e çështjes , gjatë hetimit penal , sipas nenit 31/a,b të Kushtetutës dhe nenit 34/a , shkronja " ë " të K. Pr. Penale) ; nuk janë sqaruar disa rrethana të hetimit dhe është cënuar mjaftueshëm liria ime personale. Këto dispozita nuk pengojnë njohjen time , me provat (por lejojnë njohjen time me materialet e çështjes hetimore) . Për këto fakte / shkaqe pretendoj , se prej dt. **26 / 7 / 2026** e në vijim (e deri tani) , nuk ekziston asnjë lloj pengese procedurale , për ekzekutimin , nga Departamenti i Drejtësisë të SHBA , të kërkesës të Prokurorit , për marrjen e ndihmës juridike , lidhur me aktet / informacionin / të dhënat / provat përkatëse.

76/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se akti (nëpërmjet e-mail) dt. 26 / 7 / 2024 i Autoriteteve Amerikane dhe akti i përkthimit të saj , në gjuhën shqipe (shih fq. 173/5 e 173/23 , po të këtij fashikulli) , **nuk përbëjnë prova shkresore** (në formën e dokumentit zyrtar) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

76/2). Kërkoj të merret nga Ministria e Drejtësisë , kërkesa " për ndihmë juridike ", që Prokurori ka depozituar , në këtë Ministri dhe që ka lidhje me këtë përgjigje / e-mail të Autoriteteve Amerikane (me referencë shqiptare të letërporosisë nr. 122/2022 dhe 3285/Prot/A.H. dhe referencë amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linjat 1 e 2) ;

76/3). Kërkoj të merret nga Ministria e Drejtësisë kërkesa/t me referencë shqiptare të letërporosisë nr. 122/2022 e 3285/Prot/A.H. dhe referencë amerikane nr. CRM -182 - 85321 (linjat 1 e 2) , që Ministria e Drejtësisë i ka **dërguar** Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A ;

76/4). Referuar gjëndjes të aktit të sipërcituar e-mail pretendoj , që Gjykata t'i kërkojë me letërporosi , Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A sa vijon :

i).Të sjellë aktin eventual (nëpërmjet e-mail) dt. 26 / 7 / 2024 , me vulën përkatëse të autoriteteve ;

ii). Të kërkohet ekzekutimi i letërporosisë të prokurorit ; të kërkohet paraqitja e të dhënave / informacionit / akteve , objekt i letërporosisë tij / prokurorit dhe për kërkesa /pretendime të tjera eventuale , me referencë shqiptare të kësaj letërporosie ;

iii). **Të kërkohet paraqitja e vendimit gjyqësor të Gjykatës përkatëse të SH.B.A** , që ka vendosur kufizimin , për 2 vjet kohë të informacionit , objekt i kësaj letërporosie.

iv). **Të kërkohet paraqitja e kërkesës të palës të interesuar** , me objekt " kufizimin e informacionit dhe për konfidencialitet ", drejtuar prej saj , gjykatës përkatëse në SH.B.A.

v). Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

vi). Për këto shkaqe/arsye , rrethana / fakte kërkoj , që Gjykata të caktojë (sipas neneve 123 - 126 , 509 të K. Pr. Penale) një përkthyes të licensuar dhe të regjistruar , në Ministrinë e Drejtësisë , për t'u paraqitur për betim (në një seancë të ndërmjetme) dhe për të përkthyer në gjuhën angleze të zbatuar në SH.B.A , kërkesat / pyetjet e mia eventuale , kërkesat / pyetjet eventuale të tjera të prokurorit dhe kërkesat / pyetjet eventuale të Gjykatës. Teksti i plotë i kërkesës t'i dërgohet (nga Gjykata) Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , duke patur parasysh / referencë / konisederatë përmbajtjen e e-mail eventual të dt. 26 / 7 / 2024 të Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A.

vii). Kërkoj që një kopje e kësaj letërporosie (që do t'i dërgohet , nga Gjykata , Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A) të më jepet edhe mua , për njohje .

viii). Pasi të paraqitet përgjigja përkatëse (prej Departamentit të Drejtësisë të SHBA) kërkoj të përkthehet , të shqyrtohet / diskutohet dhe të administrohet , si provë , sipas radhës përkatëse procedurale ;

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026) ;

77). Provohet , se Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë SPAK-ut kërkesën (me e-mail të dt. 08 / 8 / 2024) të Autoriteteve Amerikane (shih fq. 174 e 175 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Por provohet , se kjo Ministri , **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtij e-maili të autoriteteve të SH.B.A ; Provohet , se ky e-mail , **nuk ka nënshkrimin** dhe nuk ka **as vulën** e këtyre Autoriteteve ; Provohet , se ky e-mail është përkthyer në gjuhën shqipe (shih fq. 176 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) ; Por rezulton se ky akt **nuk ka nënshkrimin e përkthyesit** (krahaso me aktet e fq. 23 e 24 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) **, nuk identifikohet përkthyesi** dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ;

77/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se akti i përkthyer në gjuhën shqipe (shih fq. 176 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) **nuk përbën provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

77/2). Referuar gjëndjes të aktit të sipërcituar e-mail ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me çështjen objekt gjykimi dhe me pafajësinë time , **kërkoj** të merret me letërporosi , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail i dt. 08 / 8 / 2024 , me nënshkrim dhe vulën e autoriteteve ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026 ;

78). Provohet , se më dt. 18 / 7 / 2024 Prokurori / SPAK-u ka caktuar përkthyes , me shkakun se (në bazë të kërkesës tyre nr. L 140/4 Prot. dt. 14 / 10 / 2022) i janë përcjellë (në formë elektronike / me CD) atyre / SPAK- ut , akti (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 7 / 2024 dhe aktet e tjera , prej Autoriteteve Amerikane (shih fq. 178 , 188 , 241 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) , me referencë shqiptare të letërporosisë nr. 122/2022 e 3285/Prot/A.H. dhe me referencë amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linjat 1 e 2 ; Rezulton , se SPAK-u dhe/ose Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtij e-mail dhe akteve të tjera bashkalidhur , të autoriteteve të SH.B.A ; Provohet , se ky akt (nëpërmjet e-mail) , **nuk ka vulën** e këtyre Autoriteteve ; **Nuk provohet , se** cilat akte konkrete të printuara elektronikisht , kanë qenë objekt përkthimi dhe i janë dhënë në vijim (nga prokurori) , përkthyesit , për tu përkthyer , në gjuhën shqipe (shih fq. 182 - 186 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten këto akte **vihet në dyshim** dokumentacioni , që SPAK-u ka dërguar , për përkthim (sepse nuk ka siguri dhe besueshmëri procedurale , për këtë korespondencë procedurale) ; Provohet , se (me përjashtim të këtij e-mail) asnjë nga aktet e tjera vijuese , të printuara (shih fq. 190 - 240 të këtij fashikulli) , **nuk janë të nënshkruara** nga nëpunësi përgjegjës / oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar , nga formati i tyre fillestar elektronik / me CD) dhe **nuk kanë datën e printimit tyre** (të cilat , në vijim , i janë vënë në dispozicion përkthyesit , për përkthim) ; Kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale (pra , pretendoj **se nuk provohet** vërtetësia dhe autenticiteti i akteve të gjuhës angleze , objekt eventual përkthimi) ; Provohet , se aktet e sipërcituara të përkthyera në gjuhën shqipe , **nuk ka datën e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; përkthyesi **nuk ka vulën e tij** , në këto akte (shih fq.185 , 186 , 242 - 298) dhe përkthyesi nuk ka paraqitur / përshkruar **deklaratën e tij** të domosdoshme .

78/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe (shih aktin nëpërmjet e-mail dt. 15 / 7 / 2024 etj. , të administruar në fq. 242 - 298 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj

meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

78/2). Referuar gjëndjes të aktit të sipërcituar nëpërmjet e-mail ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time , kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe përveç sa ju kam kërkuar / për këtë akt (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 7 / 2024 të Autoriteteve Amerikane) , kërkoj gjithashtu **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 7 / 2024 (me vulë të autoriteteve) dhe aktet e tjera bashkalidhur saj (referuar fq. 188 - 240 të sipërcituar , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026 ;

79). Provohet , se Autoritetet Amerikane i kanë dërguar / adresuar eventualisht (SPAK-ut / Prokurorit dhe Ministrisë së Drejtësisë) e-mail dt. 03 / 9 / 2024 , ora 16:13 (shih fq. 299 e 305 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Por rezulton , se SPAK-u dhe/ose Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmojnë origjinalitetin** e këtij e-mail ; Provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e këtyre Autoriteteve amerikane ; Bashkalidhur këtij e-mail (i administruar në fq. 299 e 305) është akti (nëpërmjet e-mail) po i dt. 03 / 9 / 2024 i Autoritetet Amerikane (drejtuar Ministrisë të Drejtësisë ; shih fq. 300 , 306 e 311 , po të këtij fashikulli nr. 99) ; Por provohet , se ky akt (nëpërmjet e-mail) i dt. 03 / 9 / 2024 (shih fq. 300 , 306 , 311 , po të këtij fashikulli nr. 99) **nuk ka vulën** e autoriteteve amerikane ; Bashkalidhur e-mail të dt. 03 / 9 / 2024 (administruar në fq. 300 , 306 e 311 , po të këtij fashikulli nr. 99) është përgjigja eventuale manuale , me shkrim e dt. 30 / 8 / 2024 e shoqërisë private tregtare amerikane " McKeon Grup " (shih fq. 302 , 308 e 313 , po të këtij fashikulli nr. 99 dhe ka lidhje me episodin hetimor të lobimeve) ; Referuar aktit (nëpërmjet e-mail) të dt. 03 / 9 / 2024 (administruar në fq. 300 , 306 e 311 ; shih dhe përkthimin e saj /faqe e parë e këtij e-mail , i administruar në fq. 316 të këtij

fashikulli) provohet , se kjo përgjigje (e shoqërisë private tregtare amerikane " McKeon Grup ") është dërguar , prej Autoriteteve Amerikane , në formë elektronike (pra , kjo përgjigje e kësaj shoqerie është printuar elektronikisht , nga CD , prej autoriteteve shqiptare) ; Provohet , se **printimi** i këtij materiali , në gjuhën angleze (pra , përgjigja e shoqërisë private tregtare amerikane " McKeon Grup ") , **nuk është nënshkruar** nga nëpunësi përgjegjës / oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar , nga formati i tyre fillestar elektronik / CD) dhe **nuk kanë datën** e printimit tyre (të cilat , në vijim , i janë vënë në dispozicion përkthyesit , për përkthim ; kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Pra , pretendoj **se nuk provohet** vërtetësia dhe autenticiteti e këtyre akteve të gjuhës angleze (lidhur me përgjigjen e shoqërisë private tregtare amerikane " McKeon Grup ", objekt eventual përkthimi) ; Provohet , se e-mail dt. 03 / 9 / 2024 , akti (nëpërmjet e-mail) dt. 03 / 9 / 2024 dhe akti / përgjigja dt. 30 / 8 / 2024 e shoqërisë " McKeon Grup " , janë përkthyer , në gjuhën shqipe (shih fq. 315 , 316 , 318 , 319 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Por në këto akte të përkthyera , **nuk identifikohet përkthyesi** dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Provohet , se fq. 300 , 306 e 311 të këtij fashikulli hetimor (ku administrohet i njëjti akt nëpërmjet e-mail dt. 03 / 9 / 2024 i Autoriteteve Amerikane) , **nuk është përkthyer plotësisht** (është përkthyer vetëm faqja e parë e këtij e-mail ; shih fq. 316 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit ; duket qartë , se **mungon** fq. 317 e këtij fashikulli) ;

79/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe (shih fq. 315 , 316 , 318 , 319 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

79/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara (e-mail dhe akti nëpërmjet e-mail) ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe me çështjen objekt gjykimi **:**

- **kërkoj të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 03 / 9 / 2024 (referuar fq. 299 e 305 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **kërkoj të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti (nëpërmjet e-mail) dt. 03 / 9 / 2024 (referuar fq. 300 , 306 e 311 , po të këtij fashikulli nr. 99) dhe akteve tij bashkalidhur , në formë elektronike ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026 ;

80). Provohet , se SPAK-u ka kërkuar ndihmë juridike , sipas aktit të saj L 546 dt. 18 / 11 / 2024 (nëpërmjet Ministrisë të Drejtësisë) drejtuar Autoriteteve Amerikane (shih fq. 320 e 331 po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Provohet , se Autoritetet Amerikane kanë kthyer përgjigje , me e - mail eventual të dt. 27 / 11 / 2024 (shih fq. 344 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Por provohet , se SPAK-u dhe /ose Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmojnë origjinalitetin** e këtij akti / e-mail ; Provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteve amerikane dhe **nuk është përkthyer** në gjuhën shqipe ; Provohet se akti / e-mail eventual dt. 26 / 11 / 2024 i Ministrisë tonë të Drejtësisë (drejtuar Autoriteteve amerikane , shih po në fq. 344 të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) , **nuk ka nënshkrimin** , **nuk ka vulën** e Ministrisë dhe nuk përmban **përkthimin e saj** (në gjuhën shqipe) ;

80/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se këto dy akte / dy e-mail (shih fq. 344 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte

, nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

80/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara e-mail ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe me çështjen objekt gjykimi , **kërkoj :**

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 27 / 11 / 2024 me nënshkrim e vulë (referuar fq. 344 të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **ti merret Ministrisë të Drejtësisë** akti manual **/** e-mail i dt. 26 / 11 / 2024 , ora 5:53 AM (dhe aktet e saj bashkalidhur) drejtuar Autoriteteve Amerikane (referuar po fq. 334 të këtij fashikulli) ;

81). Provohet , se Ministria e Drejtësisë i kthen përgjigje SPAK-ut , duke i përcjellur aktin / e-mail dt. 15 / 11 / 2024 , ora 10:30 PM (i dërguar ky e-mail eventualisht , prej Autoriteteve Amerikane ; shih fq. 356 e 357 të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Por provohet , se Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtij e-mail ; Provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteve amerikane ; Provohet , se përkthimi (në gjuhën shqipe) i këtij akti/ e-mail i sipërcituar (referuar fq. 361, po të këtij fashikulli) **nuk identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij/saj) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Gjithashtu ky e-mail **nuk është përkthyer plotësisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili nëpunës e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail) ;. Provohet , se bashkalidhur këtij akti / e-mail dt. 15 / 11 / 2024 (shih fq. 357 të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) , është akti tjetër (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 11 / 2024 (shih fq. 358 , po të këtij fashikulli) ; Por provohet gjithshtu , se Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtij e-mail ; Provohet , se ky akt (nëpërmjet e-mail) **nuk ka vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se përkthimi në gjuhën

shqipe i këtij akti/ e-mail i sipërcituar (referuar fq. 358 e 362 , po të këtij fashikulli) **nuk e identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; Megjithëse akti (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 11 / 2024 (shih fq. 358 e 362 , po të këtij fashikulli) thekson , ndër të tjera , se "*...dokumenti ju është përcjellur autoriteteve shqipëtare , në format elektronik ...*" provohet , se për **printimin e** këtij dokumentacioni bashkalidhur (shih fq. 360 , po të këtij fashikulli) , **nuk konfirmohet origjinaliteti i saj** (nga Ministria e Drejtësisë); Gjithashtu provohet , se ky akt bankar (shih fq. 360 , po të këtij fashikulli) **nuk ka nënshkrim dhe as vulë ,** nga autoriteti përkatës bankar i huaj ; Provohet , se ky akt bankar i printuar , **nuk është nënshkruar** , as nga nëpunësi përgjegjës / oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës , në Shqipëri (i cili i ka printuar , nga formati i tyre fillestar elektronik) dhe **nuk kanë datën e printimit tyre** (të cilat , në vijim , i janë vënë në dispozicion përkthyeses ; kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) ; **Nuk provohet** vërtetësia dhe autenticiteti e këtij akti , në gjuhën angleze , objekt eventual përkthimi (shih aktin në fq. 360 të këtij fashikulli) ; Pra , **nuk provohet** qartësisht / me siguri procedurale , nëse akti i kësaj faqeje 360 , është në të vërtetë / pikërisht akti i dërguar , në formë elektronike , nga autoritetet e SH.B.A -s (shih fq. 358 , po të këtij fashikulli) ; Provohet , se edhe përkthimi në gjuhën shqipe i këtij akti të sipërcituar (referuar fq. 360 e 364 , po të këtij fashikulli) **nuk e identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri , në bazë të elementeve , që përmbahen në vetë aktin ose në aktet , që lidhen me të) ; Provohet gjithashtu , se përkthimi në gjuhën shqipe i këtij akti të sipërcituar (referuar fq. 360 e 364 , po të këtij fashikulli) **ka pasaktësi thelbësore** , në përkthimin e veprimeve / transaksionet vijuese bankare , sepse :

- veprimi bankar nr. 32A dt. 17 / 3 / 2017 , pasqyrohet në aktin e dërguar nga autoritetet amerikane (referuar fq. 360 , po të këtij fashikulli) , si vijon " *...15000 USD ...*" ; ndërsa përkthyesi (referuar fq. 364 , po të këtij fashikulli) e përkthen në gjuhën shqipe , si vijon " ... *15,000 USD ...*" ;

- veprimi bankar nr. 33B , pasqyrohet në aktin e dërguar nga autoritetet amerikane (referuar fq. 360 , po të këtij fashikulli) , si vijon " ....*15000 USD*..." ; ndërsa përkthyesi (referuar fq. 364 , po të këtij fashikulli) e përkthen në gjuhën shqipe , si vijon " ... *15,000 USD* ..." ;

81/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se këto dy akte (e-mail dhe akti nëpërmjet e-mail) dhe akti tyre bashkalidhur (shih fq. 357, 358 e 360 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) dhe aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe (shih fq. 361 , 362 e 364 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

81/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara (e-mail dhe akti nëpërmjet e-mail) ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe me çështjen objekt gjykimi , **kërkoj** :

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 15 / 11 / 2024 me <u>nënshkrim e vulë</u> (referuar fq. 357 të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane <u>akti (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 11 / 2024</u> (me <u>vulën</u> e autoriteteve amrikane , referuar fq. 358 të këtij fashikulli të Prokurorit) dhe <u>akti saj bashkalidhur</u> (me <u>nënshkrim e vulë</u> të autoriteteve përkatëse bankare , referuar fq. 360 të këtij fashikulli) ; Kjo letërporosi (për këto dy akte) t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 27 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 29 / 10 / 2026 ;

82). Lidhur me e -mail dt. 15 / 11 / 2024 (dërguar eventualisht SPAK-ut , prej Autoriteteve Amerikane ; shih fq. 366 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) provohet , se SPAK- u , **nuk konfirmon origjinalitetin / autenticitetin** e këtij e-mail ; Provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se përkthimi në gjuhën shqipe i këtij akti/ e-mail i sipërcituar (referuar fq. 366 , 361 , po të këtij fashikulli) **nuk identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij/saj) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Gjithashtu ky akt / e-mail **nuk është përkthyer plotësisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili nëpunës e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail) ; Provohet , se bashkalidhur këtij akti / e-mail dt. 15 / 11 / 2024 (shih fq. 366 të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) , është akti tjetër (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 11 / 2024 (shih fq. 367 , po të këtij fashikulli) ; Por provohet gjithshtu , se SPAK / Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon origjinalitetin** e këtij akti (nëpërmjet e-mail) ; Provohet , se ky akt **nuk ka as vulën** e autoriteteve amerikane; Provohet , se përkthimi në gjuhën shqipe i këtij akti/ e-mail i sipërcituar (referuar fq. 362 , po të këtij fashikulli nr. 99) nuk e identifikon **përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij /saj) dhe nuk përcaktohet **data e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Megjithëse akti (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 11 / 2024 (shih fq. 367 e 362 , po të këtij fashikulli) thekson , ndër të tjera , se "*.... dokumenti ju është përcjellur autoriteteve shqipëtare , në format elektronik ...* " provohet , se për **printimin e** këtij dokumentacioni bashkalidhur (shih fq. 369 , po të këtij fashikulli) , nuk konfirmohet **origjinaliteti / autenticiteti i saj** (nga SPAK / Ministria e Drejtësisë) ; Gjithashtu provohet , se ky akt bankar (shih fq. 369 , po të këtij fashikulli) **nuk ka nënshkrim dhe as vulë ,** nga autoriteti përkatës bankar ;). Provohet , se ky akt bankar i printuar , **nuk është nënshkruar** , as nga nëpunësi përgjegjës / oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës , në Shqipëri (i cili e ka printuar nga formati i tyre fillestar elektronik) dhe **nuk ka datën e printimit tyre** (të cilat , në vijim , i janë vënë në dispozicion përkthyesit ; Kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; **Nuk provohet** vërtetësia dhe autenticiteti

e këtij akti , në gjuhën angleze , objekt eventual përkthimi (shih aktin në fq. 364 të këtij fashikulli ; pra , **nuk provohet** qartësisht , mjaftueshëm dhe me siguri procedurale , nëse akti i kësaj faqeje 369 , është në të vërtetë / pikërisht akti i dërguar , në formë elektronike , nga autoritetet e SH.B.A -s ; shih dhe fq. 367 , po të këtij fashikulli) ; Provohet , se edhe përkthimi në gjuhën shqipe i këtij akti të sipërcituar (referuar fq. 369 e 364 , po të këtij fashikulli) **nuk e identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij/saj) dhe nuk përcaktohet **data e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Provohet gjithashtu , se përkthimi në gjuhën shqipe i këtij akti të sipërcituar (referuar fq. 369 e 364 , po të këtij fashikulli) **ka pasaktësi thelbësore** , në përkthimin e veprimeve / transaksionet vijuese bankare , sepse :

- veprimi bankar nr. 32A dt. 17 / 3 / 2017 , pasqyrohet në aktin e dërguar nga autoritetet amerikane (referuar fq. 369, po të këtij fashikulli) , si vijon " ... *15000 USD* ..." ; ndërsa përkthyesi (referuar fq. 364 , po të këtij fashikulli) e përkthen në gjuhën shqipe , si vijon " ... *15,000 USD* ..." ;

- veprimi bankar nr. 33B , pasqyrohet në aktin e dërguar nga autoritetet amerikane (referuar fq. 369 , po të këtij fashikulli) , si vijon " .... *15000 USD* ..." ; ndërsa përkthyesi (referuar fq. 364 , po të këtij fashikulli) e përkthen në gjuhën shqipe , si vijon " ... *15,000 USD* ..." ;

82/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se këto dy akte (e-mail dhe akti nëpërmjet e-mail) dhe akti tyre bashkalidhur (shih fq. 366 , 367 e 369 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) dhe aktet e përkthyera , në gjuhën shqipe (shih fq. 361 , 362 e 364 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

82/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara (e-mail dhe akti nëpërmjet e-mail) ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe me çështjen objekt gjykimi , **kërkoj :**

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 15 / 11 / 2024 , me nënshkrim e vulë (referuar fq. 366 të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti (nëpërmjet e-mail) dt. 15 / 11 / 2024 (me vulën e autoriteteve të drejtësisë , referuar fq. 367 të këtij fashikulli të Prokurorit) dhe akti bashkalidhur saj (me nënshkrim e vulë të autoriteteve përkatëse bankare , referuar fq. 369 të këtij fashikulli) ; Kjo letërporosi (për këto dy akte) t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 03 / 11 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 05 / 11 / 2026 ;

83). Provohet , se Autoritetet Amerikane kanë kthyer përgjigje , me e - mail eventual të dt. 27 / 11 / 2024 (shih fq. 344 e 371 , po të këtij fashikulli nr. 99 të Prokurorit) ; Por rezulton , se SPAK-u dhe /ose Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmojnë origjinalitetin / autenticitetin** e këtij akti / e-mail ; Provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se përkthimi në gjuhën shqipe i këtij akti / e-mail i sipërcituar (referuar fq. 344 , 371 e 374 , po të këtij fashikulli nr. 99) **nuk e identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij/saj) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Gjithashtu ky akt / e-mail **nuk është përkthyer plotësisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili nëpunës e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail) ;

83/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se këto dy akte / dy e-mail (shih fq. 344 e 371 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje

, për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

83/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara e-mail) ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe me çështjen objekt gjykimi , **kërkoj** :

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 27 / 11 / 2024 , me nënshkrim e vulë (referuar fq. 344 e 371 të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **ti merret nga gjykata , Ministrisë të Drejtësisë** akti manual / e-mail dt. 26 / 11 / 2024 , ora 5:53 AM , me nënshkrim e vulë (dhe aktet e saj bashkalidhur) drejtuar Autoriteteve Amerikane (referuar po fq. 334 , 371 të këtij fashikulli) ;

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 03 / 11 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 05 / 11 / 2026 ;

84). Rezulton , se Ministria e Drejtësisë i përcjell / dërgon SPAK-ut , kërkesën e autoriteteve Amerikane , për informacione shtesë (shih fq. 375 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) ; Duke iu referuar e-mail dt. 26 / 02 / 2025 të autoriteteve Amerikane (drejtuar eventualisht Ministrisë të Drejtësisë ; shih po aty fq. 375 e 376) provohet , se Ministria e Drejtësisë , konfirmon se " *....ka mbërritur e-mail dt. 26 / 02 / 2025 , prej autoriteteve Drejtësisë Amerikane* ..." ; Kjo Ministri , nuk konfirmon **origjinalitetin / autenticitetin** e këtij akti / e-mail ; Provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se përkthimi në gjuhën shqipe , i këtij akti / e-mail dt. 26 / 02 / 2025 (referuar po aty , fq. 380) **nuk e identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij/saj) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Gjithashtu ky akt / e-mail **nuk është përkthyer plotësisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili nëpunës e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail) ; Duke

iu referuar e-mail dt. 27 / 11 / 2024 të autoriteteve Amerikane (drejtuar eventualisht Ministrisë të Drejtësisë ; shih po aty fq. 375 e 377) provohet , se Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon** (shih fq.375) , se ky e-mail ishte bashkalidhur praktikës të saj ; Kjo Ministri , nuk konfirmon **origjinalitetin / autenticitetin** e këtij akti / e-mail ; Provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteteve amerikane ; Gjithashtu (referuar akteve , në këtë fashikull) provohet , se ky e-mail , **nuk është përkthyer** , në gjuhën shqipe ; Duke iu referuar e-mail dt. 26 / 11 / 2024 të Ministrisë të Drejtësisë (drejtuar eventualisht autoriteteve Amerikane , në gjuhën angleze ; shih po aty, fq. 378) provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e Ministrisë të Drejtësisë ; Gjithashtu (referuar akteve , në këtë fashikull) provohet , se ky e-mail , **nuk është përkthyer** , në gjuhën shqipe ; Duke iu referuar e-mail dt. 15 / 11 / 2024 të autoriteteve Amerikane (drejtuar eventualisht SPAK-ut ; shih po aty , fq. 375 e 378) provohet , se Ministria e Drejtësisë **nuk konfirmon** (shih fq. 375) , se ky e-mail ishte bashkalidhur praktikës të akteve të saj ; Kjo Ministri / SPAK-u , nuk konfirmon **origjinalitetin / autenticitetin** e këtij akti / e-mail ; Provohet , se ky e-mail **nuk ka as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteteve amerikane ; Gjithashtu (referuar akteve , në këtë fashikull) provohet , se ky e - mail , **nuk është përkthyer** , në gjuhën shqipe ;

84/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se këto 4 akte / e-mail (shih fq. 376 , 377 e 378 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

84/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara e-mail) ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me pafajësinë time dhe me çështjen objekt gjykimi , **kërkoj** :

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. 26 / 02 / 2025 , me nënshkrim e vulë (referuar , fq. 376 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail dt. dt. 27 / 11 / 2024 , me nënshkrim e vulë (referuar , fq. 377 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane , akti manual / e-mail dt. dt. 15 / 11 / 2024 , me nënshkrim e vulë (referuar , fq. 378 , po të këtij fashikulli të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **ti merret Ministrisë të Drejtësisë** akti manual / e-mail dt. 26 / 11 / 2024 , ora 5:53 AM , me nënshkrim e vulë (dhe aktet e saj bashkalidhur) drejtuar Autoriteteve Amerikane (referuar , po fq. 378 të këtij fashikulli);

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 03 / 11 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 05 / 11 / 2026 ;

85). Provohet , se Prokurori **ka patur objekt përkthimi** (shih fq. 383 , 385 - 389 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) aktet në gjuhën shqipe , për tu përkthyer ato , në gjuhën angleze dhe (në vitin 2025) ka caktuar përkthyese / person fizik privat ; Referuar këtyre akteve , nuk provohet **data e përkthimit** , në gjuhën angleze të këtyre akteve (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Provohet , se përkthyesja **nuk ka vulën** e saj (shih fq. 383 , 389 , 390 , 397 , 406 , 409 , 412 , po të këtij fashikulli) dhe **nuk provohet** , që ajo të ketë paraqitur / përshkruar **deklaratën e saj** të domosdoshme ; shih fq. 395 - 397 , 404 – 412 , po të këtij fashikulli).

85/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën angleze (shih fq. 395 - 397 , 404 - 412 , po të këtij fashikulli nr. 99) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare

) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi / mbështetja , në këto akte (dhe aktet e mbërritura eventualisht , nga autoritetet te drejtësisë amerikane dhe/ose britanike ; shih fq. 384 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 03 / 11 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 05 / 11 / 2026) ;

86). Rezulton , se Prokurori njofton Ministrinë e Drejtësisë (shih fq. 413 , po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) , për faktin se ishte ekzekutuar (nga Autoritetet Amerikane) letërporosia shqiptare , në formë elektronike / me 9 e-mail të të njëjtës datë 21 / 3 / 2025 dhe me 1 akt nga e-mail i dt. 21 / 3 / 2025 ; Provohet , se këto 9 e-mail administrohen në fq. 458 , 459 , 460 e 461 (po të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) dhe 1 akt /nga e-mail administrohet në fq. 462 , po të këtij fashikulli ; Provohet , se Prokurori / Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon** (shih po aty , fq. 413) , **origjinalitetin / autenticitetin** e këtyre akteve / 9 e-mail dhe të 1 akti nga e-mail (shih fq. 458 , 459 , 460 , 461 e 462 të fashikullit nr. 99) ; Provohet , se këto akte / 9 e-mail dt. 21 / 3 / 2025 (shih fq. 458 , 459 , 460 e 461 të fashikullit nr. 99) **nuk kanë , as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se akti nga e- mail dt. 21 / 3 / 2025 (shih fq. 462 , të fashikullit nr. 99 ; shih fq. 12 të fashikullit hetimor nr. 100 ; shih fq. 1 të fashikullit hetimor nr. 101) **nuk ka vulën** e autoriteteve amerikane ; Referuar fq. 462 të fashikullit nr. 99 dhe referuar fq. 12 , 143 e 144 të fashikullit hetimor nr. 100 të Prokurorit provohet qartë , se aktit nga e-mail i dt. 21 / 3 / 2025 pretendohet , që **i bashkalidhen** , në formë elektronike , ndër të tjera , përkatësisht 1 PDF/me 139 faqe , 1 PDF /me 599 faqe dhe 1 PDF/ me 288 faqe ; Provohet , se Prokurori / Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon** (shih fq. 413 të fashikullit hetimor nr. 99) , **origjinalitetin / autenticitetin** e këtyre akteve të printuara / shkarkuara /ekstraktuara nga akti prej e-mail dt. 21 / 3 / 2025 (shih aktet e fq. 13 -142 , po të fashikullit hetimor nr. 100 ; shih aktet e fq. 2- 419/fashikulli hetimor nr. 101 ; shih aktet në fq. 1- 292 /fashikulli hetimor nr. 102 ; shih aktet në fq. 1- 277 / fashikulli hetimor nr. 103) ; Provohet , se aktet e printuara nga e-mail i dt. 21 / 3 / 2025 (shih fq. 462 të fashikullit nr. 99 ; shih aktet e fq. 12 , 13 - 142 të fashikullit nr. 100) , **nuk kanë , as nënshkrimin dhe as vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se aktet e printuara / të marra (shih fq. 12 , 13 - 142 të fashikullit nr. 100) , **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri

i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar / shkarkuar / ekstraktuar) dhe **nuk kanë datën** e printimit / ekstraktimit tyre (kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten / printuar dhe administruar këto akte / dokumenta (dhe që janë dërguar eventualisht nga Autoritetet Amerikane) **vihet mjaftueshëm , në dyshim** (sepse nuk ka mjaftueshëm siguri procedurale , dhe autenticitet) , nëse këto akte , janë pikërisht dokumentet , që gjënden / përmban realisht (në formë elektronike , në seicilën prej 3 " PDF " përkatëse të sipërcituara) , në aktin nga e-mail dt. 21 / 3 / 2025 ? dhe vihet në dyshim gjithashtu subjekti procedural , që i ka printuar ato ; Provohet , se **nga tërësia e akteve** , që përmban , ndër të tjera , 1 PDF /me 139 faqe , 1 PDF / me 599 faqe dhe 1 PDF/ me 288 faqe , bashkalidhur aktit nga e-mail dt. 21 / 3 / 2025 (shih fq. 462 të fashikullit nr. 99 ; shih fq. 12 , 143 , 144 të fashikullit nr. 100 të Prokurorit) provohet qartë , se prokurori ka caktuar përkthyese / person fizik privat tregtar (shih fq.3 të fashikullit nr.100) , për përkthimin (e akteve të gjuhës angleze) , në gjuhën shqipe vetëm të 129 fletëve të printuara ; shih aktet objekt përkthimi , në fq. 3 , 9 , 13 - 142 të fashikullit hetimor nr. 100) ; Provohet , se përkthimi , në gjuhën shqipe administrohet në fq. 143 - 383 të fashikullit nr. 100) ; Por provohet , se për aktet e përkthyera vijuese (shih fq. 143 - 383 të fashikullit nr. 100) :përkthimi i përkthyeses , **nuk ka datën e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale) , përkthyesja **nuk ka vulën e saj** , në këto akte (shih fq. 8 -10 , 143 - 383 të fashikullit nr. 100) dhe përkthyesja nuk ka paraqitur / përshkruar **deklaratën e saj** të domosdoshme) . Pretendohet , se nga akti / prej e- mail të dt. 21 / 3 / 2025 (shih fq. 462 , të fashikullit nr. 99 ; shih fq. 12 të fashikullit nr. 100 ; shih fq. 1 të fashikullit nr. 101 ; shih 1 PDF /me 139 faqe ; shih 1 PDF/ me 599 faqe ; shih 1 PDF / me 288 faqe) , janë **printuar** / ekstraktuar aktet e gjuhës angleze dhe **administrohen** në fashikujt hetimor vijues : në fq.13 - 142 (të fashikullit hetimor nr. 100) ; në fq. 2 - 419 (të fashikullit hetimor nr. 101) ; në fq. 1- 292 (të fashikullit hetimor nr. 102) ; në fq. 1- 277 (të fashikullit hetimor nr. 103) ; Por për aktet e printuara / ekstraktuara të gjuhës angleze dhe që administrohen / bashkalidhen në fq. 2- 419 /fashikulli hetimor nr. 101 , në fq. 1- 292 / fashikulli hetimor nr. 102 dhe në fq. 1- 277 / fashikulli hetimor nr. 103) **rezultojnë qartë** të metat procedurale vijuese : se Prokurori / Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon** (shih fq. 413 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) , **origjinalitetin / autenticitetin** e këtyre akteve (të administruar / bashkalidhur në fq. 2- 419 / fashikulli hetimor nr. 101 , në fq. 1-

292 / fashikulli hetimor nr. 102 dhe në fq. 1- 277 / fashikulli hetimor nr. 103) ; Se këto akte (të administruar / bashkalidhur në fq. 2- 419 /fashikulli hetimor nr. 101 , në fq. 1- 292 / fashikulli hetimor nr. 102 dhe në fq. 1- 277 / fashikulli hetimor nr. 103) , **nuk përmbajnë , as nënshkrimin dhe as vulën** e autoriteteve amerikane përkatëse publike / private ; se këto akte të printuara (të marra dhe të administruar / bashkalidhur në fq. 2 - 419 / fashikulli hetimor nr. 101 , në fq. 1- 292 / fashikulli hetimor nr. 102 dhe në fq. 1- 277 / fashikulli hetimor nr. 103) , **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar) dhe **nuk kanë datën** e printimit tyre (kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Pra , në këtë gjëndje , që paraqiten / printuar dhe administruar këto akte **vihet mjaftueshëm , në dyshim** (sepse nuk ka mjaftueshëm siguri procedurale dhe autenticitet) , nëse këto akte , janë pikërisht dokumentet , që gjënden / përmbajnë realisht (në formë elektronike përkatëse 1 PDF / me 139 faqe ; 1 PDF/ me 599 faqe dhe 1 PDF / me 288 faqe) , në aktin nga e-mail dt. 21 / 3 / 2025 ? dhe vihet në dyshim gjithashtu subjekti procedural , që i ka printuar ato ;Siç rezulton , në aktet e këtyre fashikujve hetimor dhe që parashtrova / pretendova më lart (sipas të cilave , objekt përkthimi , nga këto 3 PDF , prej prokurorit , janë vetëm fq. 13 - 142 të printuara / administruara në fashikullin hetimor nr. 100) **pretendoj gjithashtu , se** Prokurori **nuk argumenton** (referuar gjëndjes të fashikujve hetimor të sipërcituar me numra 99 , 100 , 101 , 102 e 103) , se për të cilat shkaqe / arsye , rrethana / fakte , **nuk janë përkthyer të gjithë aktet** , pjesë përbërëse eventuale të 1 PDF/me 139 faqe , 1 PDF/me 599 faqe dhe 1 PDF/ me 288 faqe (referuar aktit nga e- mail dt. 21 / 3 / 2025 ; shih fq. 462 , të fashikullit hetimor nr. 99 ; shih fq. 12 të fashikullit hetimor nr. 100 ; shih fq. 1 të fashikullit hetimor nr. 101 ; shih aktet që administrohen në fq. 2 - 419 /fashikulli hetimor nr. 101 , në fq. 1- 292 /fashikulli hetimor nr. 102 dhe në fq. 1 - 277 / fashikulli hetimor nr. 103) ; **Pretendoj gjithashtu** , se **mospërkthimi i akteve të tjera** (pjesë përbërëse eventuale të 1 PDF /me 139 faqe , 1 PDF /me 599 faqe dhe 1 PDF / me 288 faqe) **është e qëllimshme** , përbën mjaftueshëm **parregullsi të rëndë procedurale** ; Pretendoj , se është cënuar mjaftueshëm e drejta ime e njohjes / aksesit tim me këto akte (që nuk janë përkthyer) , është cënuar e drejta ime e mbrojtjes efektive dhe është cënuar parimi i kondradiktoritetit ; Referuar aktit (nëpërmjet e-mail) dt. 21 / 3 / 2025 të Autoriteteve Amerikane , me referencë shqiptare të letërporosisë nr. 1458/1 , L 201 Prot . dhe referencë amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linja / rreshti 3 (shih fq. 462 të fashikullit hetimor nr. 99 të Prokurorit

; shih përkthimin e saj në fq. 143 të fashikullit hetimor nr. 100 të Prokurorit) , sipas kërkesës përkatëse dhe sipas vendimit gjyqësor dt. 30 / 11 / 2024 të gjykatës përkatëse në SH.B.A parashikohej , që ekzekutimi i kërkesës të palës shqiptare të trajtohej , si " ... *konfidenciale dhe e padisponueshme , vetëm për publikun ..."* , me afat 2 vjet , nga dita e këtij vendimi gjyqësor ; Por më dt. 21 / 3 / 2025 e vijim (që ka ardhur ky e-mail , në SPAK / Ministrisë të Drejtësisë) , unë / i pandehuri nuk isha " publik " (por isha i paraburgosur / palë drejtëpërdrejtë e interesuar) . Prokurori nuk ka pretenduar , se aktet përkatëse objekt letërporosie , janë akte sekrete , si dhe nuk ka pretenduar , në asnjë lloj fazë e deri tani , ekzistencën e ndalimeve përkatëse konkrete , sipas nenit 511 të K. Pr. Penale. **Provohet deri tani** , se Prokurori (prej dt. 21 / 3 / 2025) , nuk i ka dërguar **qëllimisht** , Departamentit të Drejtësisë të SHBA , informacione / sqarime / argumenta shtesë , në lidhje me pozitën time procedurale penale , në këtë procedim penal , nga dt. 21 / 10 / 2024 (që unë u arrestova) e në vijim , prej dt. 21 / 3 / 2025 e vijim ; Prokurori nuk i ka kërkuar sqarime dhe nuk e ka /informuar Departamentit të Drejtësisë të SHBA , nëse shprehja " ...publiku ... " , (në këtë e-mail të dt. 21 / 3 / 2025) , a e përfshinte , edhe pozitën time procedurale penale (si person nën hetim dhe i paraburgosur , në këtë dosje penale) , për t'u kufizuar unë , me njohjen e akteve përkatëse ? (shih nenin 511 të K. Pr. Penale) ; Mosveprimi dhe moskryerja e këtyre veprimeve , nga Prokurori , **është në kundërshtim** me nenet 1 e vijues , 8/a e vijues , 509 e vijues të këtij kodi ; Në mungesë të këtij / këtyre informacioni / faktesh / të dhënash /aktesh / provash , nga Departamenti i Drejtësisë të SH.B.A pretendoj , se mungonte / **mungon një bazë e plotë faktike** , për aplikimin ndaj meje , pas dt. 21 / 10 / 2024 e vijim , të masës të sigurimit personal , me paraburgim . Mosveprimi dhe moskryerja e këtyre veprimeve , nga Prokurori , prej dt. 21 / 3 / 2025 (dita , që Autoritetet Amerikane , kanë njoftuar këtë e-mail) provojnë , se **është kufizuar mjaftueshëm** e <u>drejta ime (si palë direkte e interesuar)</u> , për tu njohur , me aktet / të dhënat / informacionin objekt i letërporosisë (administruar ato akte , aktualisht , në SH.B.A) ; <u>është cënuar</u> mjaftueshëm <u>e drejta ime e mbrojtjes efektive</u> /efikase / praktike , gjatë hetimit penal , në seancë paraprake gjyqësore dhe deri në këtë fazë gjykimi ; <u>është cënuar</u> mjaftueshëm <u>parimi i kondradiktoritetit (</u> lidhur me njohjen time mjaftueshëm , me të gjitha provat / aktet e çështjes , gjatë hetimit penal) ; nuk janë sqaruar mjaftueshëm disa rrethana / fakte të hetimit dhe është <u>cënuar mjaftueshëm liria ime personale</u> .

86/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 13 - 142 të fashikullit nr. 100 të Prokurorit) **dhe** aktet e gjuhës angleze **,** që nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe (të cilat administrohen në fq. 2- 419 /fashikulli hetimor nr. 101 , në fq. 1- 292 /fashikulli hetimor nr. 102 , në fq. 1- 277 / fashikulli hetimor nr. 103 ose janë pjesë e akteve të 1 PDF /me 139 faqe , akteve të 1 PDF / me 599 faqe dhe akteve të 1 PDF/ me 288 faqe) , **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

86/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara e-mail ; Meqenëse nuk janë përkthyer të gjithë aktet e gjuhës angleze ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me çështjen objekt gjykimi dhe me pafajësinë time , **kërkoj** :

- **përkthimin** (nga gjuha angleze) , në gjuhën shqipe (sipas neneve 123 - 126 , 196 të K. Pr. Penale , referuar ligjit relevant nr. 82/2021 dhe akteve të tij nënligjore) **të të gjithë dokumentacionit** , që përmbajnë 1 PDF / me 139 faqe , 1 PDF / me 599 faqe dhe 1 PDF/me 288 faqe (ose të të gjithë akteve , që administrohen në fq. 2- 419 /fashikulli hetimor nr. 101 , në fq. 1- 292 /fashikulli hetimor nr. 102 dhe në fq. 1- 277 / fashikulli hetimor nr. 103) ;

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane aktet manuale / 9 e-mail të së njëjtës datë 21 / 3 / 2025 , me nënshkrime e vula (referuar fq. 458 - 461 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual nga e-mail dt. 21 / 3 / 2025 , me vulë (referuar fq. 462 të fashikullit nr. 99 të Prokurorit) dhe të merret dokumentacioni saj eventual përbërës bashkalidhur / formë elektronike 1 PDF / me 139 faqe , 1 PDF / me 599 faqe dhe 1 PDF / me 288 faqe dhe të merren ato me nënshkrime e vula (referuar fq. 13 - 142 / fashikulli hetimor nr. 100 ; referuar fq. 2- 419 /fashikulli hetimor nr. 101 ; referuar fq. 1- 292 /fashikulli hetimor nr.

102 dhe referuar fq. 1- 277 / fashikulli hetimor nr. 103 të Prokurorit) ; Kjo letërporosi për këto akte t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane aktet vijuese : kërkesa përkatëse , me objekt " trajtimi me konfidencialitet " (drejtuar , nga çdo palë e interesuar , Gjykatës përkatëse , në SH.B.A dhe në të cilën , bazohet mjaftueshëm vendimi gjyqësor i dt. 30 / 11 / 2024 i asaj gjykate , në SH.B.A ; shih fq. 462 të fashikullit hetimor nr. 99 të Prokurorit ; shih fq. 143 të fashikullit hetimor nr. 100 të Prokurorit) **dhe** vendimi gjyqësor dt. 30 / 11 / 2024 të asaj gjykate në SH.B.A ; Pra , unë pretendoj , që këto akte **kanë lidhje** me rrethanat e çështjes dhe **me pafajësinë time** ; Për rrjedhojë **i kërkoj** , që tani këto akte , të cilat (pasi konsiderohet i plotësuar më dt. 01 / 12 / 2026 , afati i sipërcituar 2 vjecar i kufizimit konfidencial) **të merren** me letërporosi , në SH.B.A , aktet objekt letërporosie të prokurorit dhe aktet objekt i kufizimit konfidencial (sipas vendimit gjyqësor dt. 30 / 11 / 2024 i asaj gjykate , në SH.B.A) ; Kjo letërporosi të niset direkt , nga Gjykata , prej dt. 01 / 12 / 2026 , në SH.B.A dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 03 / 11 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 05 / 11 / 2026 ;

87). Rezulton , se Ministria e Drejtësisë njofton SPAK- un / Prokurorin (shih fq. 10 të fashikullit hetimor nr. 132 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore penale të themelit , objekt gjykimi) , për faktin se ishte ekzekutuar (nga Autoritetet Amerikane) letërporosia shqiptare , e përbërë : nga akti eventual manual / fizik dt. 01 / 10 / 2025 i Autoriteteve Amerikane , në gjuhën angleze (shih fq. 11 , 16 të fashikullit hetimor nr. 132) **dhe** e-mail eventual i dt. 01 / 10 / 2025 i Autoriteteve Amerikane , në gjuhën angleze (shih fq. 15 , po në këtë fashikull hetimor nr. 132) ; Provohet , se Ministria e Drejtësisë , **nuk konfirmon origjinalitetin / autenticitetin** e këtyre dy akteve të të njëjtës datë 01 / 10 / 2025 (shih fq. 10 , 11 , 15 , 16 të fashikullit hetimor nr. 132) ; Provohet , se akti manual i dt. 01 / 10 / 2025 (shih fq. 11 , 16 , të fashikullit hetimor nr. 132) **nuk ka vulën** e autoriteteve amerikane

; Provohet , se përkthimi (në gjuhën shqipe) i këtij akti manual (shih përkthimin në fq. 19 të fashikullit hetimor nr. 132) **nuk identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij/saj) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri , në bazë të elementeve , që përmbahen në vetë aktin / aktet , që lidhen me të) ; Referuar po aktit manual të dt. 01 / 10 / 2025 të Autoriteteve Amerikane (me referencë shqiptare të letërporosisë nr. 3596/Prot. dhe referencë amerikane nr. CRM -182 - 85321 , linja / rreshti 4 ; shih përkthimin në fq. 19 të fashikullit hetimor nr. 132 të Prokurorit) , sipas kërkesës përkatëse dhe sipas vendimit gjyqësor dt. 12 / 6 / 2025 të gjykatës përkatëse në SH.B.A parashikohej , që ekzekutimi i kërkesës të palës shqiptare të trajtohej " *... si konfidenciale dhe nuk i vihet në dispozicion publikut ...*" ; Por rezultoi qartë , se më dt. 01 / 10 / 2025 (që ka ardhur ky e-mail , në Ministrinë e Drejtësisë) , unë nuk isha " publik " (por isha i paraburgosur / palë drejtëpërdrejtë e interesuar / i pandehur) . Prokurori nuk ka pretenduar , në asnjë lloj fazë e deri tani , ekzistencën e ndalimeve konkrete , sipas nenit 511 të K. Pr. Penale ; Për më tepër rezultoi , se më dt. 01 / 10 / 2025 dosja ime hetimore , ishte në gjykim / për seancë paraprake . **Provohet** deri tani , se Prokurori (prej dt. 01 / 10 / 2025) , nuk e ka kërkuar vendimin gjyqësor dt. 12 / 6 / 2025 të gjykatës përkatëse në SH.B.A ; Mosveprimi dhe moskryerja e këtyre veprimeve , nga Prokurori / Ministria e Drejtësisë , **është në kundërshtim** me nenet 1 e vijues , 8/a e vijues , 509 e vijues të K. Pr. Penale . Mosveprimi dhe moskryerja e këtyre veprimeve , nga Prokurori , prej dt. 01 / 10 / 2025 (dita , që Autoritetet Amerikane , kanë njoftuar/ dërguar këtë akte manual) provojnë , se **është kufizuar mjaftueshëm** e drejta ime (si palë direkte e interesuar) , për tu njohur edhe me vendimin gjyqësor dt. 12 / 6 / 2025 të gjykatës përkatëse në SH.B.A ; është cënuar mjaftueshëm e drejta ime e mbrojtjes efektive / efikase / praktike , gjatë hetimit penal , në seancë paraprake gjyqësore dhe deri në këtë fazë gjykimi , në themel ; është cënuar mjaftueshëm parimi i kondradiktoritetit (lidhur me njohjen time mjaftueshëm , me të gjitha provat / aktet / rrethanat e çështjes , gjatë hetimit penal) ; Pra , nuk janë sqaruar mjaftueshëm disa rrethana / fakte të hetimit , e lidhur me ekzekutimin e letërporosisë . Provohet , se akti / e-mail i dt. 01 / 10 / 2025 (shih fq. 15 të fashikullit hetimor nr. 132) **nuk ka , as nënshkrimin** dhe **as vulën** e autoriteteve amerikane ; Provohet , se përkthimi në gjuhën shqipe i këtij akti/ e-mail (shih përkthimin në fq. 18 të fashikullit hetimor nr. 132) **nuk identifikon përkthyesin** (sepse ka vetëm nënshkrimin e tij/saj) dhe **nuk përcaktohet data e përkthimit** (kjo datë përkthimi

, nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Gjithashtu ky akt / e-mail **nuk është përkthyer plotësisht** (sepse nuk është përkthyer , në pjesën / fragmentet , se cili nëpunës e ka dërguar këtë e-mail dhe kujt i dërgohet ky e-mail) ; Provohet , se prokurori **i ka kërkuar** Ministrisë së Drejtësisë të kryejë përkthimin akteveeventuale të gjuhës angleze / bashkalidhur (në formatin elektronik PDF) , të aktit manual të dt. 01 / 10 / 2025 (shih fq. 11 , 16 , 21 , 22 , 23 , 33 - 163 , 165 , 166 të fashikullit hetimor nr. 132) ; Por provohet , se (lidhur me këto akte / format elektronik PDF , bashkalidhur /printuar eventualisht , prej aktit manual të dt. 01 / 10 / 2025 ; shih fq. 22 , 23 , 33 - 163 , 165 , 166 të fashikullit hetimor nr. 132) Prokurori / Ministria e Drejtësisë , **nuk e konfirmon** (shih fq. 10 të fashikullit hetimor nr. 132) , **origjinalitetin / autenticitetin** e tyre ; Provohet , se këto akte të printuara (shih 22 , 23 , 33 - 163 , 165 , 166 të fashikullit hetimor nr. 132) , **nuk kanë , as nënshkrimin dhe as vulën** e autoriteteve amerikane publike / private ; Provohet , se aktet e printuara (shih fq. 22 , 23 , 33 - 163 , 165 , 166 të fashikullit hetimor nr. 132) , **nuk janë të nënshkruara** nga oficeri i policisë gjyqësore / eksperti përkatës (që i ka printuar) dhe **nuk kanë datën** e printimit (kjo datë printimi , nuk mund të saktësohet mjaftueshëm , me siguri procedurale) ; Pra , në këtë gjëndje , që janë printuar / administruar këto akte (dhe që janë dërguar eventualisht nga Autoritetet Amerikane) **vihet mjaftueshëm , në dyshim** (sepse nuk ka mjaftueshëm siguri procedurale dhe autenticitet) , nëse këto akte , janë pikërisht dokumentet , që gjënden / përmban realisht (në formë elektronike , në seicilën prej " PDF "- ve përkatëse) , në aktin manual të dt. 01 / 10 / 2025 ? dhe vihet në dyshim gjithashtu subjekti procedural , që i ka printuar ato ;Provohet , se përkthimi i këtyre akteve (të gjuhës angleze) , në gjuhën shqipe (shih fq. 22 , 23 , 33 - 163 , 165 , 166 të fashikullit hetimor nr. 132) , vërtet i është ngarkuar Ministrisë të Drejtësisë (shih fq. 21 të fashikullit hetimor nr. 132) , por rezulton e provuar : se prokurori ka caktuar përkthimin **vetëm të një pjese të akteve** (shih fq. 21 të fashikullit hetimor nr. 132) ; Prokurori **nuk argumenton** , se për të cilat shkaqe / arsye , rrethana / fakte , nuk janë përkthyer të gjithë aktet , pjesë përbërëse eventuale të formateve elektronike PDF (referuar aktit manual të dt. 01 / 10 / 2025) ; Pretendoj gjithashtu , se **mospërkthimi i akteve të tjera** (pjesë përbërëse eventuale të akteve elektronike PDF të sipërcituara) **është e qëllimshme** , përbën mjaftueshëm **parregullsi të rëndë procedurale** ; Pretendoj , se është cënuar mjaftueshëm e drejta ime e njohjes / aksesit tim me këto akte (që nuk janë përkthyer) , është cënuar e drejta ime e mbrojtjes efektive dhe është cënuar parimi i

kondradiktoritetit ; Provohet (për aktet e përkthyera vijuese , në gjuhën shqipe shih fq. 169 - 235 / nga përkthyese Aida Gjini , 236 - 445 / nga përkthyese Eva Xhani , të fashikullit hetimor nr. 132) : se përkthimi i seicilës përkthyese , **nuk ka datën e përkthimit** (kjo datë përkthimi , nuk mund të saktësohet , me siguri procedurale); se seicila përkthyese , **nuk ju dihet identiteti i tyre** ; ato/ përkthyeset nuk janë pyetur , nëse kanë shkaqe , për përjashtimin e tyre eventual ; Ato / përkthyeset nuk janë paralajmëruar , për detyrimin , që ato kishin për të bërë përkthim të saktë dhe për të mbajtur sekretin , për veprimet që kryhen prej tyre (dhe në vijim të ftoheshin ato , për të kryer detyrën) ;

87/1). Prokurori kërkon të merren , këto akte , si prova shkresore ; Unë pretendoj , se aktet e përkthyera në gjuhën shqipe (shih fq. 169 - 445 të fashikullit nr. 132 të Prokurorit) **nuk përbëjnë provë shkresore** (në formën e dokumentave zyrtare) , ndaj meje , për secilën akuzë , objekt gjykimi ; Për rrjedhojë , edhe referimi në këto akte , nuk kanë fuqi provuese dhe nuk përbëjnë provë , ndaj meje , për seicilën akuzë , objekt gjykimi ;

87/2). Referuar gjëndjes të akteve të sipërcituara e-mail ; Meqenëse nuk janë përkthyer të gjithë aktet e gjuhës angleze ; Meqenëse kanë lidhje mjaftueshëm me çështjen objekt gjykimi dhe me pafajësinë time , **kërkoj** :

- **përkthimin** (nga gjuha angleze) , në gjuhën shqipe (sipas neneve 123 - 126 , 196 të K. Pr. Penale , referuar ligjit relevant nr. 82/2021 dhe akteve të tij nënligjore) të të gjithë dokumentacionit , që përmbajnë aktet elektronike /formati PDF (shih fq. 11 të fashikullit hetimor nr. 132) ;

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane aktet vijuese : <u>akti manual</u> i dt. 01 / 10 / 2025 , <u>me vulë</u> (referuar fq. 11 e 16 të fashikullit hetimor nr. 132 të Prokurorit) **dhe** <u>dokumentacioni i saj eventual përbërës</u> bashkalidhur / format elektronik PDF , <u>me nënshkrime e vula</u> (referuar fq. 22 , 23 , 33 - 163 , 165 e 166 të fashikullit hetimor nr. 132) ; Kjo letërporosi (për këto akte) , t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merret me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane akti manual / e-mail i dt. 01 / 10 / 2025 , me nënshkrim e vulë (referuar fq. 15 të fashikullit hetimor nr. 132 të Prokurorit) ; Kjo letërporosi t'i dërgohet / niset direkt , nga Gjykata , që në këtë fazë dhe drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

- **të merren me letërporosi** , nga autoritetet Amerikane aktet vijuese : kërkesa përkatëse (me objekt " trajtimi me konfidencialitet " , drejtuar nga çdo palë e interesuar , Gjykatës përkatëse , në SH.B.A) **dhe** vendimi gjyqësor dt. 12 / 6 / 2025 i asaj gjykate në SH.B.A (shih fq. 11 , 16 e 19 të fashikullit hetimor nr. 132 të Prokurorit) ; Edhe kjo letërporosi (për këto akte) , të niset direkt , nga Gjykata , drejtpërdrejt Departamentit të Drejtësisë të SH.B.A , sipas nenit 509/4 të K. Pr. Penale dhe sipas ligjit relevant nr. 10193/2009 (shih nenet e saj 5/3 , 6/2).

Kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 03 / 11 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 05 / 11 / 2026 ;

88). Referuar vendimit të veçantë gjyqësor penal (seancë paraprake) nr. 28/138 dt. 18 / 3 / 2026 të GJ.K.K.O të Shkallës të Parë (shih pg. III të këtij vendimi) kërkoj të urdhëroni Prokurorin , për të marrë / njohur , unë / i pandehuri **, edhe** aktet / deklarimet vijuese :

i). Kopje të legalizuara të deklarimeve të shtetasve të pyetur seicili , në hetimet paraprake , me cilësinë e personit , që kanë dijeni , për rrethanat / faktet e çështjes / çdo episod , objekt gjykimi , ndaj meje (akte të cilat , i administron deri tani , sipas këtij vendimi gjyqsor , vetëm prokurori) ;

ii). Kopje të legalizuara të çdo deklarimi të të pandehurve të tjerë të këtij procedimi penal Monika Kryemadhi , Ema Çoku , Fatime Kryemadhi e Piro Xhixho , të pyetur në hetimet paraprake , me këtë cilësi (edhe këto akte , i administron deri tani , sipas këtij vendimi gjyqsor , vetëm prokurori) ;

Sa më lart janë kërkuar e parashtruar , sipas pretendimeve të mia të datave vijuese : 08 / 9 / 2026 , 09 / 9 / 2026 , 16 / 9 / 2026 , 22 / 9 / 2026 , 29 / 9 / 2026 , 13 / 10 / 2026 , 20 / 10 / 2026 , 27 / 10 / 2026 dhe dt. 03 / 11 / 2026 (para seancave përkatëse gjyqësore) ;

89). Për të kundërshtuar (tërësisht ose pjesërisht , përmbajtjen e dëshmisë ose ai refuzon të dëshmojë) kërkoj nga Gjykata të mos e lejojë Prokurorin , që të përdori deklarimin dt. 23 / 11 / 2017 të **dëshmitarit Romeo Kara** (shih fq. 1 të fashikullit hetimor nr. 61 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) , sepse ky deklarim **nuk është nënshkruar** , në fundin e çdo flete /faqeje , nga prokurori , që e ka pyetur (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 22 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 9 / 2026) ;

90). Pretendoj , se (referuar deklarimit tij dt. 22 / 9 / 2022 ; shih fq. 84 , po të fashikullit hetimor nr. 61 të Prokurorit) **dëshmitari Idajet Beqiri** , <u>nuk është i besueshëm</u> , për këtë çështje , sepse ky shtetas nuk ka patur dijeni , për faktet e rrethanat e dobishme të hetimit të kësaj çështje dhe nuk është pyetur , sipas kuptimit të arsyeshëm të neneve 149/1 , 153 e vijues , 283 , 293 , 294 e 297/1,2 të K. Pr. Penale (kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 22 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 9 / 2026) ;

91). Për të kundërshtuar (tërësisht ose pjesërisht , përmbajtjen e dëshmisë ose ai refuzon të dëshmojë) kërkoj nga Gjykata të mos e lejojë Prokurorin , që të përdori deklarimin dt. 04 / 01 / 2023 të **dëshmitarit E.K** (shih fq. 89 , po të fashikullit hetimor nr. 61 të Prokurorit) , sepse ky deklarim **nuk është nënshkruar** , në fundin e çdo flete /faqeje , nga , nga oficeri i policisë gjyqësore prokurori që e ka pyetur (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 22 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 9 / 2026) ;

92). Për të kundërshtuar (tërësisht ose pjesërisht , përmbajtjen e dëshmisë ose ai refuzon të dëshmojë) kërkoj nga Gjykata të mos e lejojë Prokurorin , që të përdori deklarimin dt. 28 / 4 / 2023 **dëshmitarit A.P** (shih fq. 126 , po të fashikullit hetimor nr. 61 të Prokurorit) , sepse dëshmia e tij nuk është marrë / administruar , sipas rregullave procedurale penale (kërkuar prej meje , sa më lart me

parashtrimet / kërkesat e mia dt. 22 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 24 / 9 / 2026 ; kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 13 / 10 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 15 / 10 / 2026) ;

93). Për të kundërshtuar (tërësisht ose pjesërisht , përmbajtjen e dëshmisë ose ajo refuzon të dëshmojë) kërkoj nga Gjykata të mos e lejojë Prokurorin , që të përdori deklarimin dt. 02 / 4 / 2024 **të dëshmitares E.H** (shih fq.149 , po të fashikullit nr. 61 të Prokurorit) , sepse ky deklarim **nuk është nënshkruar** , në fundin e çdo flete /faqeje , nga oficeri i policisë gjyqësore (kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 29 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 01 / 10 / 2026) ;

94). Për të kundërshtuar (tërësisht ose pjesërisht , përmbajtjen e dëshmisë ose ai refuzon të dëshmojë) kërkoj nga Gjykata të mos e lejojë Prokurorin , që të përdori deklarimin dt. 07 / 11 / 2023 **të dëshmitari I.K** (shih fq. 192 e vijim , po të këtij fashikulli nr. 61 të Prokurorit) , sepse **mungojnë** fletët e tjera 2 - 4 të procesverbalit të pyetjes tij (pra , për këtë dëshmitar , nuk administrohet , në këtë fashikull , dëshmia e tij/procesverbali eventuale e plotë ; kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 29 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 01 / 10 / 2026) ;

95). Për të kundërshtuar (tërësisht ose pjesërisht , përmbajtjen e dëshmisë ose ai refuzon të dëshmojë) kërkoj nga Gjykata të mos e lejojë Prokurorin , që të përdori deklarimin dt. 20 / 3 / 2024 **të dëshmitari E.S** (shih fq. 238 e vijim , po të këtij fashikulli nr. 61 të Prokurorit) , sepse **mungojnë** faqet / fletët e tjera të procesverbalit të pyetjes tij ; kërkuar sa më lart , me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 29 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 01 / 10 / 2026) ;

96). Meqenëse kanë lidhje me çështjen , ka lidhje me dëshminë e shtetasit Jozef Hejsek (dhënë prej tij , para Arbitrazhit Tregtar të Vjenës / Austri) ; Për faktin , se provon (në mënyrë objektive) ecurinë e veprimtarisë civile / kontraktore /tregtare , të fakteve / rrethanave të marrëveshjes / kontratës të krijuar midis shoqërive tregtare ÇEZ - DIA dhe ka lidhje me episodin hetimor “ ÇEZ - DIA

” , **kërkoj** nga Gjykata të merren dhe të administrohen , si prova shkresore (dhe të përkthehen , në gjykim) aktet vijuese :

i). Vendimi përkatës i Arbitrazhit Tregtar të Vjenës , lidhur me mosmarrëveshjen midis shoqërive ÇEZ - DIA ;

ii). proces - verbalin/et e plotë të mbajtur , nga ky Arbitrazh , për këtë mosmarrveshje e shqyrtuar prej tyre ;

iii). praktikat e provave shkresore , që kanë dërguar (për shqyrtim , në këtë Arbitrazh) administratorët e shoqërisë DIA , për këtë mosmarrveshje ;

iv). praktikat e akteve / provave shkresore , që ka dërguar për shqyrtim (në këtë Arbitrazh , për këtë mosmarrëveshje) dëshmitari A.C (me detyrë administrator i shoqërisë DIA) ; të gjitha deklarimet /dëshmitë e dhëna nga ky dëshmitar , në këtë Arbitrazh ;
v). praktikat e provave shkresore , që ka dërguar (për shqyrtim , në këtë Arbitrazh) dëshmitari K.I , për këtë mosmarrveshje ;

97). Provohet , se procedimi penal / hetimor është paraqitur për gjykim / në seancë paraprake (sipas nenit 331 të K. Pr. Penale) , më dt. **29 / 8 / 2025** ; Në kuptimin / thelbin e arsyeshëm të neneve 151/2,3 , 323 , 324/4 e 331 të K. Pr. Penale) provat e marra , pas mbarimit të afatit hetimor , nuk përdoren ; provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji (shih nenin 324/4 i këtij kodi) , nuk mund të përdoren ; papërdorshmëria e provave ngrihet , edhe kryesisht / nga gjykata , në çdo gjendje e shkallë të procedimit ; Meqenëse provat vijuese janë marrë prej Prokurorit / oficeri i policisë gjyqësore , pas mbarimit të afatit hetimor (pra , pas dt. 29 / 8 / 2025 /dita që procedimi penal u dërgua nga prokurori , për gjykim) kërkoj të mos përdoren si provë , në këtë gjykim , ndaj meje , sa vijon :

i). Proces - verbali dt. **04 / 9 / 2025** i pyetjes të dëshmitares **M.H** (përcjellë prej prokurorit , në seancë gjyqësore paraprake , me aktin e tij dt. 27 / 10 / 2025 / akte hetimore shtesë ; shih fq. 1 të fashikullit hetimor nr. 132 , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ;

ii). Proces - verbali dt. **15 / 9 / 2025** i pyetjes të dëshmitarit **P.S** (përcjellë prej prokurorit , në seancë gjyqësore paraprake , me aktin e tij dt. 27 / 10 / 2025 / akte hetimore shtesë ; shih fq. 4 , po të fashikullit hetimor nr. 132) ;

iii). Proces - verbali dt. **27 / 10 / 2025** i kqyrjes e marrjes të dokumentave , nga policia gjyqësore ; marrë këto akte dhe të printuara nga akti dt. **01 / 10 / 2025** , nga formati elektronik PDF , bashkalidhur CD- përkatëse (dërguar eventualisht , ky akt , prej Departamentit Amerikan të Drejtësisë) dhe të marra nga e-mail dt. **01 / 10 / 2025** (dërguar ky e-mail eventualisht , prej Departamentit Amerikan të Drejtësisë) ; Përcjellë prej prokurorit (aktet e sipërcituara) , në seancë gjyqësore paraprake , me aktin e tij dt. 27 / 10 / 2025 / akte hetimore shtesë ; shih fq.7 , po të fashikullit hetimor nr. 132) ;

iv). Aktet e gjuhës shqipe (nga përkthimi i akteve të gjuhës angleze , që përmbanin akti i sipërcituar dt. 01 / 10 / 2025 i Departamentit Amerikan të Drejtësisë dhe e-mail dt. 01 / 10 / 2025 , po i Departamentit Amerikan të Drejtësisë ; shih fq. 169 - 445 , po të fashikullit nr. 132 të Prokurorit) ;

98). Meqenëse provojnë gjëndjen e akteve , që pretendohet se mora , nga Gj.K.K.O të Shkallës të Parë , kopje të legalizuara të fashikujve hetimor (që u patën parasysh , nga kjo GJ.K.K.O , lidhur me caktimin e masës të sigurimit peronal , ndaj meje) dhe mora kopje të legalizuara të 132 fashikujve hetimor të prokurorit (që i bashkalidhet aktualisht dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) **kërkoj** ti bashkohen kësaj dosje gjyqesore , aktet vijuese të Gj.K.K.O të Shkallës të Parë:

i). Akti i saj nr. 2283/1 dt. 30 /6 / 2026 ;

ii). Akti i saj 2283 dt. 08 / 7 / 2026 ;

iii). Akti i saj nr. 2709/1 dt. 03 / 9 / 2026 ;

iv). Akti i saj nr. 2709/2 dt. 04 / 9 / 2026 ;

v). Akti i saj nr. 2709/3 dt. 17 / 9 / 2026 ;

vi). Akti i saj nr. 2709/4 dt. 18 / 9 / 2026 ;

98/1). **të kqyret** nga gjykata fashikulli / volumi hetimor nr. 27 (që administrohet bashkalidhur dosjes gjyqësore të veçantë penale të saj me nr. 125 vendimi dt. 20 / 10 / 2024) , për numrin e fletëve të asaj dosje ;

98/2). **kërkoj** nga Prokurori dhe /ose Gjykata të verifikohet / sqarohet mjaftueshëm e në mënyrë shteruese , mungesa e fletëve / akteve nr. 61 , 64 , 70 , 76 , 86 , 91 , 96 e 143 të fashikullit hetimor nr. 27 (që i bashkalidhen dosjes hetimore dhe që GJ.K.K.O e Shkallës se Parë i ka administruar , sipas vendimit të saj gjyqësor të veçantë penal nr. 125 dt. 20 / 10 / 2024 ; pra , këto akte i kanë munguar ekspertimit financiar , në hetimet paraprake dhe cenohet baza faktike , ku është bazuar eventualisht ekspertja , për kryerjen e këtij ekepertimi) ; Pra , edhe për këtë shkak kërkoj **të thirret** (për sqarime) ekspertja financiare ;

98/3). kërkoj **të administrohen aktet e fashikujve të prokurorit** , me gjëndjen që ajo / Gjykata do të konstatojë , pas verifikimit / numërimit prej saj , në seancë gjyqësore të këtyre akteve (dhe të mos i referohet inventarit të akteve , që ka dorzuar prokurori) ; Kërkoj **të administrohen , nga gjykata** , çdo vendim / veprim / akte të tjera , të disponuara prej prokurorit / oficerit të policisë gjyqësore dhe aktet e dërguara / paraqitura , në SPAK , nga të tretët (që në tërësi ju bashkalidhen këtyre fashikujve) , **duke cilësuar** llojin e aktit , nr. e aktit , datën e tyre , gjëndjen e tyre (origjinale apo kopje e legalizuar rregullisht apo kopje të pa legalizuar) dhe nr. e fletëve të çdo akti .

Kërkuar sa më lart me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 29 / 7 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore dt. 29 / 7 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 16 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 17 / 9 / 2026 ; Kërkuar sa më lart , edhe me parashtrimet / kërkesat e mia dt. 22 / 9 / 2026 , për llogari të seancës gjyqësore eventuale të dt. 24 / 9 / 2026;

99). Meqenëse provojnë gjëndjen e akteve , që pretendohet se i bashkohen dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi) ; Duke patur parasysh faktin , që sipas aktit dt. 04 / 8 / 2025 të Prokurorit (pra , ky akt ka lidhje me dorëzimin e fashikullit

të dërgimit në gjyq , nga prokurori ; shih fq. 193 të fashikullit hetimor nr.130 të Prokurorit , që i bashkalidhet dosjes gjyqësore të themelit , objekt gjykimi provohet (nga vetë prokurori) , se fashikulli penal i dërgimit në gjyq përmbante (në përfundim të hetimeve paraprake) , më dt. 04 / 8 / 2025 , gjithësej **116** fashikuj hetimor , të dokumentuara në formatin dixhital PDF , formatet A4 dhe A3 , të ruajtura ato elektronikisht , në CD e DVD ; Por , me regjistrimin e dosjes , për gjykim themeli (dhe pasi u disponua , sipas vendimit gjyqësor / në seancë paraprake nr. 28/138 dt. 18 / 3 / 2026 të Gj.K.K.O të Shkallës së Parë , për këtë procedim penal) rezultojnë aktualisht , që aktet e këtyre fashikujve hetimor , janë të administruara / lidhura , në **132** fashikuj ; Prandaj kërkoj nga prokurori të **argumentojë këtë ndryshim thelbësor** , lidhur me këtë diferencë fashikujsh hetimor dhe akteve tyre (nga 116 fashikuj , në 132 fashikuj) , që konsiderohen pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore ;

100). Ju vë në dijeni , për adresat e disa dëshmitarëve të kërkuar prej meje :

100/1). Me aktin tim dt. 08 / 9 / 2026 (të depozituar edhe pranë jush) , ju kam njoftuar , për adresat e disa dëshmitarëve të tjerë (kërkuar dëshmia e tyre , si prova , prej meje) dhe ju kam njoftuar për faktin , se D.P.GJ.Civile , nuk më ktheu përgjigje , për adresat e disa dëshmitarëve tjerë / shtetas shqiptar ; Për këto shkaqe kërkoj , që adresa e tyre e banimit / vendqëndrimit , të merret nga Gjykata ;

101). **Ju njoftoj** , se vijon përsëri monitorimi / mbikqyrje takimi im , me avokatin tim , ka vijuar , edhe më datat 07 / 11 / 2026 e 10 / 11 / 2026 ;

101/1). Meqenëse kjo situatë përgjimi , vijon akoma ; Duke i vlerësuar këto fakte / rrethana , si shkelje të ndodhura gjatë procesit gjyqësor të të drejtës të mbrojtjes time efektive , të drejtës time për jetë private , parimit të barazisë së armëve dhe parimit të paanësisë të procesit tim gjyqësor në themel **kërkoj** përsëri , që Gjykata të urdhërojë në këtë fazë , marrjen e masave të menjëhershme , për heqjen e kamerave të vëzhgimit dhe/ose përgjimit / mbikqyrjes / monitorimit , nga dhoma e takimit , kur unë takohem me avokatin tim ose për sigurimin e kushteve të

tjera , që garantojnë plotësisht konfidencialitetin , gjatë këtyre takimeve / bisedave / komunikimit , me avokatin tim ;

102). Me këto parashtrime pretendoj përsëri , se interpretimet / konkluzionet e prokurorit (per faktet , rrethanat dhe provat objekt gjykimi) janë arbitrare , të paarsyeshme , joobjektive dhe nuk përputhen me thelbin / kuptimin e arsyeshëm të provave , mjeteve procedurale për kërkimin e provave (shih nenet 149/1 e vijues të K. Pr. Penale) dhe me jurisprudencën e tyre relevante ; Gjithashtu pretendoj , se këto interpretime të prokurorit , nuk përputhen me thelbin / kuptimin e arsyeshëm të neneve 260 e 25 , 287/2 dhe 257/a , paragrafi 2 të Kodit Penal , objekt akuze dhe me jurisprudencën e tyre relevante ;

103). Bashkalidhur , keni edhe kopje të këtyre parashtrimeve / kërkesave (për t'ja njoftuar Prokurorit) ;

KËRKUESI
i pandehuri Z. **ILIR METAJ**
Përfaqsuar nga **Av. Bujar MUSTA**